



MONITORIMI
I ZGJEDHJEVE LOKALE,
21 QERSHOR 2015, NË SHQIPËRI



RAPORT PËFUNDIMTAR





MONITORIMI
I ZGJEDHJEVE LOKALE,
21 QERSHOR 2015, NË SHQIPËRI



RAPORT PËFUNDIMTAR

Ky raport është bërë i mundur në kuadër të projektit "Vëzhgimi i zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit, 2015". Ky projekt mbi vëzhgimin e zgjedhjeve vendore mbështetet nga "Assist Impact", nëpërmjet financimit të siguruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe me asistencën teknike nga Instituti Demokratik Kombëtar.

Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve të Koalicionit për Zgjedhje të Ndershme dhe të Lira dhe për Demokraci të Qëndrueshme (KZLNDQ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

©Aplikimi për lejen e riprodhimit ose të përkthimit të gjithë ose të një pjese të këtij manuali duhet të bëhet pranë zyrës së KZLNDQ-së:

Rruga Abdyl Frashëri, Pall 10/1, Shkalla 1, Apartmenti 3
Tirana, Albania
E-Mail: kzln@kzln.org.al
www.kzln.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| SHKURTIME | 5 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 7 |
| KONKLUZIONE | 10 |
| LISTAT E VOTUESVE | 11 |
| FUSHATA ZGJEDHORE | 11 |
| PËRDORIMI I HAPËSIRËS DHE BURIMEVE PUBLIKE | 12 |
| ORGANET E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE | 14 |
| DITA E VOTIMIT | 17 |
| PROÇESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE | 18 |
| KONKLUZIONE TË TJERA TË RËNDËSISHME | 19 |
| REKOMANDIME | 21 |
| LISTAT E VOTUESVE | 21 |
| FUSHATA ZGJEDHORE | 21 |
| PËRDORIMI I HAPËSIRËS DHE BURIMEVE PUBLIKE | 21 |
| ORGANET E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE | 22 |
| PROÇESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE | 23 |
| REKOMANDIME TË TJERA TË RËNDËSISHME | 24 |
| HYRJE | 26 |
| NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI ZGJEDHJET | 27 |
| KONTEKSTI POLITIK | 27 |
| KUADRI LIGJOR | 28 |
| REZULTATET E ZGJEDHJEVE | 29 |
| GJETJE DHE ANALIZE | 30 |
| PERIUDHA PARAZGJEDHORE | 30 |
| KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE | 30 |
| KËRKESAT ANKIMORE ADMINISTRATIVE | 33 |
| KOLEGJI ZGJEDHOR | 33 |
| KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE | 35 |
| FUSHATA ZGJEDHORE | 40 |
| PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE | 44 |
| DITA E ZGJEDHJEVE | 48 |
| SITUATA PAS ZGJEDHORE | 54 |
| PROÇESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE | 54 |

| | |
|---|-----------|
| RRETH KZLNDQ | 57 |
| RRETH PROJEKTIT “MISIONI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE NË SHQIPËRI” | 57 |
| FALENDERIME | 59 |
| ANEKSET | 60 |
| <i>Aneks 1 – Tabela e adresave të KZAZ-ve</i> | 60 |
| <i>Anex 2 – Pyetsori përdorur nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve të 21 qershorit 2015.</i> | 62 |
| <i>Anex 3 - Forma e Incidenteve kritike përdorur nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve të 21 qershorit 2015.</i> | 66 |
| <i>Anex 4 – Grafikët informues në lidhje me vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve.</i> | |
| <i>Ju lutem e gjeni këtë informacion në faqen e internetit të: www.kzln.org.al</i> | 68 |
| <i>Anex 5 – Tabelat me rezultatet e vëzhgimit të Ditës së Zgjedhjeve.</i> | |
| <i>Ju lutem e gjeni këtë informacion në faqen e internetit të: www.kzln.org.al</i> | 68 |

SHKURTIME

| | |
|--------|--|
| ASHE | Aleanca për Shqipërinë Evropiane |
| APPD | Aleanca Popullore për Punë e Dinjitet |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BMM | Bordi i Monitorimit të Mediave |
| GN | Grupet e Numërimit |
| IDK | Instituti Demokratik Kombëtar |
| INDAD | Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë për Demokracinë |
| KQV | Komisionet e Qëndrave të Votimit |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| KNV | Komisioni i Numërimit të Votave |
| KZAZ | Komisioni i Zonave të Administrimit Zgjedhor |
| KZLNDQ | Koalicioni për Zgjedhje të Ndershme dhe të Lira dhe për Demokraci të Qendrueshme |
| LSI | Lëvizja Socialiste për Integrim |
| MEGA | Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen |
| NJQV | Njësi të Qeverisjes Vendore |
| OAZ | Organet e Administrimit të Zgjedhjeve |
| PBDNJ | Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut |
| PD | Partia Demokratike |
| PDIU | Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet |
| PR | Partia Republikane |
| PS | Partia Socialiste |
| QNV | Qendrat e Numërimit të Votave |
| QV | Qendër Votimi |
| RAT | Reforma Administrativo-Territoriale |
| VASH | Vëzhgues Afatshkurtër |
| VAGJ | Vëzhgues Afatgjatë |
| ZAZ | Zona Administrative Zgjedhore |

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet vendore të 21 qershorit u zhvilluan në kuadrin e Reformës Administrative – Territoriale, që gjeneroi shumë debat, dhe shërbyen si një test i rëndësishëm për objektivin e Shqipërisë në hapjen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Në përgjithësi, Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) vlerëson se ndërkohë që dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe e rregullt, periudha para dhe pas zgjedhjeve u karakterizua nga një sërë mangësish si përballë legjislacionit kombëtar ashtu edhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira e të ndershme.

Përgatitjet filluan me ndryshime të Kodit Zgjedhor, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare demokratike¹ dhe u njollosën nga një seri problemesh duke përfshirë presionin mbi votuesit, abuzimin e burimeve shtetërore, blerjen e votës dhe mungesën e koherencës në vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si edhe kushte jo të barabarta për të gjithë kandidatët për të garuar.

Periudha parazgjedhore u karakterizua nga keqpërdorimi i pozitave zyrtare dhe abuzimi i burimeve publike për qëllime elektorale si edhe nga administrata tepër e politizuar zgjedhore. Pavarësisht detyrimeve ligjore të mirëpërcaktuara dhe parashikuar në Kodin Zgjedhor (Neni 78) ushtrimi i jashtëligjshëm i autoritetit shtetëror për përfitime elektorale kërkon mjete më strikte zbatimi. Dështimi në respektimin e këtij parimi duhet të ketë pasoja ligjore.

Fatkeqësisht akuzat e shumta për frikësimin e votuesve dhe blerje vote vijuan përgjatë gjithë fushatës zgjedhore, çka dëmton besimin e publikut në procesin zgjedhor. Koalicioni i ka apeluar vazhdimisht policisë dhe prokurorisë të hetojë gjithë rastet e raportuara duke informuar në të njëjtën kohë publikun. Në të njëjtën logjikë, KZLNDQ i bën fuqimisht apel partive politike të mos detyrojnë apo ofrojnë incentiva monetare për qytetarët që këta të fundit të votojnë pro ose kundër një kandidati ose partie të caktuar.

Procesi u njollos edhe nga retorika e kriminalizimit të kandidatëve dhe mungesa e vullnetit të fortë politik për ta adresuar këtë problem. KZLNDQ i bëri thirrje partive politike të rrisin transparencën e mekanizmave që zbatohen për të zgjedhur kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiakë. Është tepër e rëndësishme që votuesit të bëjnë një zgjedhje të informuar për administratorin/ët e qytetit të tyre.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Bashkiak duhet të përfshiheshin më tepër në fushatë. Vizioni i tyre për administrimin e qytetit nuk arriti të transmetohej tek votuesit. Ata shpesh anashkaloheshin nga prania e udhëheqësve të partisë dhe kishin kryesisht funksion dekorues në aktivitetet elektorale.

Mospërputhjet dhe paqartësitë që influencojnë zhvillimin e zgjedhjeve vijuan duke përfshirë kohëzgjatjen e fushatës, regjistrimin e kandidatëve si edhe afatet për formimin e organeve

¹Standardet ndërkombëtarë kërkojnë që legjislacioni zgjedhor të mos ndryshohet për një periudhë prej 3 deri në 18 muaj para ditës së zgjedhjeve. Për më tepër shih: "Kodi i Sjelljes në Cështjet Zgjedhore/ Udhëzime dhe Raporti Shpjegues" Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit/ Komisioni i Venecias, Opinion nr. 190/2002, "Nivelet rregullatore dhe qëndrueshmëria e ligjit zgjedhor", Pjesa II/b, f. 10. Online: [http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev-e](http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev-e)

zgjedhore: Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe Vendet e Numërimit të Votave (VNV). Për më tepër, zëvendësimet e shpeshta të komisionerëve nga partitë politike krijuan vështirësi në punën e të gjitha niveleve të administratës zgjedhore.

Ndaj, krijimi i organeve të pavarura dhe të paanshme për menaxhimin e zgjedhjeve është me rëndësi parësore për vendin. Ky do të ishte një hap domethënës në ndërtimin e besimit të elektoratit dhe partive politike në zgjedhje. Në përgjithësi administrata zgjedhore duhet të reflektojë standardet e zgjedhjeve të lira e të ndershme: pavarësi dhe paanshmëri, transparencë, efikasitet dhe efikasitet.

KZLNDQ gjithashtu rekomandon krijimin e shkollës së trajnimit për administratorët e zgjedhjeve. Ata duhet të trajnohen në numër të konsiderueshëm, brenda afateve ligjore dhe në fund të zgjidhen vetëm nga lista e komisionerëve të trajnuar që kuptojnë procesin zgjedhor dhe legjislacionin shoqëruar. Transparenca, duke përfshirë publikimin në kohë të vendimeve dhe mënyrën e votimit, duhet përmirësuar në të gjithë nivelet e administratës zgjedhore. Buxheti i alokuar për menaxhimin e zgjedhjeve, veçanërisht në nivelin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) duhet të jetë i mjaftueshëm dhe i shpërndarë në një afat kohor të arsyeshëm.

Partitë politike duhet ta kishin planifikuar më mirë fushatën e tyre, në mënyrë që të reflektonin ndryshimet e reformës territoriale dhe administrative. Në kuadër të ndarjes së re territoriale dhe përbërjes së njësisive të qeverisjes vendore, partitë politike duhet t'i kishin ekspozuar votuesit e tyre ndaj efekteve praktike të reformës në komunitetin e tyre duke reflektuar gjithashtu mbi planet e të ardhmes.

Përfaqësimi i ulët i grave në Organet e Administrimit të Zgjedhjeve (OAZ) vijon të përbëjë shqetësim, pasi partitë politike dështuan në zbatimin e plotë të angazhimit për të rritur pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor. KZLNDQ vëren me keqardhje se niveli i tretë i administratës zgjedhore vijon të vuajë nga përfaqësimi tejet i ulët i grave. Ndërkohë që KZLN vlerëson pozitivisht diskriminimin pozitiv ndaj grave, që e bën të detyrueshme për listat e kandidatëve për Këshill Bashkiak të kenë 50% për secilën gjini. Pavarësisht kësaj, vetëm 9 gra (15%) u zgjodhën kryetare bashkie dhe 552 ose 34.6% u zgjodhën si këshilltare. Në këtë kuadër do të vlerësoheshin përpjekjet e masat e partive politike për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave në politikë.

Aksesi i votuesve që nuk mund të votojnë vetë mbetet shqetësim. Në këto zgjedhje, Neni 7 i Kodit Zgjedhor qartësisht nuk u respektua.² KZLNDQ inkurajon KQZ-në dhe njësitë e qeverisjes vendore të koordinohen më herët në proces në mënyrë që të ofrojnë mundësi të barabarta votimi

²“Në çdo rast, aty ku ka votues të regjistruar sipas pikës 6 të këtij neni, që kanë vështirësi të aksesojnë qendrën e votimit, qendrat e votimit duhet të organizohen dhe përcaktohen në mënyrë të tillë që të garantojnë aksesin e lirë për këtë kategori votuesish. Nëse kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet e KQZ dhe me shpenzimet e KQZ, kryetarët e njësisive të qeverisjes vendore vendosin personel mbështetës ose pajisje që garantojnë aksesin”. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 108, Pika 7, f. 60. Online: <http://www.osce.org/albania/159501?doenload=true>

për votuesit që nuk mund të votojnë vetë dhe të respektojnë dispozitat ligjore dhe rregullat zgjedhore.

Natyra delikate e numërimit të votave vijon të kërkojë një qasje të drejtë dhe transparente. Procesi duhet përfunduar në orën 22:00 pas ditës së zgjedhjeve ose brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, sikurse parashikohet në Kodin Zgjedhor. KZLNDQ rekomandon numërimin e votave në Qendrat e Votimit në prani të vëzhguesve. Kopje të tabelave të rezultateve zgjedhore në nivel KZAZ-sh duhet të ofrohen për të gjithë vëzhguesit, jo vetëm për ata që përfaqësojnë subjektet zgjedhore.

Fillimi i diskutimeve për përgatitjen dhe miratimin e Kodit të Etikës përbën një hap të domosdoshëm për zgjedhjet e ardhshme. Kodi duhet të rregullojë mënyrën se si partitë politike dhe zyrtarët e lartë sillen gjatë fushatës zgjedhore si edhe gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve.

KONKLUZIONE

Konkluzione të përgjithshme

Në përgjithësi, në bazë të vëzhgimit në terren, KZLNDQ vlerësoi, se procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve në shumicën e rasteve u krye në përputhje me kërkesat ligjore dhe se shkeljet e vërejtura në disa Qendra Votimi (QV) nuk mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme rezultatet e zgjedhjeve.

KZLNDQ nuk vërejtí ndonjë ndërhyrje të rëndësishme në procesin zgjedhor gjatë ditës së votimit, as nga niveli qendror dhe as nga njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë pikëpamje, Shqipëria kryesisht i arriti angazhimet dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, pavarësisht një numri mangësish të vërejtura në periudhat para dhe pas zgjedhore.

Periudha para dhe pas zgjedhore vuajti nga disa aspekte të kritikuar edhe më parë, si keqpërdorim të posteve zyrtare, keqpërdorim të burimeve publike për qëllime elektorale, akuza për presion mbi votuesit dhe blerje të votave, si dhe administratës zgjedhore tejet të politizuar. Megjithëse Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ofron themelet për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, mosgatishmëria e vërejtur nga ana e partive politike për të respektuar plotësisht Kodin Zgjedhor, prodhoi disa incidente që janë në kundërshtim me angazhimet e organeve të administratës zgjedhore.

Akuzat për frikësim të votuesve dhe për blerje të votave vazhduan gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga ana e përfaqësuesve të partive politike, aspekt i rëndësishëm, që ndikon në besimin e publikut te procesi zgjedhor. Një numër i dispozitave që rregullojnë këto zgjedhje u ndryshuan në Kodin Zgjedhor, më 2 Prill 2015³.

Megjithë këto ndryshime, mospërputhje dhe paqartësi vazhduan të ndikojnë në zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë kohëgjatësinë e fushatës, regjistrimin e kandidatëve, si dhe afatet për përbërjen dhe formimin e organeve zgjedhore si Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe Komisionet e Numërimit të Votave (KNV).

Zëvendësimet e shpeshta të komisionerëve nga ana e partive politike krijuan vështirësi për ritmin e punës së KQZ-së, KZAZ-ve, KQV-ve dhe KNV-ve.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor ishin të rëndësishme për shkak të Reformës Administrativo-Territoriale të miratuar në Korrik të vitit 2014, por këto u kryen me vonesë dhe mbetën të pjesshme. Përveç kësaj, partitë politike nuk arritën të trajtonin siç duhet rekomandimet e vazhdueshme të OSBE/ODIHR-it për përmirësimin e kuadrit ligjor zgjedhor.

³Qendra e Publikimeve Zyrtare, 6 Prill, 2015. OfficialGazetteno. 51. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjinnr. 8652, datë 31.7.2000, "Përganizimindhefunksionimin e qeverisjesvendore", tëndryshuar. Online: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/51-2015.pdf.

Listat e Votuesve

Sipas të dhënave të KQZ-së në 21 qershor 2015, 3,370,206⁴ votues shqiptarë patën mundësinë për të shprehur vullnetin e tyre politik për të zgjedhur kryetarë të rinj të komunave dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak në 5,301 QV. Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pjesëmarrja në votime në zgjedhjet e 21 qershorit 2015, ishte 47,63%⁵. KZLNDQ ngre disa shqetësime në lidhje me Listat e Votuesve dhe faktin se nuk ka ndonjë nismë apo përpjekje nga institucionet qeveritare që të angazhohen në mënyrë aktive emigrantët shqiptarë në zgjedhje. Kjo e bën të vështirë për këta qytetarë që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Përveç kësaj, situata aktuale e bën të vështirë verifikimin e saktësisë të Listave të Votuesve dhe për të llogaritur shifrat reale të pjesëmarrjes së qytetarëve në votime.

Është me rëndësi fakti që vëzhgimi i KZLNDQ-së tregoi se në 25% të QV-ve, një ose më shumë votues nuk ishin në gjendje të gjenin emrat e tyre në listat e votimeve. Kjo do të thotë se këta votues si rezultat nuk mund të votonin, pasi në listat e votuesve kishte parregullsi të vazhdueshme dhe se jo të gjithë votuesit u njoftuan paraprakisht se ku ishin caktuar për të votuar. Një nga shkaqet e këtij konfuzioni është se Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk i informuan në kohë votuesit në lidhje me adresën e QV-së së tyre. Dështimi për të kryer këtë proces është një problem që përsëritet në çdo zgjedhje. Megjithatë, vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan se Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) improvizuan duke krijuar struktura të hapura ku punonjës të administratës me laptop ndihmuan votuesit në gjetjen e QV-së së tyre përkatëse.

Fushata Zgjedhore

Fushata zgjedhore rregullohet nga Kodi Zgjedhor dhe përfshin të gjitha aktivitetet dhe veprimet e përcaktuara me ligj, gjatë së cilës partitë politike paraqesin përpara votuesve programin dhe kandidatët e tyre. Proceset kryesore të fushatës zgjedhore të rregulluara nga Ligji Zgjedhor përfshijnë: të drejtën e partive politike për të kryer aktivitetet e fushatës; rregullat e sjelljes (duke përfshirë shpërndarjen dhe vendosjen e materialeve promovuese, përdorimin e ndërtesave/hapësirave publike, bërjen e fushatës gjatë periudhës së heshtjes); fushatat financiare; procedurat për paraqitjet në media, mbulim të barabartë dhe të drejtë në media si dhe ndalimi për të kryer fushatë nga vendosja e ditës së zgjedhjeve e deri në fillimin zyrtar të periudhës së fushatës.

Vëzhgimi i KZLNDQ-së konstaton se fushata zgjedhore u zhvillua kryesisht në një mjedis të qetë. Kandidatët vazhduan të përdorin format tradicionale të komunikimit me votuesit. Vëzhguesit afatgjatë të KZLNDQ-së konstatuan se mjetet më të preferuara, të renditura sipas densitetit të përdorimit, ishin: postera, takime, fushata derë më derë, si dhe debate në radio dhe televizion. Përdorimi i mediave sociale ishte mjeti i preferuar në 81% të komunave. KZLNDQ

⁴KQZ. Zgjedhjet Vendore 2015. Online: <http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/QV/150529 - DTI - QV zgjedhes lista.htm>

⁵Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet zyrtare. Online: <http://www.cec.org.al/sq-al/Kreu/currentpage/4>

mirëpriti përdorimin e dëgjimeve publike dhe/ose takimeve për diskutim me qytetarë të ndryshëm dhe grupe të interesit.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së monitoruan mesazhe të fushatës të kandidatëve për kryetarë të bashkive dhe gjuhën e përdorur në fushatë. Koalicioni vëren se fokusi kryesor ishte në platformat e kandidatëve individualë dhe jo në sulmet personale, edhe pse kjo e fundit nuk mungoi krejtësisht nga ligjëratat dhe debatet e fushatës. Vëzhguesit afatgjatë nuk raportuan materiale denigruese apo anonime ndaj garuesve rivalë.

Në përgjithësi, nuk pati dhunë zgjedhore përveç disa incidenteve të izoluar në Shkodër, Vaun e Dejës, Himarë, Ersekë dhe Durrës. Një karakteristikë e veçantë e fushatës ishte se premtimet e partive politike ishin të paqarta dhe platformat ishin të përqëndruara në çështjet që zakonisht karakterizojnë zgjedhjet parlamentare dhe më pak të përqëndruara në çështjet shqetësuese për komunitetet vendase.

KZLNDQ thekson se premtimet parazgjedhore në programin elektoral duhet të përcaktohen mirë, në mënyrë që votuesit të jenë në gjendje të marrin një vendim racional të bazuar në informata të mjaftueshme. Në këtë kuptim, "zgjedhje të ndershme" do të thotë shumë më tepër se mungesë e mashtrimit zgjedhor, pasi premtime të paqarta, edhe pse nuk janë të sanksionuara nga ana ligjore, paraqesin një formë të mashtrimit zgjedhor, sidomos në qoftë se kjo bëhet e zakonshme .

Fushata ishte e përqëndruar kryesisht në kandidatët për kryetarë të bashkive, duke lënë në hije kandidatët për këshillin bashkiak, ose thënë ndryshe parlamentet lokale. Këshilli Bashkiak është i një rëndësie të madhe në procesin e vendimmarrjes dhe zhvillimit të bashkisë përkatëse. Ai është gjithashtu i ngarkuar me shqyrtimin e politikave, programeve dhe miratimin e buxhetit. KZLNDQ vërejtë se në Zgjedhjet Lokale të 21 Qershorit 2015, qytetarët morën shumë pak informacion rreth kandidatëve dhe kontributit të tyre në komunitet e më gjerë. Kandidatët për këshilltarë nuk promovohen dhe rrallë shihen në publik gjatë tubimeve dhe takimeve të organizuara nga kandidatët për kryetar bashkie dhe partive të tyre përkatëse.

Vëmendje e pamjaftueshme ju kushtua komunitetit Egjiptian dhe atij Rom. Këto komunitete nuk ishin të përfaqësuar siç duhet në listat e kandidatëve dhe vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan se nuk u zhvillua asnjë aktivitet gjatë fushatës zgjedhore në zona të populluara nga Rome apo Egjiptianë, dedikuar problematikës së tyre.

Përdorimi i hapësirës dhe burimeve publike

Vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan raste ku partitë politike dyshohet të kenë vënë nën presion punonjës të administratës publike, qendrore apo lokale, për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës. Vëzhguesit tanë morrën informacion nga bashkëbiseduesit për rreth 12 raste të presionit të dyshuar ndaj administratës publike, nxënësve apo punonjësve të ndërmarrjeve shtetërore⁶.

⁶Në gjashtë raste të raportuara punonjësit publikë kanë akuzuar se kanë qënë nën presion për të marrë pjesë në aktivitetet zgjedhore të partive politike ose kandidatëve. Në Urën Vajgurore (ZAZ 62), kandidati i PD-së ka deklaruar se punonjësit e administratës publike janë nën presion për të marrë pjesë në aktivitetet elektorale të koalicionit të krahut të majtë. Po kështu, në

Koalicioni vëzhgoi raste ku administrata lokale bënte fushtatë gjatë orarit zyrtar të punës. Në Poliçan (ZAZ 65), punonjës të bashkisë duke përfshirë edhe drejtorin e shkollës së mesme të Poliçanit, shoqëruan kandidatin e krahut të majtë të Aleancës së Shqipërisë Evropiane (ASE) gjatë një tubimi të organizuar në Paraspuar dhe Rehovë, më 2 Qershor. Gjithashtu, në Himarë (ZAZ 86) më 5 Qershor, kryetari në pushtet ka mbajtur një takim në lagjen "1 Maji", i shoqëruar nga një numër i punonjësve të bashkisë.

KZLNDQ shpreh shqetësim në lidhje me shkeljet e dukshme të rasteve të sipërpërmendura të Nenit 3, paragrafi 7 i Kodit Zgjedhor, i cili thotë se gjatë orarit të punës subjektet zgjedhore nuk mund të përdorin burimet njerëzore nga administrata publike të çdo niveli. Institucionet publike duhet të hetojnë dhe të fillojnë procedurat disiplinore ndaj nëpunësve publikë që marrin pjesë në aktivitetet elektorale brenda orarit të punës, pa marrë lejen e duhur.

Ofrimi i formave të ndryshme të ndihmave humanitare ndaj familjeve nga ana e zyrtarëve të qeverisë qendrore, u vërejt gjithashtu nga vëzhgimi i KZLNDQ-së. Në Urën Vajgurore, u dhanë ndihma për familjet e prekura nga përmytjet e Nëntorit 2014 (11/06/2015 16:00-18:30). Gjithashtu, ka patur raste në Novoselë (Vlorë, ZAZ 84) ku votuesve të ndryshëm u janë dërguar ushqime, aspekt që u paraqit edhe në titujt kryesorë të mediave. Periudha kur u dha kjo lloj ndihme mbetet një shqetësim për KZLNDQ, sepse mund të tregojë tendencë për të ndikuar votuesit, gjë që shkon kundër parimit të votës së lirë, sipas Kodit Zgjedhor të Shqipërisë, si dhe kundër standardeve ndërkombëtare. Duke patur parasysh se zyrtarët e qeverisë qendrore janë gjithashtu përfaqësues të partive politike, KZLNDQ-ja ju bën apel partive politike që të përmbahen nga abuzime të bëra kundërt statusit ekonomik, social apo shëndetësor të votuesve, me qëllim ndikimi në vullnetin e lirë të votuesve.

Anëtarët e qeverisë përdorën përrurimin e veprave të rëndësishme publike për të nxitur fushatën e koalicionit qeverisës. Raste ilustruese janë ato në Fier dhe Divjakë. Kryeministri Rama mori pjesë në një miting të organizuar nga koalicioni i krahut të majtë në Fier. Tubimi filloi me inaugurimin e shëtitores së qytetit, një investim publik që nuk kishte pse të lidhej me fushatën për zgjedhjet lokale. Më 8 Qershor, deputeti Erion Braçe përdori hapjen e sezonit turistik në Divjakë për të bërë fushatë për z. Kokoneshi, kandidat i koalicionit të krahut të majtë. Në mënyrë të ngjashme, tubimet e qeverisë qendrore për shpërndarjen e titujve të legalizimit të pronës shpesh nuk dallohen qartë nga veprimtaritë e fushatës.

Berat (ZAZ 64), kreu i fushatës të PD-së argumentoi se gjithë administrata publike e Beratit ishte nën presion për të shërbyer dhe për të mbështetur fushatën e kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Evropiane. Në Selenicë (ZAZ 85), punonjësit publikë, mësuesit dhe punonjësit e spitalit thanë se kanë marrë pjesë në takimet e kandidatit AEA, nën kërcënimet e humbur punët e tyre. KZLN është edhe më shumë e shqetësuar pasi tre prej këtyre gjashtë rasteve (UraVajgurore, Pogradec dhe Vlorë) u vunë re gjithashtu edhe në Raportin e Parë të Përkohshëm. KZLN ka identifikuar gjashtë raste të tjera të punonjësve të qeverisë që kanë mbështetur kandidatët qendrore dhe lokale dhe partitë politike gjatë orarit të punës. KZLN dëshiron të nxjerrë në pah çështjen në Vlorë, ku, gjatë orarit të punës, punonjësit e komunës, punëtorët e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe personeli i spitalit kanë marrë pjesë në takimet për promovimin e kandidatit të krahut të majtë. Organe të ndryshme të medias e raportuan këtë rast.

Pavarësisht një numri incidentesh, në përgjithësi garuesit zgjedhorë nuk shtruan ankesa rreth shpërndarjes së padrejtë të hapësirave publike për afishimin e materialeve të fushatës. Ka patur raste kur hapësirat publike u përdorën nga partitë pa marrë leje nga autoritetet lokale, të cilët reagues në mënyrë të shpejtë. Në 12 Qershor, përfaqësuesit e PD-së vunë flamuj dhe postera në Pallatin e Kulturës në Bulqizë, ku ndodhej KZAZ-ja 18. Flamujt u hoqën pas ankesave të bëra nga kandidati i LSI-së ndaj kryetarit në fuqi të bashkisë, për shpërndarjen e padrejtë të hapësirave të postimit.

Organet e Administrimit të Zgjedhjeve

Puna e Organeve të Administrimit të Zgjedhjeve (OAZ) u ndikua shumë nga vullneti i partive politike. Një tjetër karakteristikë e punës së OAZ-ve në të gjitha nivelet, ka qenë mungesa e transparencës të konsiderueshme, pasi ato nuk arritën të informojnë plotësisht dhe në kohën e duhur publikun rreth mbledhjeve dhe rezultateve të punës së tyre. Edhe pse KQZ-ja bëri përmirësime të konsiderueshme në fushën e të qenit transparent në punën e saj, duke bërë publike në kohë kohën e mbledhjeve dhe agendën e tyre si dhe nëpërmjet transmetimit direkt të tyre, ende duhet bërë më shumë punë në këtë fushë me nivelet e tjera të OAZ-ve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Veprimtaria e KQZ-së ishte kryesisht e politizuar dhe e njëanshme, bazuar kjo në monitorimin e mënyrës së arsyetimit të vendimeve dhe gjithashtu në kuorumin e vendimeve të saj për çështje shumë të diskutueshme dhe kontradiktore, të tilla si çregjistrimi i kandidatëve dhe emërimi i anëtarëve të tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit.

Pavarësisht përpjekjeve të lartpërmendura të KQZ-së për të rritur transparencën e punës së saj, garantimi i aksesit real e të qëndrueshëm të publikut ndaj këtij institucioni mbetet një sfidë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. KZLNDQ ka vërejtur vazhdimisht se Regjistri i Ankesave i publikuar në faqen e internetit të KQZ-së, nuk u përditësua rregullisht. Sipas vëzhgimit deri më datë 31 gusht 2015, Regjistri i Ankesave pas-zgjedhore⁷ përmban informacion deri më datën 10 Korrik, 2015. KZLNDQ gjithashtu vërejtë se vendimet e KQZ-së të marra para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve që janë publikuar në faqen e internetit të KQZ-së, janë në formën e projekt-vendimeve, dhe u mungojnë të dhënat për mënyrën si kanë votuar anëtarët e KQZ-së. Ndjekja hap pas hapi e këtij informacioni në internet do t'i krijonte mundësinë analistëve të zgjedhjeve, votuesve dhe publikut në përgjithësi për të patur një tablo të qartë të procesit të arsyetimit dhe të marrjes së vendimeve nga KQZ-së, pasi edhe vetë Kodi Zgjedhor kërkon që ky proces të jetë publik.

⁷ Për informata më të hollësishme, shikoni Regjistrin e Ankesave Pas Zgjedhore të faqes së internetit të KQZ-së: http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rregjistri/Rregj_Ank_pas_Zgj_2015_KQZ.pdf

Kolegji Zgjedhor

Edhe pse Kolegji Zgjedhor i ka shqyrtuar çështjet dhe ka marrë vendimet brenda afateve ligjore, publikimi i vendimeve të tij vetëm pas përfundimit të zgjedhjeve, çënoi mundësinë për aksesueshmëri dhe transparencë të punës së tij. Sistemi i ankimimit nuk i është përmbajtur plotësisht standardeve ndërkombëtare.

Kolegji Zgjedhor gjykoj 38 ankime zgjedhore nga 31 Marsi deri në 27 Korrik⁸. Veprimtaria e Kolegjit Zgjedhor u reflektua kryesisht në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve para-zgjedhore, në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, me procedurat e këshilltarëve në komunat ekzistuese dhe të partive jo parlamentare, me përzgjedhjen e kandidatëve apo edhe me kërkesat për tërheqjen e tyre.

Vendimet e Kolegjit Zgjedhor u hodhën online, plotësisht, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë vetëm pas zgjedhjeve, dhe jo menjëherë pas dhënies së vendimit nga Kolegji. Palët që kanë qënë pjesë e procedimeve ankimore në Kolegjin Zgjedhor u informuan për vendimin e Kolegjit gjatë procesit gjyqësor dhe kryesisht nëpërmjet mediave, pasi hedhja apo shfaqja online e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor rezultoi me vonesë prej më shumë se pesë ditë pune. Për këtë arsye, e drejta për akses në gjykatë, si dhe standardi i publikimit të vendimeve gjyqësore të arsyetuara në çështjet zgjedhore, që ndikojnë në procesin zgjedhor, nuk është respektuar plotësisht. Seancat gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor kanë qënë publike, në prani të mediave dhe palët janë njoftuar sipas detyrimeve ligjore, por nuk u transmetuan online në internet siç ndodhi me mbledhjet e KQZ-së, edhe pse vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë vendime të formës së prerë dhe ndikojnë në përfundimin e proceseve zgjedhore.

Duke qënë se Kolegji Zgjedhor varet tërësisht nga burimet njerëzore dhe teknike të Gjykatës së Apelit Tiranë, Kolegji Zgjedhor nuk ishte plotësisht funksional, pavarësisht ngarkesës së madhe të tij zgjedhore. Mungesa e trajnimit të sekretareve të Kolegjit Zgjedhor si dhe mungesa e ndihmësave ligjorë për të asistuar gjyqtarët e Kolegjit e bënë edhe më të vështirë funksionimin e Kolegjit Zgjedhor në mënyrë efektive.

Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)

Organet e administrimit të zgjedhjeve, veçanërisht KZAZ-të, pësuan një sërë vështirësish teknike gjatë procesit zgjedhor të Zgjedhjeve për Organizet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015. Ishte e dukshme mungesa e infrastrukturës së duhur, logjistikës e pajisjeve bazë, si dhe e buxhetimit të kësaj strukture të rëndësishme të administrimit të zgjedhjeve. Cilësia e punës së komisionerëve në Zonat Zgjedhore Administrative dhe ecuria e punës të tyre varej nga problemet e lartpërmendura, gjë që rezultoi në neglizhencë dhe mungesë bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm, si në rastin e KQZ-së dhe të Njësitve të Qeverisjes Vendore.

Mungesa e transparencës ishte e dukshme gjatë punës së KZAZ-ve. Komisionerët nuk kryen takime publike në mjedise zyrtare, ata nuk i shpallën publikisht vendimet e tyre, apo t'ju ofronin

⁸Një listë e plotë e vendimeve të KZ-ë është në dispozicion në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit të Tiranës: <http://www.gjykataeapelititirane.al/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&aid=91>

palëve të treta dokumente të caktuara sipas Kodit Zgjedhor. Shumë KZAZ treguan njohuri minimale rreth të drejtave dhe përgjegjësive të tyre ndaj palëve të treta dhe ndaj publikut.

Disa KZAZ⁹ nuk arritën të krijojnë grupet e numërimit brenda afateve ligjore. Komisionerët e opozitës refuzuan të merrnin ndonjë vendim, si përpjekje për të ngadalësuar apo për të bojkotuar procesin, duke detyruar KQZ-në për t'i zëvendësuar ato brenda më pak se 24 orëve para ditës së zgjedhjeve.

Numri i lartë i zëvendësimeve të KZAZ-të gjatë periudhës parazgjedhore është një tjetër tregues i procesit në varësi të tekave të partive politike. Përbërja politike e administratës zgjedhore nuk është *apriori* aspekt negativ i zgjedhjeve në Shqipëri. Megjithatë, polarizimi i konsiderueshëm i vendit përgjatë vijave partiake pati ndikim në punën e komisionerëve në nivele të ndryshme të administratës zgjedhore.

Dita e Zgjedhjeve në përgjithësi

Vëzhguesit e KZLN-së nuk raportuan parregullësi procedurale ose shkelje të konsiderueshme gjatë ditës së zgjedhjeve (gjatë hapjes, procedurave të votimit dhe mbylljes së QV-ve). Për këtë arsye, mund të themi që zgjedhjet u zhvilluan në një atmosferë demokratike, të qetë dhe të drejtë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe të rregulloret, me një numër të vogël parregullsish e incidente të izoluar¹⁰.

Hapja e Votimit

Hapja e qendrave të votimit¹¹ në përgjithësi u krye në përputhje me ligjin dhe rregulloret në lidhje me zgjedhjet, me disa probleme të vogla që nuk ndikuan në mënyrë të konsiderueshme në procesin e votimit. Hapja vazhdoi kryesisht në mënyrë të rregullt, me përjashtim të disa rasteve kur procesi i hapjes u vonua¹² dhe të disa problemeve procedurale. Nga pikëpamja procedurale, pak më shumë se gjysma e QV-ve, në mbarë vendin, respektuan të gjitha kërkesat kyçe të procedurave të hapjes¹³. 85% e qendrave të votimit u hapën pak përpara, ose pikërisht në orën 07:10, gjë që vërteton se vonesat në hapje ishin minimale.

⁹KZAZ-ja 1 (Malesi e Madhe) dhe 15 (Kurbini)

¹⁰Koalicioni vërejti shkelje të rënda të raportuara gjatë procedurave në ditën e zgjedhjeve në më pak se katër (4%) e qendrave të votimit në mbarë vendin .

¹¹Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) nuk ishin në përbërje të plotë në hapjen e rreth 10% të qendrave të votimit në Shqipëri. Në 17% të QV-ve komisionerët nuk arritën të shpërndajnë kopje të regjistrave me vulën e sigurisë gjatë procedurave të hapjes.

¹² Hapja e vonuar e 15% të QV-ve.

¹³Monitoruesit e KZLN vëzhguan procedurat e mëposhtme të hapjes: hapjes në kohë, inspektimin se kutia e votimit është bosh dhe e vulosur me kodet e sigurisë; nëse vulat janë regjistruar në regjistër, nëse kopjet e regjistrave të vulosur u shpërndanë për të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit e partive; nëse të gjitha QV-të janë të pajisura me materialet e nevojshme; dhe praninë e anëtarëve të KQV-së.

Në 16% të QV-ve, në mbarë vendin, komisionerët dhe vëzhguesit nuk morrën kopje të kodeve të përdorura për të mbyllur kutitë e votimit, e cila është në shkelje të Kodit Zgjedhor. Përveç kësaj, në kundërshtim me ligjin, në 10% të QV-ve, në mbarë vendin, kishte komisionerë të cilët nuk ishin të pranishëm gjatë hapjes. Përqindja është pak më e lartë në Tiranë me 16% të QV-ve, e ndjekur nga 12% në Durrës dhe 8% në Shkodër.

Gjatë hapjes, vëzhguesit e KZLNDQ-së patën qasje të lirë dhe të papenguar në pothuajse të gjitha qendrat e votimit nën vëzhgim. Vetëm në 3 (tre) QV nën vëzhgim, monitoruesit e KZLNDQ-së u penguan të vëzhgonin procedurat e hapjes.

Dita e Votimit

Proçesi i votimit u zhvillua në një atmosferë demokratike. Pati disa parregullsi procedurale dhe disa incidente të izoluara. Rastet e qytetarëve të cilëve iu kërkua të largoheshin dhe që nuk iu dha e drejta e votës, pavarësisht se mbanin një vendim gjykate dhe identifikim të vlefshëm, kanë ndodhur në 22 QV. E kundërta u identifikua, gjithashtu, ku qytetarët nuk kishin as identifikim të vlefshëm dhe as urdhër gjykate, e megjithatë u lejuan të votojnë. Raste të tilla kanë qenë të pranishme në 6 QV për rastin e parë dhe 12 QV për këtë të fundit. Procedurat e timbrimit me bojë u respektuan në 93% të rasteve në mbarë vendin.

Një konstatim shqetësues është se në më shumë se 25% të QV-ve, në mbarë vendin, ka patur votues që nuk mund të gjenin emrat e tyre në listat e votuesve. Nëse këto incidente kanë ndodhur qoftë për shkak të mangësive administrative, problemeve në njoftimin e votuesve, apo qoftë për shkak të gabimeve të votuesve, kjo çështje duhet të monitorohet më me kujdes për zgjedhjet e ardhshme.

Vëzhguesit e sondazhit të dy partive më të mëdha, PS dhe PD, u përfaqësuan në rreth 90% të qendrave të votimit, të ndjekur nga LSI me 80% përfaqësim.

Mbyllja e procesit të votimit

Edhe pse mbyllja e qendrave të votimit ishte në përputhje me rregulloret në shumicën e qendrave të votimit, vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan shkelje serioze në 5 QV duke përfshirë praninë e personave të paautorizuar në QV, pezullimin e procedurave të mbylljes për më shumë se 30 minuta dhe mos sigurimit dhe nënshkrimit të kutive të votimit para transportimit. Kjo nuk është një gjetje e rëndësishme nga ana statistikore, ndaj këto raste nuk mund të interpretohen si një pririje kombëtare, por si incidente të izoluara. Një pririje e njëjtë është vërejtur në komunat e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës.

Një shkelje e rëndësishme për tu theksuar ishte procedura e mbylljes, ku u lejuan për të votuar qytetarë të cilët mbërritën në qendrat e votimit pas orës 19:00, në tetë për qind (8%) të QV-ve.

Përveç kësaj, njëzet e tre për qind (23%) të qendrave të votimit raportuan se nuk mund të bashkërenditnin numrin e fletëve të votimit të marra nga KZAZ-ja. Kjo përqindje është e lartë, duke patur parasysh lidhjen e fortë që mospërputhja e votimit ka me mashtrimin edhe pse

ndryshimet mund të kenë ndodhur për shkak të gabimeve në numërim ose të gabimeve njerëzore e jo të mashtrimit. Edhe pse këto gabime mund të jenë shkaktuar prej neglizhencës, apo prej çështjesh mospërputhjeje të votimit, kjo duhet të adresohet nga autoritetet zgjedhore.

Proçesi i numërimit të votave

Proçesi i numërimit të votave është pjesa më delikate dhe e pasigurt e zgjedhjeve në Shqipëri. Proçesi u njoillos për shkak të mungesës së transparencës që nga mbyllja e QV-ve dhe transportit të kutive të votimit për në Qendrat e Numërimit të Votave (QNV), e deri te proçeset brenda QNV-ve. Planimetria e QNV-ve, me tavolina dhe me grupe të shumta numërimi, nuk ofroi një pamje transparente për vëzhguesit, për shkak të distancës të papërshtatshme nga tavolinat e numërimit.

Numërimi i votave filloi në orare të ndryshme gjatë gjithë QNV-ve, në përgjithësi, menjëherë pas orës 23:00 më 21 qershor dhe kjo zgjati rreth 2 deri në 4 ditë në pothuajse të gjitha QNV-të, duke përjashtuar qendrën e numërimit që i përket KZAZ-së Nr.1 në Malësinë së Madhe të Qarkut të Shkodrës¹⁴ ku proçesi zgjati më shumë.

Pavarësisht se kishte dy ekipe të numërimit për tryezë, numërimi u shoqërua me ndërprerje dhe vonesa, edhe pse në bazë të Kodit Zgjedhor proçesi i numërimit duhet të vazhdojë pa ndërprerje deri në përfundimin e numërimit për të gjitha kutitë e rregullta të votimit. Vëzhguesit e KZLNDQ-së vërejtën raste ku ekranet e skanimit të votave nuk punuan ose u fikën për periudha më shumë se gjysëm ore.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan disa raste kur persona të paautorizuar ishin të pranishëm në QNV, pavarësisht dispozitave të Kodit Zgjedhor që parashikon se vetëm subjektet e autorizuar nga KQZ-ja mund të marrin pjesë në proçesin e numërimit.

Metoda e centralizuar aktuale e numërimit të votave vërtetoi edhe një herë se është e paefektshme në respektimin e të gjitha afateve ligjore dhe për të siguruar një proçes transparent dhe të hapur të numërimit.

Proçesi i numërimit u mbyll zyrtarisht në datë 28 Qershor, shtatë ditë pas mbylljes së qendrave të votimit, edhe pse Kodi Zgjedhor deklaroi se Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve për çdo ZAZ duhet të nxirren nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës pas votimit¹⁵.

Edhe pse kjo mund të shihet si një përmirësim në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, pritja për rezultatet e zgjedhjeve për një kohë kaq të gjatë është në kundërshtim me standardet

¹⁴Gjatë këtij rasti konkret, njëzet (20) kuti u numëruan në Tiranë, pas vendimit nr. 751 të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të datës 27/06/2015, për shkak të vonesave të shumta dhe ndërprerjet e komisionerëve të QNV. Kutitë e mbetura të KZAZ-së Nr 1 u numëruan nga stafi i KQZ-së në mjediset e shkollës "1 Maji" në Tiranë. Vëzhguesit tanë nuk janë lejuar të ndjekin proçesin.

¹⁵Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Neni 122/1, 123/1
Online: <http://www.osce.org/albania/159501?doenload=true>

ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Qytetarët shqiptarë meritojnë të kenë rezultatet e zgjedhjeve në kohën e duhur, e cila është e përcaktuar edhe në Kodin Zgjedhor.

Konkluzione të tjera të rëndësishme

Mundësi të barabarta për të kandiduar

Kuadri aktual ligjor nuk ofron kushte të barabarta për të gjithë garuesit e zgjedhjeve. Partitë politike, pa vende në koalicionet e mëdha të Kuvendit dhe/ose jashtë koalicionave, si dhe kandidatët e pavarur, duhet të mbledhin një numër të konsiderueshëm firmash mbështetëse (jo më pak se 1% të votuesve në një ZAZ të caktuar), ndërsa koalicionet e mëdha dhe partitë që kanë poste në Kuvend, ose kandidatët e pavarur që mbajnë poste të larta zyrtare, janë të përjashtuar nga ky rregull.

Përveç kësaj, kandidatët e pavarur dhe partitë që konkurrojnë për herë të parë nuk janë të lejuar për të përfituar nga fondet publike për të kryer fushatën e tyre. Neni 87 i Kodit Zgjedhor përcakton se "Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, të cilat kanë marrë jo më pak se 0.5 për qind të votave në mbarë vendin, kanë të drejtë të përdorin fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave të secilës parti në këto zgjedhje."

Përfaqësimi i grave në KZAZ-të e KQV-të

Sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor të sapo ndryshuar, listat për këshilltarë apo për kandidatë ishin të ndara në mënyrë të barabartë midis gjinive, të alternuara në çdo emër të dytë. Gratë mbeten të nënpërfaqësuara në organet drejtuese zgjedhore. Kur bëhet fjalë për KZAZ, KZLNDQ vlerëson faktin se PS-ja dhe PD-ja respektojnë kuotën gjinore të kërkuar nga ligji për përfaqësimin gjinor në komisione në jo më pak se 30 për qind¹⁶, pavarësisht nga zëvendësimi i shpeshtë i komisionerëve para dhe pas datës 22 Maj, 2015¹⁷. Megjithatë, edhe pse dy partitë kryesore respektojnë ligjin, partitë më të vogla nuk e bënë këtë.

Gratë u përfaqësuan në disa pozita udhëheqëse në KZAZ, me 14 (katërmëdhjetë) ose 16% poste kryetarësh, 19 (nëntëmbëdhjetë) ose 21% poste nënkryetarësh e 22 (njëzet e dy) ose 24% në postin e sekretares. Gjatë ditës së zgjedhjeve, gratë nuk ishin të përfaqësuara në 37% të KQV-ve dhe gratë drejtuan vetëm 15% të KQV-ve. Edhe pse kjo nuk është një kërkesë e Kodit Zgjedhor, përfaqësimi i grave në organet e nivelit të tretë zgjedhor mbetet i papërfillshëm.

¹⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29/1/ç përcakton se: "30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe në pushtet dhe partia më e madhe në opozitë do të jenë nga secila gjini."

¹⁷ Që nga 6 Qershori 2015, nga 270 komisionerët e PS-së, 103 (38%) ishin gra; nga 270 komisionerët e PD-së, 87 (32%) ishin gra.

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Nga vëzhgimi u konstatua që 57% e qendrave të votimit në mbarë vendin nuk ishin të aksesueshme për votuesit me aftësi të kufizuara, gjë që është alarmante. Administrata lokale dështoi në përpjekjen për heqjen e pengesave për votuesit me kufizime të lëvizshmërisë, duke dështuar rrjedhimisht në sigurimin e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse dhe promovimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë në to.

REKOMANDIME

Domosdoshmëri për një reformë gjithpërfshirëse zgjedhore

Listat e votuesve

KZLNDQ rekomandon që qeveria shqiptare duhet të marrë masa për krijimin e regjistrave të posaçëm të votuesve për rastet e veçanta të votimit, të tilla si ai i votimit për qytetarët që banojnë jashtë shtetit. Ligji duhet të specifikojë qartë proceset, afatet dhe të gjitha modalitetet se si janë krijuar këta regjistra dhe se si përpilhen listat e veçanta të votuesve duke u kujdesur që emrat e votuesve që futen në këto lista të hiqen nga regjistri i rregullt i votuesve. Për më tepër, duhen ofruar dispozita që administrimi i votimit jashtë shtetit të jetë transparent dhe jo i politizuar.

Fushata Zgjedhore

Partitë politike dhe kandidatët ju ofruan qytetarëve të Shqipërisë një zgjedhje të qartë midis programeve dhe platformave të ndryshme. Megjithatë, duke patur parasysh mangësitë e vëna re gjatë periudhës së fushatës, KZLNDQ ju bën thirrje partive politike që të fillojnë diskutimet publike me të gjitha palët e interesuara, aktorët shtetërorë dhe jo-qeveritare, institucionet vendase dhe të huaja, në mënyrë që të fillojë hartimi i Kodit të Sjelljes për Zgjedhjet, i cili do të rregullojë sjelljen e aktorëve politikë, që përfshin zyrtarët e lartë gjatë zgjedhjeve. Hulumtime të mëtejshme janë të nevojshme në lidhje me praktikat më të mira nga vendet e tjera, për të gjetur një model të përshtatshëm për kontekstin Shqiptar.

Kodi i Sjelljes për zgjedhjet do të shërbejë si një bazë praktike për të kontribuar për zgjedhje të lira e të ndershme dhe do të zhvillojë besim në procesin demokratik për implementimin e qeverisë përfaqësuese dhe do të ndikojë në ndryshimin paqësor. Partitë duhet të jenë të angazhuara në Kodin e Sjelljes, duke e parë atë jo thjesht si një grup rregullash mekanike, por si një grup parimesh për tu respektuar si në frymë ashtu edhe në letër.

Partitë politike duhet të publikojnë historikun e kandidatëve të tyre, në mënyrë që votuesit të kenë mundësinë të shohin angazhimet e tyre profesionale dhe përvojën e mëparshme. KZLNDQ ju bën thirrje partive politike që të mos përfshijnë kandidatët me precedentë penale për të kandiduar për poste. Për më tepër, KZLNDQ rekomandon që partitë politike të tregojnë vullnet serioz politik për të finalizuar dhe për të miratuar ndryshimet ligjore, në mënyrë që të ndalohen personat me precedentë penalë nga të qënit pjesë e ekzekutivit dhe legjislativit të Shqipërisë. Ne kemi nevojë për këtë për hir të stabilitetit, unitetit, mirëqeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.

Përdorimi i hapësirës dhe burimeve publike

KZLNDQ u rekomandon bashkive që t'ju përmbahen në mënyrë rigorozë ligjit për shpërndarjen e drejtë dhe të barabartë të hapësirave të afishimit të materialeve të propagandës.

Për të shmangur çdo keqpërdorim dhe shpërdorim të burimeve publike, si dhe për të siguruar integritetin dhe besimin në procesin zgjedhor, KZLNDQ u bën thirrje autoriteteve lokale dhe qendrore që të përmbahen nga shpërndarja e ndihmave humanitare gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore dhe zgjedhore. Autoritetet duhet të hetojnë çdo formë të shpërndarjes së votave dhe të dhënat e hetimeve duhet të bëhen publike në mënyrë që të mos dëmtohet procesi dhe rezultati i zgjedhjeve.

Inaugurimi i projekteve publike nuk duhet të përdoret për përfitime elektorale. Forcave politike ju kërkohet të ofrojnë një ndarje të qartë midis aktiviteteve të fushatës dhe ngjarjeve të inaugurimit gjatë fushatës zgjedhore.

Organet e Administrimit të Zgjedhjeve

Neutraliteti dhe paanësia e Organeve të Administrimit të Zgjedhjeve (OAZ) duhet të jenë themelet e zgjedhjeve të ardhshme në Shqipëri. Krijimi i OAZ-ve të pavarura dhe të paanshëme është me rëndësi të madhe për vendin. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm në ndërtimin e besimit të elektoratit dhe të partive politike në zgjedhje, për të avancuar me axhendën e integritimit Evropian të vendit.

Në mënyrë që OAZ-të të kryjnë detyrat e tyre në mënyrë efikase, duhet të shpërndahen fonde të mjaftueshme në kohën e duhur dhe komisionerët duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur. Si organe me një rol kritik në sigurimin e administrimit të duhur të zgjedhjeve, ato duhet të jenë të çliruara nga ndikimet politike. Anëtarët e OAZ-ve duhet të jenë të paanshëm dhe të kuptojnë tërësisht procesin zgjedhor dhe kërkesat përkatëse ligjore. Ata duhet, gjithashtu, të kenë aftësi administrative dhe menaxheriale në varësi të pozicionit që mund të mbajnë në komisione.

Ambjentet e OAZ-ve duhet të jenë të pajisura me logjistikën e nevojshme, si lidhje Interneti, telefon fiks, printer, skaner dhe makina fotokopjuese¹⁸. Kjo do të mundësojë që ata të jenë funksionalë gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve, sidomos në situata të tilla si në fillim të zgjedhjeve apo gjatë zgjedhjeve të parakohshme, ose gjatë referendumeve lokale apo kombëtare. Për më tepër, KZLNDQ rekomandon që KQZ-ja të organizojë një Shkollë për Administratorët e Zgjedhjeve në Shqipëri, për të trajnuar dhe për të përgatitur administratorët e zgjedhjeve të ardhshme për të gjitha nivelet, ku qytetarët mund të marrin pjesë, të fitojnë njohuri në administrimin e zgjedhjeve, të çertifikohen dhe të jenë të përgatitur e të trajnuar, plotësisht, për të shërbyer si anëtarë të komisionit të administrimit të zgjedhjeve në të gjitha nivelet, pavarësisht nga anëtarësia partiake. Anëtarët e OAZ-ve duhet të zgjidhen vetëm nga grupi i komisionerëve të trajnuar dhe të çertifikuar, gjë që përfundimisht do të reduktojë problemet e vëna re nga zëvendësimet e komisionerëve.

KZLNDQ rekomandon që KQZ-ja duhet të përditësojë rregullisht (dy herë në ditë gjatë periudhës zgjedhore), Regjistrin online të Ankesave për të rritur transparencën e saj të shqyrtimit administrativ të ankesave zgjedhore.

¹⁸ Të paktën KQZ, KZAZ dhe KZ duhet ti kenë këto kushte/pajisje.

KQZ-ja duhet të ngarkojë online versionin e plotë të skanuar të vendimeve, duke përfshirë edhe nënshkrimet e anëtarëve të saj pasi vendimi është miratuar, në mënyrë që të rrisë informimin e palëve të interesuara dhe të publikut për veprimtarinë e KQZ-së, si dhe të përmirësojë transparencën e KQZ-së. Në këtë drejtim, KQZ-ja mund të ketë një person të dedikuar që ka të bëjë posaçërisht me këtë detyrë gjatë periudhës së zgjedhjeve.

KZLNDQ rekomandon që gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor dhe stafi administrativ duhet të kenë një godinë/strukturë të tyre, që do t'u mundësonte kryerjen e detyrave dhe kompetencave të tyre. Kjo duhet të rregullohet me amendamente legjislative në Kodin Zgjedhor të paktën një vit përpara zgjedhjeve të ardhshme.

Në të njëjtën kohë, KZLNDQ rekomandon që si KQZ-ja, gjithashtu edhe Kolegji Zgjedhor të mund të ofrojnë transmetimin online, në kohë reale, të të gjitha seancave të Kolegjit Zgjedhor, gjë që do të kërkojë më shumë fonde, logjistikë, burime njerëzore dhe kapacitete të tjera.

Në përgjithësi, KZLNDQ rekomandon që OAZ-të duhet t'u përmbahen parimeve demokratike të mëposhtme:

Pavarësi dhe paanshmëri

Anëtarët e OAZ-ve nuk duhet t'u nënshtrohen drejtimit nga ndonjë person, autoritet apo parti politike tjetër, përveç autoriteteve zyrtare zgjedhore. Ata duhet të funksionojnë pa favorizime politike apo paragjykime. OAZ-të duhet të jenë në gjendje të veprojnë pa ndërhyrje. Çdo pretendim manipulimi, perceptim paragjykimi apo dyshim për ndërhyrje, do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në kredibilitetin e organit përgjegjës, por edhe në të gjithë procesin zgjedhor.

Transparencë

Ligji duhet të përmbajë dispozita që KZAZ-të të shpallin publikisht orarin dhe axhendën e takimeve të tyre, në mënyrë që qytetarët apo grupet e interesuara të mund të marrin pjesë. Vendimet e KZAZ-së duhet të bëhen publike dhe ligji duhet të përcaktojë qartë "palët e treta" dhe detyrimet ndaj kësaj kategorie. Në mënyrë që të mos lihet hapësirë për interpretime personale nga komisionerët, ligji duhet të specifikojë kujt i lejohet dhe kujt nuk i lejohet të marrë pjesë në takime.

Efikasitet dhe efektshmëri

Efikasiteti dhe efektshmëria janë komponentë përbërës në besueshmërinë e përgjithshme të zgjedhjeve. Në vend të një buxheti fiks, KQZ-ja duhet të marrë parasysh nevojat specifike të çdo KZAZ-je dhe të përcaktojë buxhetin në përputhje me rrethanat. Ligji duhet të ketë specifikime të qarta se si llogaritet buxheti dhe të ofrojë një afat të arsyeshëm për ndarjen e tij.

Proçesi i numërimit të votave

Një numërim i drejtë dhe transparent i votave është thelbësor për zgjedhjet demokratike. Ky proces kërkon që votat të numërohen, të llogariten dhe rezultatet të finalizohen në prani të

përfaqësuesve të partive dhe të kandidatëve, si dhe të vëzhguesëve të zgjedhjeve. Gjithashtu i gjithë procesi me të cilin përzgjidhet fituesi të jetë krejtësisht i hapur për sytë e publikut¹⁹.

Sipas Kodit Zgjedhor Shqiptar, procesi i numërimit duhet të përfundojë në orën 22:00 pas ditës së zgjedhjeve ose brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit. Ky afat nuk respektohet dhe numërimi vazhdon në afate kohore tej normalitetit. Numërimi është i organizuar në vende të përcaktuara të numërimit nën administrimin e KZAZ-ve. Për këto zgjedhje, u krijuan 90 qendra numërimi, një për çdo KZAZ. Në këtë aspekt, KZLNDQ kërkon një ndryshim në mënyrën e numërimit nga modeli i centralizuar aktual, në një të decentralizuar, ku numërimi kryhet në qendrat e votimit, gjë që do të sjellë më shumë efikasitet dhe transparencë gjatë procesit. Këto ndryshime duhet të testohen në një numër të përzgjedhur të QV-ve eksperimentale në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të 2017. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, sygjeron që votat mundësisht duhet të numërohen në qendrat e votimit, e jo në qendra të posaçme. Sjellja paqësore dhe efikase gjatë hapjes dhe ditës së votimit, në përgjithësi, vërteton se stafi i qendrave të votimit është i aftë të kryejë edhe numërimin në të njëjtën mënyrë. Përveç kësaj, eliminimi i QNV-ve dhe Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) do të mundësojë kujdes në zgjedhjen e komisionerëve të QV-ve të cilët mund të trajnohen për të kryer numërimin. Ky rregullim do të përshpejtojë procesin e numërimit dhe do të shmangë nevojën për të transportuar kutitë e votimit dhe dokumentet shoqëruese, duke reduktuar kështu rrezikun e manipulimeve me kutitë e votimit.

Megjithatë, në qoftë se procesi i numërimit nuk ndryshon për zgjedhjet e ardhshme, pra mbetet njësoj siç është, KZLNDQ rekomandon që numërimi të vazhdojë në mënyrë të pandërprerë derisa procesi të ketë përfunduar dhe rezultatet të publikohen. Ngritja e dy grupeve të numërimit (Grupit A dhe Grupit B) për çdo tryezë numërimi ofron mundësi për ndërrime të tyre, dhe proces të pandërprerë, në mënyrë që të mos krijohen vonesa. KZAZ-të duhet të mos lejojnë ndërprerje të numërimit të fletëve të votimit pa patur një arsye të fortë.

Organizimi fizik i mjediseve të QNV-ve është gjithashtu problematik, pasi nuk ofron transparencë dhe lë pak hapësirë që vëzhguesit të kenë një pamje të qartë të procesit. KZLNDQ rekomandon organizimin e procesit të numërimit në mënyrë që çdo vëzhgues, partiak ose jo-partiak, të jetë në gjendje të shikojë çdo tryezë, dhe jo siç mundësohet aktualisht nëpërmjet monitorëve në largësi. Numërimi është momenti më i rëndësishëm dhe delikat i zgjedhjeve, për këtë arsye transparenca është thelbësore për të gjeneruar besim në këtë proces.

Rekomandime të tjera të rëndësishme

Mundësi të Barabarta për të Kandiduar për Poste Zyrtare

KZLNDQ rekomandon që kuadri ligjor duhet të rishikohet për të reduktuar kërkesat për firma për të kandiduar për poste si kandidat i pavarur, sidomos tani duke marrë parasysh ndarjen e re

¹⁹ Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore. Numërimi dhe tabulimi i votave. Online: <http://www.idea.int/publications/ies/upload/13.%20Counting%20and%20tabulating%20votes.pdf>

territoriale dhe rritjen e numrit të zgjedhësve brenda tyre. Për më tepër, kuadri ligjor zgjedhor duhet të rishikohet për të siguruar mbështetje për përkrahje minimale të financimit publik për partitë e reja, partitë dhe kandidatët e pavarur, që nuk e kanë kaluar pragun zgjedhor. Investimi në këto grupe dhe individë duhet bërë për hir të konkurrencës dhe demokracisë. Duke krahasuar zgjedhjet e fundit parlamentare, partitë e reja apo partitë që nuk e kalojnë pragun zgjedhor nuk morrën fonde publike për fushatën zgjedhore në zgjedhjet lokale, në këtë mënyrë u krijua pengesë për kandidatë të rinj.

Përfaqësimi i Grave

Kodi Zgjedhor i Shqipërisë duhet të ndryshojë për të lehtësuar barazi të plotë të burrave dhe grave në procesin zgjedhor si kandidatë apo administratorë të zgjedhjeve, në mënyrë që të gjithë të mund të shfrytëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të garantuara për pjesëmarrjen zgjedhore dhe publike.

Kodi Zgjedhor duhet të prezantojë të paktën të njëjtat kërkesa për kuotën gjinore për partitë e vogla që janë pjesë e përbërjes së KZAZ-ve. Kuota gjinore duhet të futet për pozitat e nivelit të lartë në KZAZ si postet për kryetar, zëvendëskryetar dhe sekretar.

Në lidhje me përfaqësimin e grave edhe pse 50% e listave të kandidatëve për këshilltarë ishin gra, vetëm 34.6% gra u zgjodhën dhe do të jetë pjesë e këshilltareve të bashkive. Përfaqësimi i grave la për të dëshëruar edhe në nivelin e kryetarëve të bashkive, ku vetëm 9 nga 16 gra candidate u zgjodhën kryetare të bashkive. KZLNDQ u kërkon partive të emërojnë më shumë gra në garat konkurruese. Në këtë kuadër KZLBDQ propozon vendosjen e kuotës prej 40% e të shoqëruar me sanksione në Kodin Zgjedhor për përfaqësimin e më shumë grave në OAZ, vendimmarrje e politikë.

Kodi Zgjedhor duhet të prezantojë, së paku, të njëjtat kërkesa të kuotave gjinore për dy partitë e vogla që janë pjesë e përbërjes së KZAZ-ve. Kuota gjinore duhet të paraqitet për pozitat e nivelit të lartë si kryetar, zëvendës kryetar dhe sekretar në të gjitha nivelet e OAZ-ve.

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Organet e Administrimit Zgjedhor (OAZ) duhet të zbatojnë Kodin Zgjedhor për të siguruar qasje të plotë të votuesve me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Duhet përcaktuar buxhete të veçanta dhe duhet të hartohet një plan veprimi për të adresuar nevojat e votuesve me aftësi të kufizuara. KQZ-ja duhet të sigurojë që të gjitha nismat të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara dhe para ditës së zgjedhjeve. OAZ-të, në bashkëpunim me pushtetin vendor apo institucione të tjera, duhet të vazhdojnë planifikimin dhe vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme për të përshtatur qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara. Për më tepër, KQZ-ja duhet të marrë masa për të siguruar zbatimin e plotë e në kohë të planeve për përdorimin e pajisjeve të veçanta të votimit për zgjedhësit e verbër dhe për kabinat e fshehta të ndryshueshme. KQZ-ja duhet të identifikojë paraprakisht mjete alternative për zgjedhjet e ardhshme që do të lejojë votimin e votuesve që nuk janë në gjëndje të dalin nga shtëpia. OAZ-të duhet të inkurajojnë njësitë e qeverisjes vendore për të marrë masat e nevojshme paraprakisht për të siguruar transportin për votuesit të cilët kanë nevojë për ndihmë për të mbërritur në qendrat e votimit.

HYRJJE

Zgjedhjet e 21 qershorit në Shqipëri u organizuan pas marrjes rishtas të statusit të vendit kandidat nga Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian, çka e sjell vendin një hap më pranë anëtarësimit në BE. Në këtë kontekst, zgjedhjet konsiderohen një test i rëndësishëm për nisjen e bisedimeve për anëtarësim. Siç deklaroi raportuesi për Shqipërinë, në Parlamentin Evropian gjatë një interviste: “Mesazhi numër një është që këto zgjedhje janë një mundësi e mrekullueshme për të treguar se Shqipëria është gati të hapë bisedimet për anëtarësim”²⁰.

Për më tepër, zgjedhjet e vitit 2015 u mbajtën pak kohë pas miratimit të Reformës Administrative Territoriale, votuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 31 korrik 2014. Ndarja e re territoriale çoi në një reduktim domethënës të Njësive të Qeverisjes Vendore (NQV) nga 373 në 61.

Ky raport shënon kulmimin e përpjekjeve vëzhguese dhe monitoruese të Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme dhe Demokraci të Qëndrueshme (KZLNDQ). Projekti i shumanshëm i monitorimit të zgjedhjeve u ideua që të përfshinte aspektet kyçe të procesit zgjedhor, gjatë gjithë etapave përbërëse të tij: atmosfera parazgjedhore, dita e votimit që nga hapja e qendrave të votimit (QV) deri në dorëzimin e materialeve zgjedhore tek Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), numërimi në qendrat e numërimit të votave (QNV) dhe zhvillimet paszgjedhore. Raporti kishte për qëllim t’i siguronte grupeve të interesuara për procesin zgjedhor, informacion të besueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, bazuar në fakte e mbështetur në statistika. Më tutje, objektivi i projektit ishte të denonconte publikisht dhe të parandalonte çdo parregullsi që mund të rrezikonte cilësinë e zgjedhjeve.

Nëntëdhjetë vëzhgues afatgjatë u angazhuan në të gjithë vendin për të monitoruar punën e të nëntëdhjetë Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) gjatë periudhë që i parapriu ditës së votimeve deri në përfundim të procesit të numërimit. Veç tyre, ditën e zgjedhjeve u angazhuan në njëmijë qendra votimi në mbarë vendin edhe një mijë vëzhgues të paanshëm afatshkurtër. Qendrat e votimit që u vëzhguan u zgjodhën përmes një metodologjie kampionimi të hartuar me kujdes²¹, për të garantuar një kampion rastësor dhe përfaqësues, çka i lejoi KZLNDQ-së t’i aplikojë me besueshmëri rezultatet dhe gjetjet në të gjitha QV-të në nivel kombëtar. Për më tepër, treqind vëzhgues përgjatë turneve të ndryshme, monitoruan të nëntëdhjetë QNV-të që prej ardhjes së kutisë së parë të votimit deri në numërimin e më të fundit.

Bazuar në atmosferën e zgjedhjeve vendore 2015, KZLNDQ vendosi të hartojë një plan angazhimi që do të siguronte informacion përfaqësues mbi organizimin e ditës së votimit në nivel kombëtar, por edhe për bashkitë e Tiranës, Shkodrës, Durrësit dhe Himarës, ku gara konsiderohej si veçanërisht konkurruese ose e rëndësishme. Prandaj, kampioni prej 1000 qendrash votimi u nda në mënyrë të barabartë, duke përdorur dy teknikat e mëposhtme të kampionimit.

²⁰ Albanian Daily Neës, 16 qershor 2015. Fleckenstein: Local Elections, opportunity for Albania to open accession negotiations. Online: <http://www.albanianneës.com/index.php?idm=1819&mod=2>

²¹ KZLNDQ përdori metodën e vëzhgimit bazuar në statistika, e cila parashikon monitorimin e një kampioni qendrash votimi dhe siguron informacion statistikisht domethënës dhe të besueshëm mbi cilësinë e procesit të ditës së zgjedhjeve (hapja, votimi dhe mbyllja e qendrave të votimit)

jo parlamentare u ankuan për faktin se procesi nuk ishte gjithëpërfshirës dhe gjykonin se ndarja e re kishte prapavijë elektorale e se gjithashtu ishte kryer pa marrë parasysh specifikat e hapësirave të banuara nga minoritetet, të gjithë aktorët kryesorë vendosën të konkurronin në zgjedhje. Fakti që reforma e decentralizimit u la për më vonë çoi në një mungesë thelbësore diskutimesh ndërmjet të gjithë aktorëve të interesuar dhe publikut në përgjithësi, mbi kompetencat e reja të njësive të qeverisjes vendore dhe ndryshimeve konkrete të sjella nga reforma, përveç fushave që mbulojnë njësitë e reja vendore²⁴.

Zgjedhjet vendore nuk shërbyen vetëm për të zgjedhur administruesit e rinj vendorë. Ato shërbyen, gjithashtu, si një test për mbështetjen që gëzojnë partitë politike përpara zgjedhjeve të përgjithshme të 2017-ës. Partia Socialiste po kërkonte një konfirmim të fitores domethënëse të koalicionit të saj në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës si edhe një tregues se reformat madhore të ndërmarra deri tani gëzonin mbështetje popullore. Partia Demokratike, nga ana tjetër kërkonte ta rimerrte veten nga humbja e pësuar më 2013-ën dhe ta kthente situatën në favorin e vet. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme politike të këtij viti ndërmjet forcave politike bënë që të shtyheshin e të mos respektoheshin afatet kohore të vendimeve të rëndësishme për rregullimin e kuadrit zgjedhor, përfshirë edhe miratimin në minutën e fundit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, çka minoi në mënyrë të drejtpërdrejtë stabilitetin e ligjit elektorale. Sipas standardeve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, elementë të rëndësishëm të ligjit elektorale nuk duhen ndryshuar një vit para zgjedhjeve²⁵.

Mjedisi politik që i parapriu zgjedhjeve ishte i tensionuar, më së shumti për shkak të konflikteve të vjetra mes dy partive më të mëdha. Atmosfera politike u cënuar nga akuza të vazhdueshme mbi kriminalizimin ndërmjet partive politike dhe mungesën e vullnetit për t'u angazhuar në një proces reformimi ligjor mbi këtë çështje. Mosbesimi i përhapur mes partive ishte një kërcënim i vazhdueshëm ndaj organizimit të zgjedhjeve të lira e të ndershme.

KZLNDQ dënon faktin që partitë politike nuk përdorën kohën e mjaftueshme që patën në dispozicion për të konkuruar në zgjedhje kandidatë për kryebashkiakë dhe këshilla bashkiakë që nuk ngrenë dyshime mbi integritetin dhe besueshmërinë e tyre. Qytetarët e Shqipërisë meritojnë të zgjedhin ndërmjet kandidatësh me rekorde të pacena.

Kuadri ligjor

Zgjedhjet vendore të 2015-ës u mbajtën nën një kuadër të shëndoshë ligjor të bazuar në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor. Dispozitat e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor mbështeten nga vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së. Legjislacioni tjetër në fuqi përfshin ligjin “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”²⁶, ligji

²⁴ Një sondazh i Zërave të Qytetarëve mbi Reformën Territoriale Administrative, kryer nga IDRA tregon se shumica e qytetarëve ndjehet e painformuar. Veçanërisht 65% u përgjigjën se ndjehen të painformuar, 22% ndjehen të informuar dhe 13% të mbetur ndjehen mesatarisht të informuar. Për më shumë informacion mbi rezultatin e sondazhit shih raportin këtu: <http://www.idra.al/files/reports/Hyrje%20&%20Permbledhje%20Ekzekutive%20%20FINAL.pdf>

²⁵ Për më shumë informacion shih “Kodin e Praktikave të Mira mbi Çështjet Zgjedhore” – Komisioni i Venecias, Opinion Nr. 190/2002, II./2/b, fq. 10.

²⁶ Ligji 115/2014

“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, ligji “Për Partitë Politike”, Kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi Penal.

Shqipëria garanton të drejta votimi universale dhe të barabarta për çdo shtetas mbi 18 vjeç. Shtetasit kanë të drejta votimi të barabarta dhe çdo votues ka një votë. Kjo e drejtë themelore garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe Kodi Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor u ndryshua në prill 2015 për të pasqyruar ndarjen e re të njësisve të qeverisjes vendore. Sa i përket përfaqësimit gjinor në listat e partive dhe koalicioneve konkurruese u bënë ndryshime të rëndësishme, sipas të cilave, listat shumëmemore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë duhet të përmbajnë 50 përqind të secilës gjini dhe çdonjëri në dy emra duhet t'i përkasë së njëjtës gjini²⁷. Listat që nuk e përmbushin kushtin e përfaqësimit gjinor nuk pranohen për regjistrim nga KQZ-ja²⁸.

Rezultatet e zgjedhjeve

Në zgjedhjet vendore të 21 qershorit morën pjesë në votime 1,613,054²⁹ vetë për kryetar bashkie (ndërsa për këshilltarët bashkiak vetëm 1,612,217) nga 3,372,471 qytetarë të regjistruar në listat e votimit. Ata votuan në 5,301³⁰ qendra votimi në të gjithë vendin. Pjesëmarrja në përqindje në zgjedhje është 47.83. Pjesëmarrjen më të madhe në votime, në shkallë qarku, e pati Kukësi me 58.79% dhe më të voglën qarku i Vlorës me 36.75%. Numri i grave që morrën pjesë në votime është 678,298 ose 42% e atyre që votuan.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u regjistruan 63 parti dhe 14 candidate të pavarur për Kryetar Bashkie dhe 12 për anëtar të Këshillit Bashkiak. U krijuan dy koalicione të mëdha, ai i Aleancës për Shqipërinë Europiane më 37 parti dhe ai i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet me 15 parti. Gara e vërtetë elektorale u zhvillua ndërmjet dy koalicioneve qoftë për kryetarët e bashkive ashtu edhe për këshillat respektivë. Në përfundim të votimit proporcional për këshillat votat u ndanë, për të dy koalicionet, Aleanca për Shqipërinë Europiane me 991,609 ose 63.48% dhe Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet me 507,285 vota ose 32.47%.

Nëse do ti referoheshim votave për secilën parti, ato do të rrjeshtoheshin: PS e para me 402,709 (25.78%), PD 317,620 (20.33%), LSI 259,934 (16.64%), PDIU 59,701 (3.82%), PR 53,784 (3.44%), e të tjerat me rradhë.

Koalicioni ASHE-së fitoi në 45 bashki, ndërsa APPD në vetëm 15 bashki. Një bashki, ajo e Finiqit, është fituar nga kandidati i Partisë MEGA. Për garën për kryetar bashkie është për tu theksuar që kandidati i pavarur Gjergji Bojaxhi, që garoi në Tiranë, morri 16056 vota (5.37%), duke u renditur i treti, për sasinë e votave, pas dy kandidatëve të koalicioneve, Erjon Veliaj (ASE) me 160,235 vota (53.58%) dhe Halim Kosova (APPD) me 116,628 vota (39.00%) .

Në garën për kryetar bashkie morrën pjesë 17 candidate gra ku 9 prej tyre fituan dhe do të drejtojnë bashkitë e Shkodrës, Gjirokastrës, Sarandës, Prrenjasit, Gramshit, Patosit, Libohovës, Urës Vajgurore dhe Roskovecit, dmth rreth 15% të bashkive të vendit.

²⁷ Neni 67 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar

²⁸ Neni 175 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar

²⁹ Këto të dhëna mbi zgjedhjet janë marrë në faqen zyrtare të KQZ, <http://results.cec.org.al/Results/LocalMayor?cs=sq-AL&r=r&rd=r1#>.

³⁰ Nuk janë përfshirë në tabulatet përfundimtare të KQZ katër QV në qarqet e Shkodrës, Lezhës, Tiranës dhe Elbasanit për këshilltarët dhe tre QV për kryetar në qarqet e Lezhës, Tiranës and Korçës për parregullsi në kutitë respektive të votimit.

Megjithëse Kodi Zgjedhor shprehet “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t’i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 164, të këtij Kodi³¹.” rezultati përfundimtar i Zgjedhjeve Vendore 2015 tregoi se 552 gra do të jenë anëtare këshillash nga 1595 këshilltarë në të 61 bashkitë ose 34.6 %.

Një aspekt pozitiv i këtyre zgjedhjeve ishte fakti se partitë dhe kandidatët që humbën garën përgjithësisht i pranuan rezultatet. Disa prej kandidatëve që humbën garën si Halim Kosova në Tiranë, Keti Bazhdari në Shkodër dhe Enkelejd Alibeaj në Fier madje i uruan rivalët e tyre, duke sjellë kështu një model të ri sjelljeje në këtë aspekt. Gjithsesi, duhet përmendur se disa subjekte zgjedhore, më së shumti parti të vogla kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesa ankimore në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve, përfshirë edhe ankesën e paraqitur nga Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila kundërshton rezultatin në Vorë.

GJETJE DHE ANALIZE

KZLNDQ vëzhgoi nga afër procesin e zgjedhjeve vendore të 2015-ës gjatë fazës parazgjedhore, ditës së votimit, dhe periudhës paszgjedhore nëpërmjet vëzhguesve afatgjatë, atyre afatshkurtër dhe një grupi ekspertësh në zyrat qendrore të KZLNDQ. Ky seksion paraqet gjetjet mbi secilën prej tre fazave të vëzhguara.

Periudha Parazgjedhore

KZLNDQ e nisi monitorimin e periudhës parazgjedhore më 22 maj 2015, me hapjen zyrtare të fushatës zgjedhore. Vëzhguesit e KZLNDQ-së monitoruan KQZ-në dhe Kolegjin Zgjedhor si edhe dërguan raporte javore në lidhje me administrimin e nëntëdhjetë Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), mbi praktikën e përgjithshme të fushatës zgjedhore dhe përdorimin e burimeve publike nga partitë politike dhe kandidatët.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Ekspertët e KZLNDQ-së monitoruan të gjitha mbledhjet e KQZ-së që prej 1 qershorit 2015 në lidhje me transparencën, vendimmarrjen për Bordin e Monitorimit të Medias, listat e votuesve, zëvendësimin e komisionerëve dhe ankesat në nivel administrativ lidhur me aktivitetin e KQZ-së, siç parashikon edhe Kodi Zgjedhor³². Monitorimi i transparencës së veprimtarisë së KQZ u përqendrua në njoftimin paraprak të kohës së zhvillimit të mbledhjeve, njoftimin e përfaqësuesve të partive politike, shpërndarjen e axhendës tek të gjitha palët e interesuara, përfshirë përfaqësuesit e partive politike, mediat dhe vëzhguesit përpara fillimit të mbledhjeve të KQZ-së, si edhe botimin/bërjen publike të vendimeve të KQZ-së me qëllim informimin e palëve të interesuara dhe të publikut.

³¹ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/51-2015.pdf

³² Neni 22 i Kodit Zgjedhor.

Ekspertët e KZLNQ-së vëzhguan se KQZ, përgjithësisht, përmirësoi dhe rriti nivelin e transparencës dhe aksesit të publikut në aktivitetet e saj duke i transmetuar të gjitha mbledhjet në internet në kohë reale, megjithatë vendimet e KQZ nuk ishte e mundur të gjendeshin online në formë të shkruar ose skanuar.

Kështu, KQZ e ka rritur transparencën e mbledhjeve të saj duke njoftuar rregullisht dhe në kohë aktorët e interesuar dhe publikun përmes postës elektronike dhe mjeteve të tjera të informacionit; rendi i ditës publikohej paraprakisht në faqen e internetit të KQZ si dhe njoftohej nga zëdhënësja e institucionit, kështu përfaqësuesit e partive politike, media dhe vëzhguesit janë njoftuar në kohë mbi aktivitetet e radhës.

Mbledhjet e KQZ-së u zhvilluan në kohë dhe media e aktorë të tjerë të interesuar e patën akses të plotë për t'i ndjekur, pasi mbledhjet janë transmetuar drejtpërsëdrejti në kohë reale në faqen zyrtare të internetit të KQZ. KQZ ka diskutuar mbi çdo çështje që ishte parashtruar në rendin e ditës, duke i dhënë mundësinë përfaqësuesve të partive politike të paraqisnin qëndrimet e tyre përpara marrjes së vendimeve.

Udhëzimet e KQZ-së³³ mbi çështjet dhe procedurat që lidhen me administrimin e zgjedhjeve u miratuan në mënyrë unanime. Disa vendime të KQZ u miratuan me shumicë të thjeshtë të vetëm katër anëtarëve të saj. Këto vendime u vunë re kryesisht në çështje të debatueshme si për shembull vendimi mbi çregjistrimin e kandidatëve³⁴, vendimi mbi partitë politike që kishin të drejtë të merrnin pjesë në shortin për përzgjedhjen e anëtarëve të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave³⁵ dhe një vendim mbi vlerësimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias për të kompensuar kohën e transmetimit për partitë politike.

Axhenda e ngarkuar parazgjedhore e KQZ-së ishte, gjithashtu, e lidhur me pretendimet nga ana e përfaqësuesve të partive politike mbi listat e votuesve të fryra “artificialisht” në Durrës³⁶,

³³ Udhëzimet e KQZ-së që kishin të bënin me procedurat për marrjen në dorëzim të kutive të votimit nga skuadrat përkatëse, “Caktimi i grupeve të numërimit, përbërja dhe procedurat e numërimit”, “ Për krijimin dhe funksionimin e Komisioneve të Qendrave të Votimit” si edhe Udhëzimi “Për mbledhjen e të dhënave dhe rezultatet paraprake zgjedhore” u miratuan unanimit. Gjithashtu, u miratuan unanimit edhe vendimet e KQZ-së nr. 588, 28 maj 2015 “Për miratimin e përdorimit të mjeteve të posaçme që u lejon personave që nuk shohin të lexojnë fletën e votimit” dhe vendimi nr. 578, 26 maj 2015 për miratimin e Manualit të Grupeve të Numërimit. Të gjitha udhëzimet e KQZ-së mund të gjenden në faqen e internetit të institucionit <http://www2.cec.org.al/sq-al/Udh%C3%ABzime-2015>.

³⁴ Rast i Kurbinit ishte rasti më i kontestuar por gjithashtu edhe më polemiku sa i përket çregjistrimit të kandidatëve në zgjedhjet për kryetarë bashkie; ky problem u pasqyrua gjithashtu edhe në rastet e tjera të kërkesave për tërheqjen e kandidatëve. Argumentimi thelbësor i KQZ-së mbi këtë çështje ishte se KQZ-ja nuk mund të miratonte kërkesat për tërheqja nga gara të kandidatëve pas afatit ligjor të regjistrimit; ky arsytim u reflektua në tre raste: rastin e Kurbinit kur KQZ-ja vendosi me shumicë të thjeshtë të mos e marrë parasysh kërkesën e kandidatit për tërheqje nga gara, në Kuçovë dhe në Dropull.

Në tri raste të tjera të ngjashme, KQZ-ja vendosi që të pranojë kërkesat e kandidatëve për t'u tërhequr nga gara; në Memaliaj ku kërkesa për tërheqjen e kandidatit të pavarur u pranua me arsytimin se në rastet me një numër të madh kandidaturash (shtatë) konfigurimi i fletës së votimit e bënte të vështirë mbledhjen dhe shtypjen e emrave në një fletë të vetme (Vendimi nr. 608 i KQZ-së). E njëjta situatë ndodhi edhe në Sarandë, ku kandidati për kryetar bashkie mbështetur nga Partia Etnike e Minoritetit Grek paraqiti në KQZ një kërkesë formale tërheqjeje të noterizuar dhe KQZ-ja vendosi të miratojë kërkesën për tërheqje (Vendimi Nr. 609 i KQZ-së). Në Këlcyrë, koalicioni APPD i kërkoi KQZ-së çregjistrimin e kandidatit të vet për shkak të rekordeve të shkuara kriminale të tij; kandidati nuk ishte dakord me këtë kërkesë, por KQZ-ja vendosi unanimitas ta çregjistrojë kandidatin e Këlcyrës sipas kërkesës së koalicionit (Vendimi nr. 625).

³⁵ KQZ vendosi që anëtari i tretë duhet t'i përkasë LSI-së dhe i katërti Partisë Republikane, duke lënë kështu jashtë grupeve të numërimit të votave PDIU-në.

³⁶ Për Durrësin, u ndërmor një hetim nga ana e Prokurorisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë e Durrësit vendosi ndalimin e të gjitha veprimeve të mëtejshme të Drejtorisë së Gjendjes Civile së Durrësit mbi një listë njerëzish për të cilët Prokuroria pretendonte se ishin regjistruar si banorë të qytetit me dokumente të rreme, vendim ky që nuk preku listën e votuesve; deri më tani, informacioni mbi vendimin specifik të Gjykatës nuk është bërë ende publik në sajë të çështjes së mbrojtjes së të dhënave të një nëpunësi të

Vorë³⁷, Kavajë dhe Tiranë³⁸, si edhe mbi listat e posaçme të votuesve në qendrat e vuajtjes së dënimit. Hartimi i listave të votuesve është kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile³⁹, nën mbikëqyrjen e KQZ-së, prandaj KQZ kërkoi informacion zyrtar nga institucionet kompetente dhe mbajti takime të hapura informuese me Drejtorin e Përgjithshëm të Gjendjes Civile dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve. Në të dy këto takime, KQZ nuk mori asnjë vendim në lidhje me listat e votuesve, duke shpjeguar se Kodi Zgjedhor nuk e lejon mundësinë për rishqyrtim të listës së votuesve pas finalizimit të tyre.

KQZ shqyrtoi të gjitha raportet javore të Bordit të Monitorimit të Medias dhe në të gjitha rastet i miratoi plotësisht gjetjet e tyre⁴⁰. Për shkeljet e raportuara nga Bordi i Monitorimit të Medies, KQZ mori në shqyrtim provat dhe i adresoi ato duke vendosur gjoba në tre raste⁴¹ ndërsa për rastet e tjera duke i urdhëruar operatorët mediatikë të ndërprisnin shkeljet dhe të kompensonin kohën e transmetimit ndaj subjekteve zgjedhore të cënuara nga këto shkelje. Zbatimi i këtyre sanksioneve administrative mbetet problem duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk parashikon rregulla të hollësishme mbi këto çështje dhe KQZ nuk ka kompetenca/autoritet të qartë për të mbikëqyruar zbatimin e tyre. Në këtë aspekt, janë të nevojshme disa ndryshime ligjore për ta bërë Kodin Zgjedhor edhe më të detajuar për të adresuar çështjen së raportit përpjesëtimor (parimi i proporcionalitetit) të gjobave për shkeljet e operatorëve mediatikë si dhe për ekzekutimin e gjobave.

Një problem me të cilin u ballafaqua KQZ gjatë periudhës parazgjedhore ishte ndërrimi i vazhdueshëm i komisionerëve të KZAZ-ve deri në minutën e fundit. Një praktikë e tillë u vu re edhe pas ditës së zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave. Deri në ditën e zgjedhjeve, pati 272 zëvendësime komisionerësh dhe 48 prej tyre u zëvendësuan pasi ishin trajnuar nga KQZ-ja. Arsyeja për ndryshimet e ashtuquajtura “të minutës së fundit” ka të bëjë me faktin se komisionerët emërohen nga partitë politike dhe përbërja e KZAZ-ve dhe KQV-ve varet vetëm nga urdhrat dhe vullneti i partive politike. Ky problem është vërejtur edhe gjatë zgjedhjeve të mëparshme të përgjithshme dhe vendore. Në rrethana të tilla KZLNDQ sugjeron që komisionerët e KZAZ-ve të mos emërohen më nga partitë politike.

Sa i përket trajnimeve të komisionerëve të KZAZ-ve dhe atyre të qendrave të votimit, KQZ-ja organizoi një sërë trajnimesh në mbarë Shqipërinë, sado që jo të gjithë komisionerët i ndoqën të gjitha sesionet e trajnimeve. Veç kësaj, KQZ-ja përgatiti dhe publikoi në faqen e saj të internetit

Zyrës së Gjendjes Civile dhe një noteri të përfshirë. KZLNDQ vlerëson se vendimi i gjykatës duhet të bëhet publik pa identitetin e personave të prekur, duke qenë se kjo çështje ndikon në procesin zgjedhor dhe rasti në fjalë ka të bëjë me një çështje shumë të diskutueshme.

³⁷ Prokuroria nisi gjithashtu një hetim edhe për Vorën; dy oficerë të policisë gjyqësore sekuestruan regjistrin e gjendjes civile më 17 qershor, por deri në tani nuk ka asnjë informacion mbi statusin e hetimeve.

³⁸ Për Kavajën dhe Tiranën pati akuza nga partitë politike se qytetarë ishin regjistruar në zonat e mbuluar nga KZAZ-të, por deri tani nuk jepet informacion në ka një hetim zyrtar.

³⁹ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është një institucion nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

⁴⁰ KQZ-ja i miratoi unanimisht të gjitha raportet javore të Bordit të Monitorimit të Medies, përveç njërit prej tyre që u miratua me shumicë të thjeshtë.

⁴¹ Televizionet lokale Antena Nord, Vlora Channel (15.06.2015) dhe Skampa TV (24.06.2015) u gjobitën. Arsyeja përse KQZ-ja nuk u tregua “shumë dorëlëshuar” në vendosjen e gjobave për transmetimin e fushatës zgjedhore nga mediet ishte sepse niveli i gjobave që parashikon Kodi Elektorale rezultoi shumë i lartë dhe kështu vendosja e tyre (strikt sipas ligjit) do të ishte shumë e lartë dhe do të çonte në falimentimin e televizioneve.

një video trajnuese me udhëzime mbi procesin dhe procedurat e ditës së votimit⁴² për komisionerët e qendrave të votimit, e cila ishte lehtësisht e aksesueshme për këdo që vizitonte faqen e internetit të KQZ-së.

Kërkesat ankimore administrative

Deri në fund të muajit korrik 2015, KQZ ka shqyrtuar në mbledhje të hapura mbi 120 kërkesa ankimore administrative në lidhje me vendimet e KZAZ-ve dhe të KQZ-së, prej të cilave 112 janë pasqyruar online. KZLNDQ ka monitoruar vazhdimisht mbledhjet e KQZ ku janë shqyrtuar kërkesat ankimore, procesin e vendimmarrjes dhe aftësinë e KQZ-së për t'i bërë publike këto vendime dhe për të dhënë informacion të hollësishëm mbi ecurinë e kërkesave ankimore.

KZLNDQ vëzhgoi se, në përgjithësi, ishte e vështirë për subjektet që kishin paraqitur kërkesa ankimore të ndiqnin ecurinë e tyre online. Pavarësisht ekzistencës së regjistrimit të kërkesave ankimore⁴³ në faqen e internetit të KQZ-së, regjistri nuk përmbante informacion të përditësuar mbi kërkesat ankimore paszgjedhore⁴⁴, prandaj rezultoi e vështirë marrja/pasja e një informacioni të saktë mbi numrin e kërkesave ankimore të depozituara pranë KQZ. Ky informacion jepej më së shumti nga mediat ose nga transmetimet online të mbledhjeve të KQZ-së.

Edhe në fazën paszgjedhore, KQZ vazhdoi të reflektojë të njëjtin problem që KZLNDQ vërejti në Raportin Paraprak lidhur me mungesën e transparencës mbi votat/mënyrën e votimit të anëtarëve të KQZ. Informacioni mbi votimin e anëtarëve të KQZ-së u mor nga monitorimi i mbledhjeve të KQZ dhe nga media, por nuk është ende i disponueshëm në faqen e internetit të institucionit në versionin e skanuar të vendimeve, ku reflektohet nëse anëtarët e KQZ-së kanë votuar pro apo kundër. Kjo është dicka që KQZ duhet ta marrë në konsideratë për ta përmirësuar përsa i takon publicitetit dhe transparencës së aktiviteteve të saj.

Kolegji Zgjedhor

KZLNDQ monitoroi aktivitetin e Kolegjit Zgjedhor përmes mbulimit të tij nga media dhe botimit online të vendimeve të tij. Kolegji Zgjedhor gjykon ankesat e subjekteve zgjedhore kundër vendimeve të KQZ, që prekin interesat e tyre ligjore; e drejta e ankimit i njihet gjithashtu edhe individëve dhe partive politike për të ankimuar vendimet e KQZ kur kjo e fundit refuzon t'i regjistrojë si subjekte zgjedhore, brenda një afati kohor prej 5 ditësh pas shpalljes së vendimit. Veprimtaria e Kolegjit Zgjedhor ishte më e ngjeshur kryesisht me ankime parazgjedhore, lidhur me procedurat e regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentet e nevojshme për t'u regjistruar, kërkesa për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatët që nuk kishin mandate, apo

⁴² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve <http://www.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Video-Trainimi-KQV>

⁴³ Regjistri i Ankimeve / Register of Complaints <http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rregjistri/Rregjistri%20i%20Ankimeve%20para.pas%20Zgjedhjeve%202015%20ne%20KQZ.pdf>

⁴⁴ Në KQZ është i pasqyruar informacioni mbi kërkesat ankimore administrative deri më dt. 2 qershor 2015.

përfaqësim në njësitë e qeverisjes vendore⁴⁵. Vetëm tre ankime të periudhës parazgjedhore nuk lidheshin me procedurat e regjistrimit të kandidatëve; një ankim u depozitua kundër vendimit të KQZ që përcaktonte partitë politike që duhet të kishin të drejtën e emërimit të anëtarëve të tretë dhe të katërt në grupet e numërimit të votave dhe dy të tjerat kishin të bënin me procesin e përpilimit të listave të votuesve bazuar mbi një falsifikim të supozuar⁴⁶ dhe me fryrjen artificiale të listave të votuesve me qëllime elektorale.

Kolegji Zgjedhor ka gjykuar 38 çështje / ankime zgjedhore⁴⁷. Gjatë periudhës parazgjedhore, krahasuar me zgjedhjet e mëparshme pati një rritje⁴⁸ të ankimeve në lidhje me konfliktet parazgjedhore, veçanërisht të rasteve që lidheshin me regjistrimin e kandidatëve. 23 vendime të Kolegjit Zgjedhor kanë të bëjnë me konflikte parazgjedhore.

Në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë⁴⁹ janë publikuar të gjitha vendimet e dhëna nga Kolegji Zgjedhor, megjithatë publikimi i plotë i tyre nuk u arrit të realizohej deri në shpalljen rezultativit përfundimtar të zgjedhjeve. Vendimi me Nr. 25 nuk rezultoi i hedhur në këtë faqe.

Në përgjithësi, Kolegji Zgjedhor ka lënë në fuqi vendimet e KQZ (në 20 raste) dhe ka hedhur poshtë vetëm 6 prej tyre; në 3 raste të tjera, Kolegji Zgjedhor ka urdhëruar KQZ të marrë vendim, për 3 çështje Kolegji ka vendosur pushimin e plotë të gjykimit ndërsa për 2 çështje ka vendosur pushimin e pjesshëm të gjykimit (në një prej tyre KQZ ka urdhëruar KQZ të marrë një vendim); për 3 çështje të tjera Kolegji Zgjedhor ka pushuar gjykimin dhe ka dërguar çështjet në Gjykatën Administrative për shqyrtim të mëtejshëm⁵⁰. Kolegji i ka gjykuar çështjet brenda afateve ligjore⁵¹. Seancat gjyqësore të zhvilluara nga Kolegji Zgjedhor kanë qenë publike, në prani të mediave dhe palët janë njoftuar sipas parashikimeve ligjore, por ato nuk janë transmetuar online si mbledhjet e KQZ, edhe pse vendimet e Kolegjit janë vendime të formës së prerë dhe zgjidhin në mënyrë përfundimtare çështjet zgjedhore.

Palët u informuan mbi vendimet e Kolegjit Zgjedhor gjatë seancave dhe përgjithësisht përmes mediave, duke qenë se vendimet u reflektuan online me një vonesë prej më shumë se pesë ditësh

⁴⁵ Neni 67 mbi “Listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive” dhe Neni 68 mbi “Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve” të Kodit Zgjedhor.

⁴⁶ Ky ishte rasti i apeleve për bashkitë e Durrësit dhe Kavajës ku u ndërmor një hetim nga ana e Prokurorisë mbi fenomenin e fryrjes artificiale të listave të votuesve.

⁴⁷ 38 vendime të Kolegjit Zgjedhor lidhen me zgjedhjet vendore të 21 qershorit dhe një vendim ka të bëjë me një referendum vendor (janar, 2015).

⁴⁸ Gjatë kohës që shërbenin si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, gjykatësit merreshin gjithashtu edhe me çështjet e tyre të përditshme në gjykatat respektive, duke qenë se ato gjykojnë edhe çështje jozgjedhore në panele prej tre gjyqtarësh ku shtyrja e gjyqeve është e vështirë të bashkërendohet; në këto rrethana atyre u është shtuar ngarkesa e punës.

⁴⁹ <http://www.gjykataeapelitirane.al/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=91>

⁵⁰ Nga 38 vendime të Kolegjit Zgjedhor botuar online në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit të Tiranës:

- 10 vendime të Kolegjit Zgjedhor lanë në fuqi vendimet e KQZ-së
- 6 vendime të Kolegjit Zgjedhor hodhën poshtë vendimet e KQZ-së,
- 3 çështje iu dërguan për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë,
- në 3 raste Kolegji Zgjedhor e pushoi çështjen plotësisht,
- në 2 raste Kolegji Zgjedhor e pushoi çështjen pjesërisht
- 3 vendime të Kolegjit Zgjedhor e urdhëruan KQZ të merrte vendim
- 1 vendim i Kolegjit Zgjedhor (Vendimi 25) pjesërisht nuk gjendet i publikuar

⁵¹ Dhjetë ditë nga depozitimi i kërkesës për ankim.

- 500 nga 5 301 QV-të u kampionuan për përfaqësim kombëtar me një kufi gabimi²² të barabartë me ± 4.1 përqind, me interval besueshmërie 95 përqind;
- Për më tepër, u përzgjedhën edhe 500 QV plotësuese, për të mundësuar krahasimin me nëngrupe të bashkive të Tiranës (të kampionuara 270 nga 864), Shkodrës (150 nga 245) dhe Durrësit (180 nga 310), me një kufi gabimi të barabartë me ± 4.9 përqind dhe interval besueshmërie 95 përqind.

Të gjithë vëzhguesit (qytetarë të paanshëm) u trajnuan, testuan dhe pajisën me instrumente sondazhi, manuale, akreditimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe materiale të tjera të nevojshme. Gjatë qëndrimit në vendet e tyre të përcaktuara, ata ishin të përgatitur të raportonin mbi situatën në përgjithësi si edhe mbi incidentet që mund të lindnin gjatë procesit të votimit.

Një vështrim i përgjithshëm mbi zgjedhjet

Më 21 qershor 2015, 3 370 206²³ votues shqiptarë patën mundësi të shprehnin vullnetin e tyre politik duke votuar në një prej 5301 qendrave të votimit për të zgjedhur 61 kryebashkiakë dhe 1595 anëtarë të këshillave bashkiakë, sipas një ndarjeje të re, të reduktuar bashkiake.

Konteksti politik

Në qershor 2014 u hodh një hap i rëndësishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, kur vendit iu dha statusi kandidat pas disa përpjekjesh të dështuara. Zgjedhjet e 21 qershorit u mbajtën në kontekstin e statusit të fituar dhe perspektivës për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në një të ardhme të afërt. Organizimi i zgjedhjeve që përmbushin standardet ndërkombëtare për garantimin e votës së lirë dhe të ndershme ka qenë një nga kushtet kyçe të BE-së. Raporti i progresit 2014 i Komisionit Evropian lexon: “*Bazuar në përparimin e shënuar në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës, Shqipëria duhet të zbatojë rekomandimet e misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR, veçanërisht forcimin e pavarësisë së organeve administruese të zgjedhjeve në kohë për zgjedhjet vendore të 2015-ës*”. Mbajtja e zgjedhjeve formëson në një afat të gjatë, jetën politike në vend dhe gjithashtu ndikon në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit evropian. Prandaj, ishte e rëndësishme që këto zgjedhje të pasqyronin edhe njëherë pjekurinë e klasës politike shqiptare.

Këto ishin zgjedhjet e para vendore që u mbajtën pas miratimit të Reformës Administrative Territoriale (RAT) nga Kuvendi i Shqipërisë më 2014-ën. Niveli i parë i qeverisjes vendore do të përbëhet tashmë nga 61 bashki, në vend të 373 njësive (65 bashki/njësi urbane dhe 308 komuna/njësi rurale). Sa i përket drejtuesve vendorë, RAT solli uljen e numrit të tyre nga 373 në 61 dhe të anëtarëve të këshillave bashkiakë nga 6 152 në 1 595. Megjithëse opozita dhe disa parti

²² Teknikisht, një gabim kampionimi në kufij $\pm 4.1\%$ do të thotë se nëse përsëritet në kampione të tjera të kësaj madhësie, 95% e tyre do t'i pasqyronin rezultatet me pasaktësi jo më të madhe se $\pm 4.1\%$

²³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve: <http://www.2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/QV/150529-DTI->

pune, prandaj e drejta për akses në gjykata si edhe standardi i transparencës për zbardhjen e vendimeve gjyqësore mbi çështjet zgjedhore që ndikojnë procesin, nuk u respektuan plotësisht.

Në kryerjen e punës së tyre, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor varen nga mjediset, personeli dhe logjistika e Gjykatës së Apelit të Tiranës⁵². Sekretarët e Kolegjit nuk u trajnuan paraprakisht mbi procedurat zgjedhore dhe nuk kanë pasur ndihmës ligjorë që t'i asistojnë gjyqtarët; këto situata përbëjnë shkak për vonesa në të gjitha fazat e gjykimit dhe mungesë profesionalizmi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, duke sjellë ulje të efikasitetit dhe performancës së përgjithshme të Kolegjit Zgjedhor. KZLNDQ sugjeron që Kolegji Zgjedhor të ketë infrastrukturën e vet fizike dhe personelin (ndihmës ligjorë, sekretarë gjyqësorë dhe staf të teknologjisë së informacionit/IT) për të pasur një performancë më të mirë e më efektive.

Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve

Më 22 maj 2015, KZLNDQ angazhoi nëntëdhjetë vëzhgues afatgjatë në secilën prej nëntëdhjetë ZAZ-ve për të monitoruar aktivitetin e KZAZ-ve gjatë përgatitjeve parazgjedhore deri më 21 qershor 2015, ditën e zgjedhjeve vendore. Vëzhguesit afatgjatë u trajnuan të monitoronin shpeshitë e takimeve të secilës prej KZAZ-ve, cilësinë e vendimmarrjes, transparencën, respektimin e ligjit dhe burimeve. Nga 22 maji deri më 20 qershor, vëzhguesit afatgjatë të KZLNDQ vëzhguan personalisht 653 takime të KZAZ-ve dhe dërguan informacion për gjithsej 845 takime. Bazuar në vëzhgimin afatgjatë, KZLNDQ arrin në përfundimin se takimet dhe aktivitetet e KZAZ-ve janë mbajtur në një atmosferë të qetë dhe të rregullt. Ato përgjithësisht kanë reflektuar shpirt bashkëpunimi mes anëtarëve të komisionit dhe kanë ofruar informacion të vlefshëm mbi procedurat e përgjithshme të zgjedhjeve. Gjithsesi, vëzhguesit afatgjatë raportuan edhe një sërë problemesh në punën e KZAZ-ve, që vinin si rezultat i mungesës së përgatitjeve të duhura, shpeshitë së lartë të zëvendësimit të anëtarëve të KZAZ-ve nga ana e partive politike dhe një numër vështirësish teknike që mund të shmangen lehtësisht gjatë zgjedhjeve të ardhshme.

Formaliteti i takimeve të KZAZ-ve

Në thuajse të gjitha KZAZ-të nuk u respektua programi⁵³ për veprimet e komisionit. Siç u vu re edhe gjatë periudhës së raportimit, në 25 KZAZ ishte praktikë e zakonshme që një sërë takimesh të mbaheshin nëpërmjet telefonit ose në hapësira jashtë zyrave të KZAZ-ve⁵⁴. Në shumë raste vendimet u morën jashtë takimeve të KZAZ-ve dhe komisionet mblidheshin sipas kërkesave protokollare vetëm kur iu duhej të firmosnin vendimet e tyre.

Sipas intervistave me komisionerët, justifikimi kryesor që jepej për këto praktika ishte ngarkesa e punës me të cilën përballeshin anëtarët e komisioneve, të cilit kishin punët e tyre të përditshme e

⁵² Kolegji Zgjedhor është i vendosur në Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila duhet t'i vënë në dispozicion hapësirë, mjete dhe personel të mjaftueshëm për të kryer detyrat e veta.

⁵³ Udhëzimi i KQZ-së nr. 2, datë 25.2.2009, neni 18/1 përcakton se: "Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja punon paradite nga ora 08.00 – 13.00 dhe mbasdite 16.00 - 20.00"

⁵⁴ Ibid, neni 20/1 përcakton se: "Mbledhjet e KZAZ-së janë publike. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e saj të punës."

kështu e kishin të vështirë të mbulonin njëkohësisht dy pozicione. Ia vlen të përmendet që të tilla praktika ndaluan gjatë javës së fundit përpara ditës së votimeve dhe KZAZ-të i kryen të gjitha aktivitetet e tyre ashtu siç kërkohet, nga zyrat e tyre.

Vëzhguesit afatgjatë të KZLNDQ raportuan gjithashtu për mungesë angazhimi nga KZAZ-të për të shpallur publikisht orën dhe rendin e ditës për takimin pasardhës, çka shkaktonte vështirësi për vëzhguesit e KZLNDQ-së në monitorimin e çdo takimi, ose për shpalljen publike të vendimeve të marra⁵⁵. Një numër i vogël KZAZ-sh bënin përpjekje për të publikuar vendimet e tyre. Gjithsesi, duhet thënë se ligji nuk i specifikon mjetet dhe mënyrat që KZAZ-të duhet të përdorin për t'i bërë aktivitetet dhe informacionet e tyre publike.

E drejta për të ndjekur dhe/ose vëzhguar takimet e KZAZ-ve

Pavarësisht faktit që Kodi Zgjedhor dikton që takimet e KZAZ-ve duhet të jenë publike⁵⁶, në pak prej KZAZ-ve vizitorët që shkuan të vëzhgonin takimet e KZAZ-ve pa akreditimin e KQZ-së, përfshirë edhe vëzhguesit e KZLNDQ⁵⁷ nuk u lejuan t'i ndiqnin ato.

Për më tepër, disa vëzhgues afatgjatë të KZLNDQ hasën vështirësi në monitorimin e KZAZ-ve të tyre. Vëzhguesit e patën të vështirë të siguronin kopje të vërtetuara të procesverbaleve të takimeve të KZAZ-ve, edhe pse paragrafi ë i nenit 34 të Kodit Zgjedhor thotë se “sekretari i KZAZ-së u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre”.

Zëvendësimi i komisionerëve në nivel ZAZ-sh

Numri i lartë i zëvendësimeve gjatë procesit zgjedhor dhe ç'është më e rëndësishmja aq pranë ditës së votimit e minoi seriozisht cilësinë e procesit në një mënyrë të pajustificueshme dhe të panevojshme. KZLNDQ ka ngritur shqetësime rreth numrit të madh të komisionerëve të zëvendësuar në nivel ZAZ-sh gjatë muajit të fundit duke i paraprirë ditës së votimeve, në dy raportet të ndërmjetme të saj. Kjo prirje u bë edhe më e shpeshtë teksa dita e zgjedhjeve afrohej⁵⁸. KZLNDQ ngriti shqetësime edhe rreth aftësisë së komisionerëve të rinj për të kryer detyrat e tyre, duke qenë se një numër i konsiderueshëm i tyre u zëvendësua pasi KQZ-ja përfundoi trajnimin e saj të fundit për komisionerët e ZAZ-ve, mbajtur 2-4 qershor 2015. Nga ana tjetër, gjatë takimeve të KZLNDQ me partitë politike, këto të fundit ngulnin këmbë që komisionerët e rinj kishin përvojë, pasi kishin mbuluar pozicione të ngjashme gjatë zgjedhjeve të mëparshme. Ndërkohë që një gjë e tillë mund të jetë e vërtetë, KZLNDQ dëshiron të theksojë se çdo zgjedhje ka specifikat e veta, duke ofruar kështu sfida dhe kontekste të reja për komisionerët.

⁵⁵ Ibid, neni 22/6 përcakton se: “KZAZ-ja është e detyruar që të bëjë menjëherë publike vendimet e marra...”

⁵⁶ Kodi Zgjedhor, neni 35/1: “Mbledhjet e KZAZ-së janë publike”.

⁵⁷ Pesë KZAZ nuk i lejuan vëzhguesit e KZLNDQ të ndiqnin takimet teksa ata ishin ende pa akreditim. Ata u lejuan të ndiqnin takimet e KZAZ-ve pasi vëzhguesit afatgjatë cituan Kodin Zgjedhor mbi faktin se takimet e KZAZ-ve janë të hapura për publikun.

⁵⁸ Gjithsej, deri më 23 qershor, 264 komisionerë u zëvendësuan në nivel ZAZ-sh: 135 në qershor, 85 në maj dhe 44 në prill.

Vendndodhja e zyrave qendrore të KZAZ-ve

Pavarësisht dispozitave të qarta të Kodit Zgjedhor, sipas të cilave selitë e KZAZ-ve nuk mund të jenë në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, përveç institucioneve arsimore, shëndetësore dhe kulturore, pati njëmbëdhjetë⁵⁹ KZAZ selitë e të cilave ishin vendosur në mënyrë të papërshtatshme në ndërtesa të zëna nga administrata bashkiake, ose ajo qendrore. Një gjë e tillë përbën shkelje të Kodit Zgjedhor, megjithatë të gjitha këto KZAZ u zhvendosën brenda një jave nga dita e votimeve.

Infrastruktura dhe logjistika e KZAZ-ve

Vëzhguesit afatgjatë vërejtën se shumë KZAZ hasën probleme të ndryshme në lidhje me infrastrukturën, logjistikën dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera si për shembull KQZ-në dhe autoritetet vendore. Gjithsej, njëzet e gjashtë KZAZ deklaruan se pengoheshin nga mangësitë në infrastrukturë dhe logjistikë. Prej këtyre, nëntëmbëdhjetë⁶⁰ deklaruan se selitë e tyre ndodheshin në mjedise të papërshtatshme dhe jo funksionale dhe/ose hapësira ishte e pamjaftueshme e në zyra mungonte furnizimi me ujë dhe elektricitet. Ato pretendonin gjithashtu se kishte mangësi në logjistikë si për shembull mungesë telefoni fiks dhe lidhjeje interneti, mungesë kompjuterash, printerash dhe faksesh.

Njëmbëdhjetë⁶¹ KZAZ deklaruan se nuk ishin të kënaqura me mbështetjen e marrë nga KQZ-ja⁶² ndërsa shtatë⁶³ prej tyre deklaruan se nuk ishin të kënaqur me ndihmën e marrë nga autoritetet vendore për zgjidhjen e këtyre çështjeve⁶⁴. Vetëm katër⁶⁵ KZAZ deklaruan se nuk ishin të kënaqur me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet komisionerëve⁶⁶.

Problemet e KZAZ-së me buxhetin dhe bazën materiale

Puna e komisionerëve u bë edhe më e vështirë, duke pasur parasysh mangësitë në buxhet dhe bazën materiale të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të tyre zgjedhore. Tridhjetë⁶⁷ KZAZ patën probleme me bazën materiale (dokumente, formularë, letër dhe bojë printeri, karburant), njëzet e gjashtë⁶⁸ KZAZ shprehën shqetësim gjatë periudhës së raportimit për shkak se nuk

⁵⁹ KZAZ 1 (Malësi e Madhe) ishte vendosur në drejtorinë bujqësore, Koplik; KZAZ 9 (Tropoja) ishte vendosur në një sallë takimesh në bashkinë e Bajram Currit; KZAZ 20 (Krujë) në sallën e aktiviteteve në bashkinë e Krujës; KZAZ 52 në Bashkinë e Librazhdit; KZAZ 71 dhe 72 (Korçë) që të dyja në bashkinë Korçë; KZAZ 74 në ndërtesën e nën-prefekturës Përmet; KZAZ 75 në sallën e këshillit bashkiak të Këlcyrës; KZAZ 76 në sallën e këshillit bashkiak të Memaliajt; KZAZ 77 në bashkinë Tepelenë; dhe KZAZ 88 në sallën e këshillit bashkiak të Sarandës.

⁶⁰ KZAZ-të 1, 4, 6, 13, 21, 30, 38-39, 48-49, 52-53, 57, 63, 66, 71, 83, 86, 89. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1

⁶¹ KZAZ-të 5, 13, 22, 30, 34, 39, 47, 63, 66, 83, 89. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1.

⁶² KZAZ-të ia kanë drejtuar problemet e lartpërmendura KQZ-së dhe kanë mbetur të pakënaqur nga përgjigja/reagimi i institucionit.

⁶³ KZAZ-të 2, 13, 34, 38, 52, 57, 83. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1.

⁶⁴ Autoritetet vendore janë përgjegjëse për garantimin e infrastrukturës dhe një pjesë të mirë të logjistikës. Shtatë KZAZ-të kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me çka iu është vënë në dispozicion nga autoritetet vendore.

⁶⁵ KZAZ-të 20, 39, 44, 47. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1.

⁶⁶ Në të tilla raste, komisionerët priren të akuzojnë kolegët e partive rivale për zvarritje të procesit në bazë të urdhrave të kryetarëve të partive.

⁶⁷ KZAZ-të 2, 4, 13, 16, 19, 21-23, 28-30, 33, 38-39, 42, 52-53, 57, 60-63, 66-67, 70-72, 83-84, 90.

⁶⁸ KZAZ-të 2, 12-13, 19, 21-22, 29-30, 33, 38-39, 42, 46, 52-53, 62-67, 70, 72, 82, 89-90.

kishin buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të tyre dhe pesë⁶⁹ KZAZ deklaruan se nuk ishin të kënaqur me aftësitë e kolegëve për kryerjen e detyrave të tyre. Gjithsej, më shumë se gjysma e KZAZ-ve, pra dyzet e gjashtë prej tyre hasën të paktën një problem që kishte të bënte me bazën materiale, mungesat në buxhet ose shfaqje mangësish sa i përket aftësive profesionale.

KQZ-ja u caktoi secilës KZAZ një buxhet prej 15 mijë lekë, kryesisht për të mbuluar shpenzimet e letrës dhe bojës së printimit, shumë të cilën komisionet duhet ta tërhiqnin nga bashkitë e tyre respektive. Ky fond nuk ishte i përshtatshëm për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të KZAZ-ve, veçanërisht për shpenzime udhëtimi. Në këtë aspekt, buxheti duhet të ndryshojë në mënyrë domethënëse nga njëra KZAZ në tjetrën, nëse mbajmë parasysh numrin dhe vendndodhjen⁷⁰ e qendrave të votimit⁷¹ për KZAZ. Mungesa e karburantit dhe fondeve për udhëtim shkaktoi vonesa në punën e disa KZAZ-ve, veçanërisht në inspektimin dhe pajisjen me listat e votuesve të disa qendrave të votimit⁷²

Ia vlen gjithashtu të përmendet se buxheti prej 15 mijë lekësh u vu në dispozicion të KZAZ-ve më 4 qershor 2015. Duke qenë se KZAZ-të filluan punë më 14 prill, KZLNDQ gjykon se kjo është një vonesë e tepërt dhe dëmton përgatitjet për procesin zgjedhor.

Në shumë prej rasteve të sipërpërmendura, komisionerët i mbuluan mungesat në bazë materiale dhe buxhet përmes burimeve të veta financiare dhe materiale⁷³. Është sa e kuptueshme, aq edhe e papranueshme që këto vështirësi teknike mund të ndikojnë ende performancën e komisionerëve.

⁶⁹ KZAZ-të 12, 39, 47-49. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1.

⁷⁰ Shembull: Bashkia Shkodër ka katër ZAZ (2, 3, 4, 5). ZAZ-të 3, 4, 5, kanë respektivisht 46, 44, 46 qendra votimi, të gjitha me vendndodhje në qytetin e Shkodrës. ZAZ-ja 2, me seli në qytetin e Shkodrës ka 110 qendra votimi, të tëra në zonat rurale, disa prej tyre në zona malore të largëta e me infrastrukturë të keqe rrugore.

⁷¹ Shembull: ZAZ 64 (Berat) ka numrin më të madh të qendrave të votimit në vend (124), me vendndodhje si në zonat urbane ashtu edhe rurale, ndërsa ZAZ-ja 69 (Pustec) është më e vogla në të gjithë vendin me vetëm tetë qendra votimi.

⁷² Deri më 13 qershor, KZAZ 2 nuk kishte mundur ende të pajiste me listat e votuesve 13 qendra votimi: QV 91-94 (Komuna Pult), QV 115-119/1 (Shalë), dhe QV 132-134 (Shosh). Të gjitha këto janë komuna të thella. KZAZ-ja 13 nuk kishte pajisur 27 qendra votimi me listat e votuesve: QV 690-696 (Komuna Blinisht), QV 704-708 (Kallmet), dhe QV 720-728 (Kolsh).

⁷³ KZLNDQ kontaktoi KQZ-në, të hënën më 8 qershor 2015 rreth problemit të buxhetit dhe përgjigja e tyre ishte se fondet e buxhetit ishin transferuar të enjten, më 4 qershor 2015 dhe se KZAZ-të ishin njoftuar për të tërhequr fondet respektive.

| Tabela 1: Lista e KZAZ-ve me probleme ndarë në dy grupe | | | |
|--|------------------------|--|------------------------|
| Probleme me infrastrukturën, logjistikën dhe bashkëpunimin | Numri i KZAZ-ve | Probleme me bazën materiale, buxhetin dhe aftësitë profesionale | Numri i KZAZ-ve |
| Infrastrukturë e papërshtatshme/Mangësi në logjistikë | 19 | Mungesa në bazë materiale | 30 |
| Mungesë bashkëpunimi me KQZ-në | 11 | Mangësi në buxhet | 26 |
| Mungesë bashkëpunimi me autoritetet vendore | 7 | Mungesë aftësish profesionale | 5 |
| Mungesë bashkëpunimi ndërmjet komisionerëve | 4 | Tjetër | 0 |
| Numri gjithsej i KZAZ-ve me të paktën një nga problemet e radhitura më lart | 26 | Numri gjithsej i KZAZ-ve me të paktën një nga problemet e radhitura më lart | 46 |

Përfaqësimi gjinor në Komisionet e ZAZ-ve

KZLNDQ e vlerëson faktin që PS-ja dhe PD-ja kanë respektuar kuotat gjinore sipas kërkesave të ligjit për përfaqësim gjinor jo më pak se 30 përqind⁷⁴ në KZAZ, pavarësisht zëvendësimeve të shpeshta të komisionerëve para dhe pas 22 majit 2015. Deri më 13 qershor 2015 nga 270 komisionerë të PS-së 103 (38%) ishin gra; nga 270 komisionerë të PD-së tetëdhjetë e shtatë (32%) ishin gra.

Megjithatë, edhe pse dy partitë zbatuan ligjin, përfaqësimi gjinor në komisionet e ZAZ-ve mbeti larg frymës së ligjit me vetëm 270 (29%) nga 720 komisionerë gjithsej, përfshirë sekretarët. Një gjë e tillë u ndje gjithashtu edhe në numrin e vogël të grave komisionere të emëruara nga partitë e vogla, LSI dhe Partia Republikane, të cilat patën respektivisht vetëm nëntë (10%) komisionere gra nga 90 gjithsej.

Zbatimi i përfaqësimit gjinor në postet drejtuese në komisione (kryetar, zëvendës kryetar dhe sekretar) tregoi shifra edhe më shkurajuese. Nga nëntëdhjetë komisionerë për secilin nga pozicionet e përmendura më lart, vetëm katërbëdhjetë (16%) ishin kryetare, nëntëmbëdhjetë (21%) zëvendës kryetare dhe njëzet e dy (24%) sekretare.

Krijimi i komisioneve të qendrave të votimit

Afati për krijimin e komisioneve të qendrave të votimit (KQV) ishte data 1 qershor 2015. Tridhjetë e gjashtë KZAZ nuk e respektuan këtë afat për arsye të ndryshme. Njëmbëdhjetë KZAZ e përfunduan procesin vetëm më 19 qershor 2015 (më pak se 48 orë para ditës së votimeve). Posaçërisht, KZAZ-ja 15 (Kurbini) e përfundoi procesin vetëm më 20 qershor, disa

⁷⁴ Kodi Zgjedhore, neni 29/1/ç përcakton se: “30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini”

orë para hapjes së qendrave të votimit, kur KQZ-ja me anë të vendimit nr. 716, shkarkoi katër komisionerët nga partitë e opozitës, të cilët akuzoheshin për bllokim të procesit.

Së pari, në njëzet e tetë⁷⁵ KZAZ, partitë politike vonuan dorëzimin e listave të kandidatëve për komisionerë, patën mangësi në listat e dorëzuara, ose KZAZ-ja e quajti të nevojshme të zëvendësonte një numër kandidatësh për komisionerë, të cilët nuk plotësonin kriteret.

Së dyti, në njëmbëdhjetë⁷⁶ KZAZ, afati për krijimin e KQV-ve u shkel për shkak të problemeve të ndryshme që këto KZAZ patën me një numër qendrash votimi, përfshirë edhe qendrat e votimit në mjedise jofunksionale, në prona private ose në adresa të gabuara.

Së treti, në njëmbëdhjetë⁷⁷ KZAZ puna për krijimin e KQV-ve u vonua nga vetë komisionerët e ZAZ-ve, më së shumti për shkak të vonesave në takime.

Krijimi i grupeve të numërimit dhe qendrave të numërimit të votave

Vëzhguesit afatgjatë të KZLNDQ raportuan se njëzet KZAZ i krijuan grupet e numërimit të votave (GNV) pas afatit ligjor që ishte 11 qershor 2015⁷⁸. Sërish, ashtu si edhe me krijimin e KQV-ve, partitë politike nuk i dorëzuan listat e anëtarëve të grupeve të numërimit në kohë, dorëzuan lista pa dokumentacionin e kërkuar ose përfshinë numërues të cilët nuk plotësonin kriteret për të kryer punën

Në këtë aspekt, KZAZ 1 (Malësi e Madhe) u bë më problematikja, ku për arsye të ndryshme komisionerët nuk arritën t'i krijojnë grupet e votimit përpara ditës së zgjedhjeve. KQZ-ja ndërhyri me anë të vendimit 729, më 22 qershor 2015 duke e urdhëruar KZAZ-në 1 që më në fund të përmbushte detyrimet e veta.

Me përjashtim të KZAZ-së 19 (Dibër), të gjitha qendrat e numërimit të votave (QNV) u pajisën brenda një kohe të arsyeshme me bazën e nevojshme materiale (tavolina, karrige, skanerë).

Fushata Zgjedhore

Fushata për zgjedhjet lokale të 21 qershorit u hap zyrtarisht më 22 maj 2015, por pothuajse të gjithë kandidatët dhe përfaqësuesit politikë e kishin filluar atë, tashmë, javë para fillimit të saj zyrtar, duke shkelur kështu legjislacionin zgjedhor kombëtar. Fushata ndoqi trendin e saj të rritjes së tonit, duke arritur kulmin në javën e fundit me mitingjet përmbyllëse të koalicioneve në qytetet kryesore të vendit. Me përjashtim të disa incidenteve të izoluara, fushata mbeti, përgjithësisht, e qetë.

Fushata u karakterizua nga angazhimi i plotë dhe bile i tepruar i liderëve të partive politike dhe nga paraqitja e platformave që do të ishin më të përshtatshme për zgjedhjet parlamentare, sesa për ato vendore. Shumica e premtimeve u përqëndruan në politikat që zbatohen në nivel qendror.

⁷⁵ KZAZ-të 1-2, 4-5, 9-10, 16, 18-19, 25, 31, 34-35, 39-41, 45-46, 48-49, 63-65, 71, 73, 81, 86, 90. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1

⁷⁶ KZAZ-të 2, 4, 15, 34, 38-39, 49, 62, 71, 82, 85. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1

⁷⁷ KZAZ-të 1, 9, 19-20, 23, 31, 34, 39-40, 46, 81. Shih listën e vendndodhjes së KZAZ-ve në Shtojcën 1

⁷⁸ Kodi Zgjedhor, neni 95/1.

Kandidatët

KQZ-ja regjistroi 89 subjekte zgjedhore, 63 parti politike dhe 14 kandidatë të pavarur që kandidonin për kryetar të bashkive dhe 12 kandidatë të pavarur që kandidonin për anëtar të këshillit bashkiak. Gjithashtu, u krijuan dy koalicionet e mëdha partish. Të dy koalicionet, Aleanca për Shqipërinë Europiane (me 37 parti, kryesuar nga Partia Socialiste) dhe Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (me 15 parti, kryesuar nga Partia Demokratike) i dhanë tonin fushatës gjatë gjithë shtrirjes së saj. Kandidatët e pavarur mbetën në hije për shkak të takimeve dhe aktiviteteve të përmasave të vogla, si dhe mbulimit të ulët mediatik, ndoshta si rezultat i burimeve të kufizuara financiare dhe strukturore.

Kandidatët për këshillin bashkiak, anëtarët e ardhshëm të parlamenteve vendore, ku do të merren vendime të rëndësishme lidhur me zhvillimin e bashkive përkatëse, kanë munguar në këtë garë zgjedhore. Informacioni mbi kandidatët për këshillin bashkiak - pjesë e listave të mbyllura dhe të votuar me një sistem proporcional - dhe mbi kualifikimet e kontributin e shkuar dhe të pritshëm të tyre në komunitetet përkatëse, mbeti minimal. Në përgjithësi, kandidatët për këshillin bashkiak nuk kanë qenë pjesë e ekipeve të kandidatëve për kryetarë në takimet e tyre publike.

KZLNDQ vëren se dispozitat gjinore, të miratuara rishtas, rritën numrin përfundimtar të kandidateve femra për këshilltare. Megjithatë, gratë mbetën të nën-përfaqësuara në rastin e kandidateve për kryetare bashkie me vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) ose 10% kandidate femra nga një numër total prej 161 kandidatësh. Një aspekt pozitiv është se gratë konkurruan në qytetet e mëdha dhe të rëndësishme si Durrësi dhe Shkodra, për herë të parë në historinë e zgjedhjeve lokale. Vetëm 9 gra ishin të suksesshme.

Një çështje tjetër në këto zgjedhje ishte përfaqësimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian. Pavarësisht nga prania e konsiderueshme e këtij komuniteti në disa nga bashkitë kryesore në vend, ishte e vështirë të gjeje ndonjë anëtar të këtij komuniteti në listat e partive për këshillin e bashkisë, apo premtime të bëra nga kandidatët apo partitë që merrnin në konsideratë shqetësimet dhe nevojat e tyre të përditshme. Vëzhguesit tanë vendas nuk raportuan ndonjë aktivitet elektorale të kandidatëve në zonat ku jeton ky komunitet.

Prezantimi i Platformave

Mitingjet elektorale kanë qenë mjetet kryesore të fushatës për të dy koalicionet, me liderët e partive dhe ekipet e tyre mbështetëse që lëviznin nga njëri qytet në tjetrin. Përfshirja e liderve të tre partive kryesore në fushatën zgjedhore dhe zënia e podiumit kryesor duke promovuar kandidatët për kryetarë të bashkive përkatëse ishte problematike. Përkundër frymës dhe qëllimit të këtyre zgjedhjeve, udhëheqësit përkatëse të PS-së, PD-së dhe LSI-së zhvilluan një fushatë zgjedhore tipike për zgjedhjet parlamentare, me një fokus në çështjet me rëndësi kombëtare, të tilla si, ulja e taksave në nivel kombëtar, ulja e çmimit të energjisë elektrike dhe të produkteve të domosdoshme të konsumit, punësimin në përgjithësi dhe projektet në nivel kombëtar.

Këto qasje kanë qenë njëkohësisht kundërproduktive dhe keqorientuese për votuesit. KZLNDQ beson se kjo pati dy aspekte negative. Së pari, fushata, në mënyrë të panevojshme, kontribuoi në polarizimin e mëtejshëm të garës zgjedhore midis kandidatëve lokale dhe zvogëloi rëndësinë e

tyre në garë. Së dyti, premtimet e lidhura me politikat në nivel kombëtar, që bënë liderët e partive, nga pozitat ku ata qëndrojnë, shpesh nuk lidheshin, drejtpërdrejt, me nevojat përkatëse të zgjedhësve.

Kjo situatë, sipas KZLNDQ-së, u ndikua, gjithashtu, nga stacionet lokale dhe kombëtare televizive që mbuluan mitingjet e liderëve të partive dhe lanë pas dore, apo raportuan në mënyrë të pamjaftueshme, nëse e bënë këtë gjë, takimet e kandidatëve në zonat periferike dhe takime në komunitetet e vogla. Tirana dhe Durrësi kanë qenë një përjashtim në këtë drejtim, pasi aktivitetet e kandidatëve të koalicioneve, në këto bashki, u pasqyruan gjerësisht.

Në anën tjetër, KZLNDQ përshëndeti faktin se shumica e kandidatëve bënë përpjekje për t'ju larguar kësaj linje dhe e përqëndruan fushatën e tyre rreth platformave përkatëse për zhvillimin e bashkive ku ata konkurrionin. Platformat zgjedhore ishin disi më të përpunuara, por KZLNDQ vuri re që, përsëri, premtimet mbetën të përgjithshme dhe nuk u shoqëruan nga plane të detajuara për zbatim. KZLNDQ beson, fuqimisht, se ishte e nevojshme për t'ju shpjeguar qytetarëve mjetet për arritjen e premtimeve të programit elektorale, duke përfshirë institucionet kompetente, rregulloret, fondet e nevojshme dhe afatet për përmbushjen e tyre. Në disa raste, kandidatët për kryetarë të bashkive, nga të dy koalicionet - me siguri të ndikuar nga liderat e tyre partiakë – ju referuan, gjithashtu, nivelit kombëtar të politikë-bërjes në platformat e tyre.

Fjalimet dhe sulmet ndaj kandidatëve

Vëzhguesit KZLNDQ-së monitoruan mesazhet dhe gjuhën e përdorur nga kandidatët për kryetar, dhe vunë re, me kënaqësi, se fokusi kryesor që, më së shumti, tek platformat individuale sesa tek sulmet personale, edhe pse këto të fundit nuk munguan, plotësisht.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së në Vlorë kanë shënuar se kandidati i pavarur Vasil Bedinaj⁷⁹ ka përdorur, në disa raste, gjuhë përçmuese ndaj zyrtarëve të lartë të vendit. I njëjti kandidat, në përgjigje, ishte subjekt i mesazheve negative të TV Vlora, i cili, gjithashtu, transmetoi mesazhe kundër kandidatit të koalicionit të krahut të djathtë, Genc Deromenaj. Vlen të përmendet se në këtë rast, KQZ-ja urdhëroi këtë media që t'i jepte fund kësaj praktike.

Vëzhguesit KZLNDQ-së raportuan një numër incidentesh kundër kandidatëve, zyrave elektorale dhe posterave. Rasti më flagrant ka qenë dhunimi i zyrës elektorale të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) në Himarë, që përfaqëson minoritetin grek, dhe grisja e posterave të kandidatit të saj, Fredi Beleri. Në një tjetër incident shqetësues, stafi i kandidatit të PD-së në Pogradec, Eduard Kapri, raportoi se ai kishte marrë një mesazh kërcënues në telefonin e tij celular. Prokuroria nisi hetimet për këtë rast. Në Vlorë, kandidati i pavarur Vasil Bedinaj⁸⁰ denoncoi presionin e ushtruar nga zyrtarët e qeverisë ndaj tij dhe bashkëpunëtorëve të tij, duke e konsideruar rastin si shkelje të lirisë për të shprehur idetë e tyre.

⁷⁹https://video-fra3-1.xx.fbcdn.net/hvideo-xtf1/v/t42.1790-2/11275256_431189900375754_846240387_n.mp4?oh=5aaa7aa275b7407fbb07c8607a034725&oe=557B655F

⁸⁰<https://www.facebook.com/GazetaRD/photos/pcb.801559349942316/801559046609013/?type=1&theater>

Mjetet e Fushatës

Përveç mitingjeve të liderëve të partive, kandidatët përdorën format tradicionale të komunikimit me votuesit. Sipas gjetjeve të KZLNDQ-së, të listuara sipas frekuencës së përdorimit, ato ishin: posterat, takimet, prezantimi derë më derë dhe debatet e zhvilluara në radio ose në televizion. Media sociale ishte media më e preferuar për 81%⁸¹ të bashkive dhe kandidatët publikuan aktivitetet zgjedhore në llogaritë e tyre përkatëse të mediave sociale. KZLNDQ vlerëson se në pak raste (Berat dhe Shkodër), u organizuan të ashtuquajturat dëgjesa publike apo takime për diskutim, ku të dy kandidatët kryesorë prezantuan dhe debatuan programin e tyre zgjedhor me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit.

Aspekti vizual i propagandës zgjedhore u forcuar gjatë javës së fundit të fushatës. U rrit ndjeshëm numri i flamujve dhe postera të partive, si dhe banderolat e partive dhe kandidatëve respektive. Sipas vëzhgimeve të VAGJ-ve, në përgjithësi, koalicioni i krahut të majtë ishte më i dukshëm në aspektin e materialeve propagandistike, veçanërisht, në Peqin, Gramsh, Pogradec, Sarandë, Himarë, Berat, Fier dhe Kavajë.

Edhe pse jo në fokusin e vëzhgimit të KZLNDQ-së, VAGJ-të tona, pas takimeve me selitë elektorale në të gjithë vendin, nuk na raportuan probleme të rënda në mbulimin dhe aksesin e medias kombëtare, kur vjen puna për të dy koalicionet kryesore në garë. Në anën tjetër, kandidatët e pavarur pohuan se nuk patën akses të mjaftueshëm në mediat kombëtare⁸². Ky fakt e bëri garën tyre të pabarabartë në krahasim me kandidatët e partive politike. Kjo, gjithashtu, ndikoi edhe tek zgjedhësit që nuk morrën informacionin e plotë mbi kandidatët e pavarur, kështu, në mënyrë indirekte, u kufizua vendimi i zgjedhësit në fletën e votimit.

Raportimi Proaktiv i Financave të Fushatës

Aktivitetet zgjedhore, mitingjet e partive, dhe materialet vizuale propagandistike treguan se, përse i përket tre partive të mëdha, kjo ishte një fushatë e shtrenjtë. Vetëm një kandidat i pavarur bëri të njohur, publikisht, kontributet financiare të donatorëve gjatë periudhës së fushatës dhe ftoi partitë e tjera të ndiqnin shembullin e tij. KZLNDQ përsëriti nismën dhe ftoi të gjithë kandidatët dhe partitë të publikonin të dhënat financiare dhe kontributet nga donatorët në raportet e tyre dhe në mënyrë proaktive ti raportonin ato para afateve ligjore, në një akt të përgjegjësisë politike ndaj zgjedhësve. Për më tepër, pavarësisht detyrimit ligjor për të publikuar numrin e llogarisë bankare, vetëm katër subjektet zgjedhore bënë publik numri i tyre të llogarisë bankare për financimin nga fondet jopublike të fushatës së tyre përkatës: PS, LSI, Partia Demokristiane dhe Z. Gjergj Bojaxhi, kandidati i propozuar nga zgjedhësit në Tiranë⁸³

⁸¹ Statistika të KZLNDQ-së – përpunim i pyetsorëve të VAGJ-ve

⁸² Këto konkluzione janë rezultat i takimeve me stafet elektorale të Z. Gjergj Bojaxhi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit në bashkinë e Tiranës, dhe Z. Vasil Bedinaj, kandidat i propozuar nga zgjedhësit në bashkinë e Vlorës.

⁸³ Sipas Kodit Zgjedhor, Neni 90/2 “Regjistrimi i fondeve jopublike”, subjektet zgjedhore duhet të hapin një llogari bankare jo më vonë se tre (3) ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Zgjedhjet-Vendore/Zgjedhjet-2015/Financimi-i-Subjekteve>

Reforma Territoriale dhe Administrative

Këto zgjedhje lokale u zhvillua në kuadrin e reformës së re administrative dhe territoriale. KZLNDQ beson se, pavarësisht nga ndryshimet strukturore të bëra deri tani, mbetet shumë për t'u bërë në drejtim të funksioneve, kompetencave politike, decentralizimit fiskal, burimeve financiare (grante të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara nga qeveria dhe burimet e veta financiare), marrëdhëniet ndërmjet bashkive (niveli i parë i qeverisjes vendore) dhe qarqeve (niveli i dytë), si dhe përfshirja e bashkive të reja në procesin e vendimmarrjes të reformës. Të gjitha këto mangësi e dëmtojnë fushatën pasi pak, ose aspak, informacion ju dha qytetarëve rreth asaj se çfarë është reforma, në aspektin praktik, dhe se si interesat e njerëzve në zonat rurale dhe të largëta të bashkive do të përfaqësoheshin në këshillin bashkiak. Si rezultat, votuesit nuk kishin në duart e tyre informacionin e kërkuar, për të bërë një vendim-marrje të mirë-informuar.

Qëndrimi i Policisë

Policia e Shtetit ka vepruar në mënyrë profesionale gjatë gjithë fushatës. U bënë përpjekje për përgatitjen e duhur dhe trajnimin e stafit. Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit kishin përgatitur një plan të detajuar masash. Punonjësit e policisë u trajnuan, përveç aspekteve të tjera të fushatës zgjedhore, mbi temat e sjelljes në terren gjatë zgjedhjeve dhe se si duhet të trajtoheshin shkeljet e ligjit gjatë procesit zgjedhor⁸⁴.

Incidentet dhe ankesat e raportuara ishin raste të izoluar. Incidenti më i rëndë ku u përfshirë një punonjës policie u regjistrua në Vaun e Dejës (ZAZ 6), në ditën e parë të fushatës zyrtare. KZLNDQ do të inkurajonte autoritetet policore që të forcimin më tej këtë qëndrim, që është vërejtur gjatë dy periudhave të fundit zgjedhore.

Përdorimi i Burimeve Publike

Burimet publike, përveç fondeve të buxhetit të shtetit për partitë parlamentare, të rregulluara në mënyrë të qartë me ligj, nuk duhet të përdoren për qëllime elektorale. Është përgjegjësi e qeverisë, që të sigurojë që burimet publike dhe administrative, si materiale ashtu dhe njerëzore, nuk përdoren në mënyrë abuzive në mbështetje të ndonjë kandidati ose partie të veçantë. Nëse ndërtesat ose mjediset e tjera publike vihen në dispozicion, për përdorim, si zyra për fushatë apo për takime, ato duhet të jenë në dispozicion për të gjithë kandidatët ose partitë, mbi të njëjtën bazë. Si një minimum, punonjësit publikë duhet që, rreptësisht, të ndajnë rolet e tyre si nëpunës publikë nga përfshirja e tyre në aktivitete të fushatës. Punonjësve publikë nuk duhet t'ju kërkohej të marrin pjesë në aktivitetet e fushatës, të financojnë kandidatë të veçantë ose parti politike, ose të detyrohen të votojnë për një parti apo kandidat të veçantë, siç është shprehur qartë në Kodin Zgjedhor shqiptar dhe Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Shqipërisë.

⁸⁴ Përveç kësaj, forcat e policisë kanë qenë subjekt i disa trajnimeve, përfshirë një nga OSBE, lidhur me zgjedhjet. Trajnimi më i fundit i forcave të policisë u zhvillua gjatë periudhës 20.04-05.05.2015.

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1605689033050795&id=1502420603377639

Presioni mbi Punonjësit e Administratës Publike

Gjatë periudhës parazgjedhore, ka pasur disa⁸⁵ raste, të raportuara, ku punonjësit e Qeverisë së Shqipërisë, administratës publike qendrore apo vendore, dhe agjencive e institucioneve qendrore mbështetën kandidatë dhe parti politike gjatë orarit të tyre të punës.

Vëzhguesit KZLNDQ-së, gjithashtu, raportuan një numër⁸⁶ rastesh kur punonjësit e administratës publike u vunë nën presion për të marrë pjesë në aktivitetet elektorale të partive politike dhe të kandidatëve. Në Urën Vajgurore (ZAZ 62), kandidati i PD-së pohoi se punonjësit e administratës publike u vunë nën presion për të marrë pjesë në aktivitetet elektorale të koalicionit të krahut të majtë. Po kështu, në Berat (ZAZ 64), kreu i PD-së për fushatën akuzoi se të gjithë punonjësit e administratës publike Berat se u vunë nën presion për të marrë pjesë në fushatën e kandidatit të ASHE. Për më tepër, në Selenicë (ZAZ 85), punonjësit publik, mësuesit dhe punonjësit e spitalit kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në takimet e kandidatit të ASHE, nën presionin se mund të humbisnin punën e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, ka pasur disa⁸⁷ raste të raportuara ku punonjësit e Qeverisë së Shqipërisë, administratës publike qendrore apo vendore, dhe agjencive e institucioneve qendrore mbështetën kandidatët dhe partitë politike gjatë orarit të tyre të punës.

Në Urën Vajgurore, punonjësit qeverisë vendore dhe mësuesit janë parë në një miting të kandidatit të krahut të majtë, të dokumentuar me foto në faqen e Facebook-ut të kandidatit. Vëzhguesi i KZLNDQ-së, në KZAZ-në nr 67 në Pogradec, raportoi se punonjës të institucioneve shtetërore dhe pushtetit vendor lanë punën gjatë orarit zyrtar për t'u bashkuar me zyrat elektorale të partive politike.

KZLNDQ tërheq vëmendjen për rastin e Vlorës, ku punonjës të bashkisë Vlorë, punëtorët e ujësjellës-kanalizimeve dhe personeli i spitalit kanë marrë pjesë në mbledhjet e kandidatit të krahut të majtë për kryetarin e Vlorës gjatë orarit të tyre të punës. Përveç kësaj, në Vlorë, VAGJ-ja njoftoi se punëtorët e transportit urban morrën pjesë në një takim të kandidatit të krahut të majtë më 2 qershor, 2015 në 12:40. Mediat lokale në Vlorë, gjithashtu, i kanë dokumentuar këto raste.

Për më tepër, në Poliçan (ZAZ 65) punonjësit e bashkisë, si dhe drejtor i shkollës së mesme Poliçan shoqëruan kandidatin e krahut të majtë, të Aleancës për Shqipërinë Europiane (ASHE) gjatë fushatës së tij elektorale në Paraspuar dhe Rehovë në ora 10:34, më 2 qershor.

Në mënyrë të ngjashme, në Himarë (ZAZ 86), më 5 qershor, në ora 11:30, kryetari në detyrë pati një takim në lagjen "1 Maj", i shoqëruar nga një numër punonjësish të bashkisë.

KZLNDQ shpreh shqetësimet e saj serioze për raste të tilla, pasi ata nuk mund të shihen në ndonjë mënyrë tjetër, përveçse si shkelje të qarta të nenit 3, paragrafi 7, i Kodit Zgjedhor shqiptar, i cili thotë se subjektet zgjedhore nuk mund të përdorin burimet njerëzore të administratës publike të çfarëdo niveli. Ftohen partitë politike të bëjnë transparente të gjitha rastet kur individë të punësuar në administratën publike kanë marrë pjesë në fushatë, pasi kanë

⁸⁵ Ura Vajgurore, Pogradec, Vlora, Poliçan, Himara.

⁸⁶ Tirana, Ura Vajgurore, Berat, Poliçan, Vlora, Selenica.

⁸⁷ Ura Vajgurore, Pogradec, Vlora, Poliçan, Himara.

marrë më parë pushimet/lejet nga rolet e tyre publike, në mënyrë që të shmangen të gjitha akuzat lidhur me presionin ndaj punonjësve të administratës publike dhe keqpërdorimit të burimeve njerëzore.

KZLNDQ ju rekomandon të gjithë aktorëve zgjedhore të përmbajnë veten nga ushtrimi i çdo presioni mbi subjektet zgjedhore dhe votuesit, si një akt i paligjshëm që dëmton integritetin e marrëdhënieve punëdhënës-punëmarrës dhe etikën punës. KZLNDQ, gjithashtu, i bën thirrje institucioneve që të hetojë akuzat në përputhje me rrethanat.

Shpërndarja e Ndhimave Humanitare

KZLNDQ ka vënë re një numër rastesh të ndihmës humanitare që u është dhënë familjeve të përmbytura në nëntor 2014, si në Urën Vajgurore (11 qershor 2015 16:00-18:30). Po kështu, në Novoselë (Vlorë, ZAZ 84), siç është raportuar edhe nga mediat lokale, ju dhanë ndihma votuesve në formën e ushqimit. VAGJ-të e KZLNDQ-së, gjithashtu, raportuan raste të dorëzimit të ndihmave humanitare për familjet e përmbytura në nëntor 2014 në komunën Qendër, në Vlorë. Koha e dhënies së kësaj ndihme mbetet shqetësim për KZLNDQ-në, pasi ajo tregon një tendencë për të ndikuar tek votuesit. Kjo shkon kundër parimit të votës së lirë, e theksuar nga Kodi Zgjedhor shqiptar, si dhe standardet ndërkombëtare.

KZLNDQ rekomandon që çdo lloj ndihme humanitare nuk duhet të jepet gjatë periudhës së zgjedhjeve, sepse ajo krijon përshtypjen se ka përpjekje për të ndikuar në votën e përfituesve.

Inagurimet e Projekteve Publike dhe Shpërndarja e Çertifikatave të Legalizimit të Pasurisë

Një tjetër aspekt i fushatës ishte përdorimi i përrurimit të projekteve të rëndësishme publike nga ana e politikanëve dhe anëtarëve të qeverisë, si pjesë e aktiviteteve të fushatës. Raste të tilla janë vërejtur në Fier dhe në Divjakë. Në Fier, mitingu i organizuar nga koalicioni i krahut të majtë, ku mori pjesë Kryeministri i Shqipërisë, nisi me inaugurimin e shëtitores së qytetit, një investim publik, që nuk duhej të lidhej me fushatën zgjedhore lokale. Ndërsa në Divjakë, më 8 qershor, Anëtari i Parlamentit Z. Erion Braçe, përdori rastin e hapjes zyrtare të sezonit turistik, për të bërë fushatë për kandidatin e koalicionit të majtë, z Kokoneshi.

KZLNDQ është e shqetësuar nga raportet e shumta të mediave për takime zgjedhore të kandidatëve, gjatë së cilave janë shpërndarë titujt e legalizimit të pronave. Ngjarje të tilla nuk mund të dallohen qartë nga aktivitetet zgjedhore dhe angazhimi i qeverisë qendrore duhet të bëhet i ndarë nga takimet e fushatës.

KZLNDQ rekomandon që të gjitha inagurimet e projekteve publike dhe shpërndarja e titujve të legalizimit të pronës gjatë fushatës zgjedhore duhet të organizohen me kujdes, në aspektin e qëllimit dhe periudhës kohore (nëse është e mundur të kryhet jashtë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore), në mënyrë që të dallohen qartë prej aktiviteteve të fushatës.

Përdorimi i Hapësirës Publike

Në përgjithësi, garuesit politike nuk u ankuan për shpërndarje ose përdorim të padrejtë të hapësirave publike për afishim të materialeve të fushatës. Megjithatë, pati incidente të izoluar në një numër bashkish, të cilat, kryesisht, u adresuan.

U vërejtën disa raste ku përdorimi i hapësirave publike nga palët është bërë pa pëlqimin e autoriteteve lokale, si dhe ka patur akuza për shpërndarjen e padrejtë të hapësirës publike nga ana e autoriteteve lokale.

Ka patur një numër ankesash nga palët për ndarjen e pabarabartë të hapësirave për kandidatët që të vendosnin materialet e tyre propagandistike. Në Vlorë, koalicioni i krahut të djathtë dhe kandidati i pavarur, pretenduan në mediat lokale se kandidati i Aleancas së majtë për Shqipërinë Europiane gëzoi më shumë hapësirë për të vendosur materialet e tij propagandistike. Përveç kësaj, në Urën Vajgurore kandidati i PD-së pohoi se atij nuk i ishte dhënë hapësira e duhur për të vendosur materialet e tij propagandistike.

Ka pasur edhe raste të partive politike që përdorën hapësirat publike pa leje, kundër të cilave autoritetet e pushtetit vendor reagojnë me shpejtësi. Në Bulqizë, të enjten, më 12 qershor, Partia Demokratike vendosi flamuj dhe postera e saj në Pallatin e Kulturës, ku, gjithashtu, ishte vendosur edhe KZAZ nr. 18. Më pas ata janë hequr pas ankesave të kandidatit të LSI-së tek kryetarin i bashkisë.

Në Vlorë, siç është raportuar nga mediat lokale dhe nga kandidatët e tjerë (kandidati i PD-së dhe kandidati i pavarur), kandidati i krahut të majtë, ASHE, kishte zënë më shumë hapësira publike për të vendosur materialin e tij propagandistik, sesa kandidatët e tjerë. Për më tepër, në Urën Vajgurore (KZAZ nr. 62) vëzhguesi KZLNDQ-së pati një takim me kandidatin e PD-së i cili pretendonte se atij nuk i ishte dhënë hapësira e mjaftueshme për të vendosur materialin e tij propagandistik. Përveç kësaj, kreu i fushatës së PD-së në Berat argumentoi se koalicioni ASHE, në mënyrë agresive kishte uzurpuar të gjitha hapësirat për afishimin e materialeve propagandistike.

KZLNDQ ju kujton autoriteteve lokale që merren me këtë çështje, që Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë thekson se të gjitha subjektet zgjedhore duhet të gëzojnë mundësi të barabarta për fushatat e tyre elektorale.

Votuesit Fiktivë

KZLNDQ dëshiron t'ju tërheqë vëmendjen autoriteteve për akuzat e bëra publike nga Voltana Ademi, kandidate e PD-së për Shkodrën, për abuzimet me sistemin TIMS⁸⁸ në vendkalimet kufitare nga emigrantët fiktivë, që hyjnë në vend. Nëse këto akuza qëndrojnë, atëherë ky do të ishte një problem kombëtar dhe jo vetëm për rajonin e Shkodrës, dhe gjithashtu edhe në lidhje me procesin e zgjedhjeve lokale, si një i tërë. KZLNDQ pret që autoritetet përkatëse të kryejnë një hetim të shpejtë të këtyre akuzave për t'ju siguruar qytetarëve integritetin e votës së tyre.

KZLNDQ, gjithashtu pret një hetim të plotë nga autoritetet përkatëse në lidhje me rastet e transferimit të votuesve në Durrës dhe Kavajë, që, nëse provohet të jetë e vërtetë, do ta rrezikonte seriozisht kredibilitetin e procesit zgjedhor në Shqipëri. KZLNDQ, fuqimisht, i bën thirrje autoriteteve për të hetuar dhe zgjidhur rastet e mësipërme.

KZLNDQ nuk është në gjendje të verifikojë saktësinë e këtyre akuzave, por Koalicioni u rekomandon autoriteteve përkatëse ti hetojnë ato tërësisht dhe t'i informojnë qytetarët sa më shpejt të jetë e mundur në lidhje me rezultatet e hetimit, në mënyrë që të mos minohet procesi

⁸⁸ Regjistri i kalimit të kufirit

dhe rezultati i zgjedhjeve. Një parakusht i rëndësishëm për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe për ndërtimin e besimit të publikut në procesin zgjedhor është që të gjithë ata që kryejnë vepra penale në lidhje me të drejtat dhe rregullat zgjedhore të ndëshkohen në përputhje me sistemin ligjor shqiptar.

Dita e Zgjedhjeve

Monitorimi i ditës së zgjedhjeve u mundësua njëkohësisht nga ekipi qendror i KZLNDQ-së, VAGJ-ve, VASH-ve, qendrës së komunikimit në Tiranë, koordinatorëve vendorë dhe ekipeve lëvizëse të monitorimit. Mes këtyre burimeve njerëzore, megjithatë, VASH-të shërbyen si burimi parësor i misionit për vëzhgimin dhe vlerësimin, duke u mbështetur në një pyetesor të parapërgatur, e procedurave të ditës së votimit në qendrat e votimit. Ditën e zgjedhjeve, më shumë se 1000 VASH u shpërndanë në të gjithë vendin sipas një kampioni të rastësishëm dhe përfaqësues për të vëzhguar votimin.

Qendrat e Votimit gjatë Ditës së Zgjedhjeve

Në përgjithësi, procedurat kyçe të votimit respektuan Kodin Zgjedhor, me shkelje në raste të izoluara. Kjo sugjeron se në të ardhmen u duhet kushtuar më shumë rëndësi disa aspekteve të trajnimit të KQV-ve. Incidentet në fjalë u përmbledhën në dy kategori. Kategoria e parë përfshin shpërndarjen e papërshtatshme të vulave të kutive të votimit, të cilat shërbejnë si masë kontrolli në Qendrat e Numërimit. Kategoria e dytë përfshin mungesën e pjesëmarrjes së plotë të të gjithë anëtarëve të KQV-së gjatë hapjes së QV-së.

Në raste të tjera, shkeljet kanë qenë edhe më shqetësuese dhe kërkojnë mbikqyrjen e kujdesshme të KQZ-së: të tilla si incidentet ku votuesit nuk gjetën emrin në listën e votuesve; KQV-të nuk ishin në gjendje të përputhnin numrat e fletëve të votimit të marra në dorezim nga KQZ-ja; por edhe ato raste kur nuk u mundësuan kushtet e përshtatshme për votuesit e paaftë të votojnë pa asistencën e nevojshme. Edhe pse të gjitha këto shkelje nuk e kompromentojnë seriozisht rezultatin e zgjedhjeve, incidentet e raportuara përbëjnë shkelje të Kodit Zgjedhor të Shqipërisë dhe, në disa raste, të standardeve ndërkombetare.

Analiza e Dites së Votimit ndahet në disa pjesë: Procedurat e Hapjes, Votimi, Procedurat e Mbylljes, dhe përmban të dhëna shtesë mbi Përbërjen Gjinore të Administratës, Votimi i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shkeljet Zgjedhore.⁸⁹


Hapja e Qendrave të Votimit

Procedurat e hapjes u kryen kryesisht duke respektuar ligjin zgjedhor, me pak incidente që nuk ndikuan në mënyrë thelbësore mbi procesin e votimit. Dy problemet kryesore ishin mosshpërndarja e duhur e vulave të kutive të votimit dhe mospjessmarja e plotë e komisionerëve në QV-të gjatë procedurës së hapjes së qendrës së votimit.

⁸⁹ Informacion me te detajuar per tabulimin e cdo variabli mund ta gjeni në Aneksin në faqen zyrtare të KZLNDQ. Informacioni prezantohet ne rang kombëtar, sipas qarqeve dhe me kampione të fokusuara në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Himarë.

Nga ana procedurale, në bazë të monitorimit të vëzhguesve të KZLNQDQ-së, më shumë se gjysma e qendrave të votimit në kampionin kombëtar respektuan të gjitha procedurat kyçe të hapjes. Për sa u përket qendrave të tjera të votimit, pothuajse një e treta dështuan të përmbushnin të paktën një procedure kyçe të hapjes.⁹⁰

FIGURA 1: Procedurat e Hapjes së Qendrës së Votimit



Më shumë se 85% e qendrave të votimit në të gjithë vendin u hapën në kohë ose me vonesa të vogla dhe, nga të gjitha QV-të e vëzhguara, vetëm një qendër votimi nuk u hap fare. Pothuajse të gjitha qendrat e votimit ishin të pajisura me materialet e nevojshme për të nisur procesin e votimit. Vëzhguesit e KZLNQDQ-së raportuan se të gjitha KQV-të ndoqën procedurën për prezentimin e kutive bosh të votimit përpara vëzhguesve të pranishëm. Pati incidente të izoluar ku kodet e vulave për mbylljen e kutive të votimit nuk u regjistruan siç duhej. Pothuajse të gjitha qendrat e votimit nuk kishin materiale fushate ose propagandistike të postuara brenda një rreze prej 150 m.

KZLNQDQ shpreh shqetësimin e saj mbi faktin se në 16% të QV-ve në të gjithë vendin, komisionerët dhe vëzhguesit nuk u pajisën me një kopje të kodeve të vulave të përdorura për mbylljen e kutive të votimit.⁹¹ Kjo dukuri u dëshmuar edhe në bashkitë e Tiranës dhe Durrësit, ndersa në Shkoder u vëzhgua një situatë më e mirë, ku 94% e qendrave të votimit ndoqën procedurat e nevojshme. Këto kode unike u caktohen kutive të votimit të çdo qendre votimi dhe duhet të përputhen me dokumentacionin zyrtar të KQZ-së në qendrat e numërimit. Nëse

⁹⁰ Infomacion mbi këtë variabel mund ta gjeni në Aneksin e Metodologjisë.

⁹¹ Sipas Kodit Zgjedhor, Neni 101: Kopje të procesverbalit të vulosjes me vulën e KQV-së u jepen anëtareve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.


komisionerët dhe vëzhguesit nuk pajisen me këtë dokument, kjo mund të sabotojë besimin në rezultatin zgjedhor.

Për më tepër, kjo gjetje sugjeron që KQZ-ja mund të mos i ketë trajnuar siç duhet të gjithë anëtarët e KQV-ve, që këta të respektonin procedurën në fjalë. Meqë shumica e incidenteve ka ndodhur në bashkitë më të mëdha, ku gara zgjedhore është zakonisht më konkurruese, KZLNDQ i vlerëson keto procedura si tepër të rëndësishme, ato duhet të theksohen nga KQZ në trajnimet e ardhshme të KQV-ve, por edhe përbëjnë një objektivi në monitorimin e KZLNDQ-së për zgjedhjet e ardhshme.

Një tjetër shqetësim mbi procedurat e hapjes në ditën e votimit është se në pak më shumë se 10% e QV-ve në të gjithë vendin u vu re mungesa e pjesëmarrjes së plotë të komisionerëve gjatë hapjes. Kjo përqindje është pak më e lartë në Bashkinë e Tiranës, me 15% të qendrave të votimit, e pasuar nga 11% në Durrës, ndërkohë që në Shkodër kemi një performancë më të mirë, me mungesë pjesëmarrje të plotë vetëm në 8% të qendrave të votimit.

Procedurat e votimit

Vëzhguesit e KZLNDQ-së raportuan se procedurat e votimit për identifikimin e votuesve, procedurat e plota të shenjimit të votuesve dhe votimi i personave me aftësi të kufizuara u kryen kryesisht në përputhje me Kodin Zgjedhor. Më shqetësuese janë incidentet ku votuesit nuk mundën të gjenin emrin në listën e votuesve.



Votuesve nuk iu mohua e drejta për të votuar dhe u respektuan procedurat që mundësonin votimin vetëm një herë nga i njëjti votues. Në përgjithësi, votuesit e ligjshëm dhe me

identifikimin e duhur ishin në gjendje të votonin. Pati raste të izoluara ku votuesit u lejuan të votonin pa paraqitur identifikimin e duhur dhe ku votuesit u penguan të votonin, edhe pse emrin e kishin në listë dhe qenë të pajisur me dokumentin e përshtatshëm të identifikimit. Në rang kombëtar, pothuajse të gjitha KQV-të ndoqën procedurat e shenjimit në bazë të kodit, duke kontrolluar gishtat e votuesve për gjurmë boje kur këta prezantoheshin përpara komisionit dhe duke i shenjuar votuesit pasi këta kishin përfunduar votimin. Bashkitë e Tiranës, Durrësit e Shkodrës pasqyruan të njëjtën prirje.

Më shumë se 25% e qendrave të votimit në të gjithë vendin patën votues të cilët nuk e gjetën emrin e tyre në listat e votuesve. E njëjta dukuri u pasqyrua edhe në bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës. Sipas Kodit Zgjedhor, autoritetet vendore janë të detyruara të pajisin, brenda 60 ditëve nga shpallja e ditës së votimit, të gjithë votuesit e regjistruar dhe të ligjshëm me infomacionin e nevojshëm mbi vendodhjen e qendrës së votimit. Megjithatë, KZLNDQ raporton se në përgjithësi votuesit nuk u njoftuan nga autoritetet vendore përkatëse për shkak të kufizimeve buxhetore dhe delegimit të përgjegjësive midis autoriteteve vendore dhe atyre qendrore. Kjo mund të jetë arsyeja kryesore pse votuesit nuk i gjetën emrat në listat e votuesve. Duhet përmendur fakti se votuesit kanë mundësi të gjejnë vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit duke kontaktuar KZAZ-në, duke kontrolluar listat e votuesve të postuara në qendrat e votimit, ose duke vizituar faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme. Më shumë punë nevojitet për të ofruar informimin e duhur të votuesve në të ardhmen, promovimin e mëtejshëm për të kontrolluar dhe përdorur burimet asistuese.

Për më tepër, vëzhguesit e KZLNDQ-së vunë në dukje se disa nga këto incidente ndodhën për shkak të ndarjes së disa qendrave të votimit në dy të tilla, brenda së njëjtës godinë. Kjo është një praktikë e lejuar nga Kodi Zgjedhor në ato raste kur numri i votuesve të regjistruar në një qendër votimi është më i madh se 1000 dhe një tjetër qendër votimi hapet brenda së njëjtës godinë për të lehtësuar ngarkesën me votuesit. Për këtë arsye, disa votues u paraqitën në qendrat e gabuara të votimit por në adresat e sakta të tyre. Ata u lejuan të votojnë vetëm pasi gjetën qendrën e sakte ku gjendej emri i tyre, brenda të njëjtës ndërtesë.

Pavarësisht incidentit, kjo dukuri është shqetësuese dhe mund të sjellë që votuesit e ligjshëm të përjashtohen nga procesi i votimit, në një situatë ku përgjegjësia është e përbashkët midis autoriteteve vendore dhe votuesve. Kjo gjetje përbën një shqetësim serioz sepse mund të ndërpresë administrimin e votimit dhe të pengojë aftësinë e votuesve për të ushtruar të drejtën për të votuar. KZLNDQ i bën thirrje KQZ-së të luajë një rol më aktiv në monitorimin e krijimit të listave të votuesve.

KZLNDQ ka kënaqësinë të vërë në dukje se pothuajse në të gjithë vendin u respektua e drejta e vëzhguesve të pavarur për të qenë të pranishëm në qendrat e votimit dhe për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit. Në 98% të qendrave të votimit në rang vendi vëzhguesit ushtruan të drejtat e tyre të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.⁹² U raportuan disa incidente të izoluara, më së shumti gjatë procedurave të hapjes dhe mbylljes së qendrave të votimit. Vëzhgimet në Tiranë, Durrës dhe Shkodër pasqyruan gjetjet në rang vendi.

⁹² Infomacion mbi këtë variabël mund të gjeni në Aneksin e Metodologjisë.

Në 95% të qendrave të votimit në rang vendi ishte i pranishëm të paktën një vëzhgues partiak. Vëzhguesit e dy partive të mëdha, PS dhe PD, qenë të pranishëm në rreth 90% të QV-ve. Vëzhguesit e LSI qenë të pranishëm në rreth 80% të QV-ve. Të njëjtat gjetje pasqyrohen në Tiranë dhe Shkodër, ndërkohë që në Durrës, të treja partitë ishin të pranishme me vëzhguesit përkatës në 95% të qendrave të votimit.

Përfaqësimi gjinor

Nën-perfaqësimi i grave vazhdon të jetë një dukuri shqetësuese për KZLNDQ-në, sepse partitë politike dështuan në respektimin e plotë të angazhimit të ndërmarrë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor.

Në 37% të qendrave të votimit në rang vendi nuk pati anëtare femra në komisionet e QV-ve. Nuk kishte komisionere femra në 28% të qendrave të votimit në Durrës dhe në 40% të QV-ve në Shkodër. Situata prezantohej më e mirë në Tiranë, ku komisionerët femra mungonin në vetëm 13% të qendrave të votimit.

Vetëm në 14% të qendrave të votimit në rang vendi kryetarja e komisionit ishte një grua. Durrësi dhe Shkodra pasqyrojnë të njëjtën prirje, ndërkohë situata është më e mirë në Tiranë dhe Himarë. Tirana ka një përqindje kryetaresh femra dy herë më të lartë se në rang vendi, me 28%.

KZLNDQ shpreh keqardhjen mbi faktin se administrata zgjedhore e nivelit të tretë vazhdon të vuajë një përfaqësim jashtëzakonisht të ulët të gjinisë femërore.

Të drejtat e votuesve që nuk mund të votojnë vetë

Të gjithë votuesit, edhe ata që kanë nevojë për asistencë ose kanë aftësi të kufizuara, kanë të drejtën të votojnë lirisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në fshehtësi. KZLNDQ vë në dukje mungesa serioze në të gjithë vendin për sa i përket garantimit të të drejtës për të marrë pjesë në votime për votues që kanë nevojë për asistencë.

Më shumë se 57% e qendrave të votimit në rang vendi nuk kishin rampe ose ashensore, gjë që i bënte këto qendra votimi të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Pothuajse të njëjtat gjetje u vunë re në Tiranë (53%), Durrës (62%) dhe Shkodër (48%).

Pothuajse 90% e votuesve që kishin nevojë për asistencë qenë në gjendje të votonin me ndihmën e një votuesi të regjistruar dhe vetëm kur kjo ndihmë u kërkua specifikisht.

Procedurat e Mbylljes

Mbyllja e qendrave të votimit kaloi e qetë dhe në përgjithësi u respektuan procedurat e mbylljes. Shumica e qendrave të votimit u mbyllën në kohë dhe u garantua e drejta e votuesve të ligjshëm për të votuar deri në orën 19:00. Komisionet e QV-ve respektuan me rigorozitet procedurat për përgatitjen e kutive të votimit për transportim, duke i vulosur dhe siguruar në praninë e personave të autorizuar. Megjithatë, një e katërta e komisioneve të qendrave të votimit nuk ishin në gjendje të përputhnin numrin total të fletëve të votimit me numrin e fleteve të votimit të marra në dorëzim nga KZAZ-ja në momentin e çeljes së qendrës së votimit.

KZLNDQ monitoroi procesin e mbylljes së QV-ve, sigurimin dhe vulosjen e kutive të votimit, rakordimin e fletëve të votimit, praninë e personave të paautorizuar dhe praktikën e protokollit të

mbylljes (përfshi personat që shoqëruan kutitë e votimit gjatë transportit). Të dhënat mbi këtë fazë u mbledhën për 99% të kampionit përfaqësues kombëtar.

Tabela më poshtë përmbledh situatën në qendrat e votimit gjatë orarit zyrtar të mbylljes:

TABELA 42: Situata në orarin zyrtar të mbylljes: 19:00

| | Votimi mbyllet (s'ka radhë) | Votimi vazhdon (votuesit lejohen të votojnë pas orës 19:00) | Mospërputhje me numrin e fletëve të votimit (numëri i fv në mbyllje ndryshon nga ai në hapje) | Persona të paautorizuar janë të pranishëm | Incident kritik (ndërprerje e procesit për më shumë se 30 minuta) | Ndiqet protokoli zyrtar | Probleme me transportin e kutisë së votimit |
|-------------------------|-----------------------------|---|---|---|---|-------------------------|---|
| Në rang kombëtar | 79% | 8% | 23% | 2% | 1% | 100% | 1% |
| Tirana | 77% | 10% | 25% | 3% | 1% | 99% | 2% |
| Shkodër | 84% | 9% | 18% | 1% | 1% | 99% | 0% |
| Durrës | 71% | 14% | 21% | 1% | 0% | 100% | 1% |

Koha zyrtare e mbylljes ditën e votimit është ora 19:00. Votimi mund të vazhdojë nëse ka ende votues në radhë. Por votuesit nuk lejohen të votojnë nëse ata paraqiten në qendrën e votimit pas orës 19:00, gjithmonë sipas Kodit Zgjedhor.

Në përgjithësi votimi u mbyll në orën 19:00 dhe 79% e qendrave të votimit nuk kishin radhë pritjeje në orën zyrtare të mbylljes. Shtatëmbëdhjetë përqind e qendrave të votimit që kishin votues në radhë në orën 19:00 ndenjën hapur derisa votuesi i fundit në radhë mundi të votonte. Në 19 qendra votimi ku kishte radhë votuesish në orën 19:00, këta të fundit nuk u lejuan të votonin pas orarit zyrtar të mbylljes. Ndërkohë, në 8 qendra votimi u lejuan të votonin votues të cilët u paraqitën në qendrën e votimit pas orës 19:00. Të dhëna të ngjashme janë raportuar mbi bashkitë Tiranë, Durrës dhe Shkodër në lidhje me votimin gjatë orarit zyrtar të mbylljes. Nuk u gjet asnjë lidhje midis qendrave të votimit që u hapën vonë dhe atyre që u mbyllën vonë, duke sugjeruar se si hapja, ashty edhe mbyllja vlerësohen si faza teknike nga ana e komisionerëve të qendrave të votimit.

Njëzetë e tre përqind (23%) e qendrave të votimit raportuan mospërputhje në numërimin final të fletëve të votimit, përfshi të dhënat mbi sa fletë u përdorën, nuk u përdorën, të pavlefshme, të cilat nuk përputheshin me numrin e fletëve të votimit të marra në dorëzim në momentin e hapjes së qendrës së votimit. Pati incidente ku vëzhguesit e KZLNDQ-së nuk u lejuan të vëzhgonin procedurat e mbylljes dhe nuk u pajisën me protokollin final nga ana e KQV-së dhe si rrjedhim nuk mund të merrnin të dhëna mbi numërimin final të fletëve të votimit gjatë mbylljes. Përsa u përket zgjedhjeve të ardhshme, Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë qarte detyrimin që kanë komisionerët për të pajisur me një kopje të procesverbalit të mbylljes vëzhguesit e pranishëm gjatë kësaj procedure në mënyrë që të mundësohet raportimi i saktë i numërimit final të fletëve të votimit.

Vëzhguesit e KZLNDQ vëzhguan në disa raste në rang kombëtar prezencën e personave të paaautorizuar në qendrat e votimit, pezullimin e procedurave të mbylljes për më shumë se tridhjetë minuta dhe shkelje të tjera proceduriale si mospajtimi dhe mosvulosja e kutisë së votimit përpara transportit, të cilat, gjithsesi, mbetën në nivele të izoluara. E njëjta prirje u vu re edhe në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Vëzhguesit e partive politike dorëzuan ankesa zyrtare në 7% të qendrave të votimit në rang kombëtar, gjë që sugjeron se në përgjithësi partitë politike nuk kanë pasur probleme me mbarëvajtjen e votimit. PS dhe PD kanë kryer ankesa zyrtare në 5% të qendrave të votimit, ndërsa LSI në 3%. Tirana dhe Durrësi pasqyruan nivele të njëjta ankesash, respektivisht me 3% dhe 5% të qendrave të votimit. Në Shkodër ankesat zyrtare u dorëzuan në 11% të qendrave të votimit.

Situata pas zgjedhore

Procesi i numërimit të votave

Pas mbylljes së procesit të votimit, kutitë me fletët e votimit dhe materialet zgjedhore u transportuan drejt Qendrave të Numërimit. Skuadrat e numërimit janë përcaktuar 10 ditë para ditës së votimit dhe ishin të përbëra nga 4 anëtarë të propozuar nga partitë politike⁹³. Çdo skuadër duhet të numëronte 5 deri në 10 qendra votimi dhe zëvendësohej nga një skuadër tjetër në fund të procesit.⁹⁴ Bazuar në Kodin Elektorale dhe Vendimet e KQZ⁹⁵, procesi i numërimit u nda në dy faza. Në fillim të procesit u numëruan votat për kandidatët për kryetare/ë bashkie dhe më pas vazhdoi numërimi për anëtarë/ët e këshillave bashkiakë. Procesi i numërimit të votave filloi në orare të ndryshme në të gjithë Shqipërinë pak pas orës 23.00 të datës 21 qershor 2015 dhe vazhdoi 2 deri në 4 ditë në pothuaj të gjitha VNV-të. Procesi i numërimit u ndoq nga afër nga vëzhguesit vendorë, vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vëzhguesit e partive politike (PS, PD, LSI, PR, PDIU).

Zyrtarisht procesi i numërimit për Zgjedhjet Lokale 2015 u mbyll në datën 28 Qershor 2015, rreth shtatë ditë pas zhvillimit të zgjedhjeve, ndërkohë që Kodi Zgjedhor parashikon që Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve për çdo ZAZ duhet të nxirren nga KZAZ jo më vonë se ora 22.00 e ditës së nesërme të votimit. Krahasuar me zgjedhjet vendore të vitit 2011, i cili zgjati afro 14 ditë, procesi i numërimit të votave nuk reflekton përmirësime të dukshme, pasi për zgjedhjet lokale të vitit 2011 në Tiranë u votua për katër organe të qeverisjes vendore⁹⁶, për rrjedhojë numri i kutive të votimit të numëruara ishte dyfishi i atyre në zgjedhjet e tanishme.⁹⁷ Menjëherë pas përfundimit, KQZ deklaroi publikisht përmbylljen e procesit dhe rezultatin e numërimit të votave dhe rezultatit të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e numërimit të votave.

⁹³ Kodi Zgjedhor, Neni 95/2 Një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, të cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtarë i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtarë i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive.

⁹⁴ Kodi Zgjedhor, Neni 95/4

⁹⁵ Sipas Nenit 12, udhëzimi Nr. 5 i KQZ-së datë 22.04.2015, për fazën e parë, numërimi fillon me numërimin e votave për kryetar bashkie dhe pasi çdo VNV deklaron rezultatin nis faza tjetër.

⁹⁶ Kryetar i Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Kryetar të Minibashkive dhe Anëtarë të Këshillave të Minibashkive.

⁹⁷ Kodi Zgjedhor, Neni 122/1, 123/1

Rreth 300 vëzhgues të KZLNDQ ndoqën procesin e numërimit të votave dhe do aspect të tij në 90 VNV duke përfshirë; Raportimin e procedurave; Pajisjet e VNV-ve; Përbërjen e grupeve të pranimit; Vendimet e KZAZ-ve dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të numërimit në çdo VNV. Incidentet janë raportuar në kohë reale në qendrën e komunikimit.

Gjetjet nga monitorimi i procesit të numërimit të votave

Nga pikëpamja kohore, procesi i numërimit të votave shënoi përmirësim krahasuar më zgjedhjet e kaluara. Pavarësisht disa rasteve të ndërprejeve, vëzhguesit e KZLNDQ e vlerësuan procesin e numërimit në tërësi si të rregullt dhe të zhvilluar në një atmosferë bashkëpunimi. Megjithatë, ende duhet të plotësohen disa kërkesa ligjore drejt përmirësimit të mëtejshëm të procesit.

Vëzhgimi tregoi se pas mbërritjes së kutive të votimit, grupet e pranimit kanë ndjekur procedurat e duhura lidhur me verifikimin e vulave të sigurisë. Gjatë pranimit në qendrat e numërimit, vetëm 21 kuti votimit u deklaruan të parregullta për shkak të mungesës së kopjeve origjinale të vendimeve të KQV-së, mungesës së numrave përkatëse serialë ose kodet e sigurisë të dëmtuara në dokumentacionin shoqëruar të fletëve të votimit (KZAZ 71, 74, 2, 26, 39, 43, 68). Nga deklaratimet e vëzhguesve tanë, vendimet e KZAZ-ve për vlerësimin e vlefshmërisë së kutive të votimit, pranimit e tyre dhe kalimin në procesin e numërimit u bënë në liri të plotë, pa asnjë lloj presioni.

Vëzhguesit KZLNDQ raportuan 20 raste të ndërprerjeve për shkak të konflikteve mes numëruesve dhe vëzhguesve të partive politike, të cilat nuk e penguan në mënyrë të konsiderueshme procesin e numërimit dhe rezultatet. KZAZ-të shpesh vendosi të ndërpresë numërimin për shkak të lodhjes dhe mbingarkesës, pavarësisht dispozitave të Kodit Zgjedhor sipas të cilave numërimi vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në përfundimin e të gjitha kutive të rregullta të votimit. Puna më turpe e të grupeve të numërimit, si dhe anëtarëve të KZAZ-së do të lehtësonte procesin e numërimit dhe do të eliminonte humbjen e panevojshme të kohës.

Sipas raportimeve, ka pasur 39 raste kur procesi i numërimit të votave është ndërprerë apo pezulluar për më shumë se 25 minuta. Vlen të përmendet në këtë pikë se pas përfundimit të numërimit të votave për kandidatët për kryetar bashkie, komisionet e numërimit të votave kanë marrë vendim për të bërë ndërprerje disa orarësh të procesit të numërimit, 4 deri në 10 orë, gjë që bie ndesh me Kodin Zgjedhor Kodi Zgjedhor.⁹⁸ Të dy grupet e numërimit për çdo tryezë zëvendësojnë njëri-tjetrin, në mënyrë që procesi të vazhdojë pa ndërprerje. Rrjedhimisht, këto ndërprerje mbeten të pajustificuara.

Vëzhgimi i KZLNDQ tregoi se numërimi ka filluar në kohë të ndryshme në VNV të ndryshme. Në dy të tretat (58 VNV) e tyre numërimi filloi para orës 02:00 të 22 qershorit. Njëzet e pesë (25) VNV nisën punën pas marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, nga ora 22:00 deri në 00:00. Nga raportimet e marra prej vëzhguesve tanë, në 33 VNV procesi i numërimit filloi në frekuencën 00:00 - 02:00 të datës 22 qershor, në 17 VNV rreth orës 02:01- 04:00 dhe 5 vende të

⁹⁸Kodi Zgjedhor, Neni 95/4 “Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Në përfundim të këtij procesi grupi i numërimit zëvendësohet nga grupi tjetër i numërimit”.

numërimit të votave nisën procesin e numërimit pas orës 06:00, në mëngjesin e datës 22 Qershor. Malësia e Madhe (KZAZ Nr. 1) përfaqësoi rastin më problematik në këto zgjedhje duke qenë se procesi i numërimit filloi me dy ditë vonesë.

Pati shtatë (7) raste kur vëzhguesit e KZLNDQ u penguan të kryenin detyrën e tyre. Pati 1 (një) rast kur vëzhguesja u pengua të merrte pjesë në procesin e dorëzimit dhe pranimit të materialeve zgjedhore dhe 6 (gjashtë) raste (përkatësisht në VNV nr 26 (Vora), 36 (nr. 6, Tirana) 67 (Pogradec), 83 (Vlora), 84 (Vlora) kur vëzhguesit u penguan dhe nuk u lejuan të vazhdonin vëzhgimin gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatët e këshillave bashkiakë, me justifikimin e mbipopullimit dhe mosnjohjes së autorizimit dhënë nga KQZ për vëzhguesit e pavarur.

Gjatë numërimit të materialeve zgjedhore të VNV nr.1 Malësi e Madhe, të realizuar nga stafi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ishin të pranishëm vëzhgues partiakë (një vëzhgues nga çdo parti politike) dhe nuk u lejua pjesëmarrja e vëzhguesve të pavarur me arsyetimin e numrit të madh të vëzhguesve të pavarur të interesuar për të ndjekur procesin. Pavarësisht nga prania konsiderueshme e vëzhguesve të pavarur dhe politike, organizimi i mjediseve të VNV-ve nuk garantonte një transparencë të plotë e procesit. Distanca e tavolinave nga vëzhguesit pengonte sigurimin e një pamje të plotë të të gjitha procedurave.

Gjithashtu, është raportuar se në 17 (shtatëmbëdhjetë) raste, në vendet e numërimit të votave ka pasur persona të pautorizuar dhe pa akreditimin përkatës.⁹⁹ Sipas nenit 121 të Kodit Zgjedhor, përveç anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së dhe anëtarëve e grupeve të numërimit, vetëm vëzhguesit e subjekteve zgjedhore dhe të vëzhgues të tjerë të akredituar janë të lejuar në VNV. Duket se pavarësisht se procesi i numërimit ka qenë përgjithësisht i qetë, janë evidentuar 5 raste dhune verbale dhe fizike në VNV-të, përkatësisht në VNV nr. 1 (Malësi e Madhe) 26 (Vorë), 44 (Peqin), 57 (Fier) dhe 58 (Fier).

Procesi i numërimit përfundoi në të gjitha VNV-të në datë 28 Qershor. Ndër VNV-të e fundit të cilat përmbyllën këtë proces ishin ato të Kamzës, Vorës, disa VNV në Durrës (nr. 20, 21, 22, 23), në Tiranë (nr. 35, 39) dhe numërimi I VNV-së Nr. 1 Malësi e Madhe i cili u zhvillua më vonë në Tiranë. Duke pasur parasysh vonesat dhe bllokimet e vazhdueshme, KQZ mori një vendim (nr. 751, data 06.07.2015) për të transferuar 20 kutitë e votimit në Tiranë, të cilat u numëruan nga stafi i KQZ në mjediset e shkollës 9 vjeçare “1 Maji” në Tiranë.

KZAZ-të morën 23 ankesa zyrtare në lidhje me numërimin nga vëzhguesit e partive politike. Ato përfshijnë:

- 1- 10 ankesa nga Partia Demokratike në KZAZ 68 (Maliq), KZAZ 48 (Elbasan), KZAZ 71 (Korce), KZAZ 39 (Tirana) and KZAZ 26 (Vore).
- 2- 4 ankesa e kundër CEAZs nga Partia Socialiste në KZAZ 39 (Tirane), KZAZ 3 (Shkoder), KZAZ 22 (Durrës) and KZAZ 16 (Mat).

⁹⁹KODI ZGJEDHOR, Neni 121“Gjatë procesit të numërimit të votave, në vendin e numërimit të votave janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, anëtarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësues të akredituar të medias, si dhe personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, i autorizuar nga KQZ-ja.”

- 3- 4 ankesa nga Partia Socialiste për Integrim në KZAZ 26 (Vorë), KZAZ 23 (Durrës) dhe KZAZ 73 (Ersekë).
- 4- 1 ankesë nga partia Republikane në KZAZ 26 (Vorë).
- 5- 1 ankesë nga Partia për Ligj dhe Drejtësi në KZAZ 5 (Shkoder).

RRETH KZLNDQ

Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një organizatë e pavarur, jopartiake, e krijuar për të promovuar pjesëmarrjen qytetare në zgjedhje dhe për të siguruar demokracinë e qëndrueshme. KZLNDQ përqendrohet në çështje që ndikojnë në zbatimin e të drejtave të njeriut, çështjet e barazisë gjnore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

KZLNDQ ka nënshkruar Deklaratën e Parimeve Globale për Vëzhgim të Paanshëm të Zgjedhjeve dhe Monitorim nga Organizatat e Qytetarëve si dhe Kodin e saj të Sjelljes të GDNEM (Rrjeti Global i Vëzhguesve Vendorë për Monitorimin e Zgjedhjeve) që parashtron qartësisht deklaratën e parimeve dhe kodin e sjelljes për monitorimin e pavarur të zgjedhjeve nga organizatat qytetare. Metodologjia e vëzhgimit të zgjedhjeve të KZLNDQ është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të përfshira në dokumentet ndërkombëtare, si Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

KZLNDQ, nga 6 qershori 2015, përbëhet nga 30 organizata partnere dhe qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë që ndihmojnë KZLNDQ-në për vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të 21 qershorit 2015.

Projekti për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it dhe zbatohet me asistencën teknike të Institutit Demokratik Amerikan, NDI.

RRETH PROJEKTIT “Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve në Shqipëri”

Metodologjia e vëzhgimit afatgjatë të KZLNDQ-së është bazuar në standardet ndërkombëtare e cila jep paraqitjen e disa elementëve kryesorë të fushatës si dhe identifikimin dhe dokumentimin e problemeve, nëse ato ndodhin. KZLNDQ angazhoi 90 vëzhgues të trajnuar, të pavarur për të gjitha 90-të Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për të vëzhguar përpara ditës së zgjedhjeve. Misioni i tyre filloi në datën 22 maj dhe përfundon me ditën e zgjedhjeve, 21 Qershor 2015. Gjatë kësaj periudhe vëzhguesit monitoruan punën e administratës elektorale, fushatën e kandidatëve të partive politike, kandidatët e pavarur, si dhe dhe përdorimin e mundshëm të fondeve publike apo abuzimin me zyrat publike për qëllime elektorale. KZLNDQ monitoroi nga afër zbatimin e kërkesave ligjore për listat e votuesve, përfaqësimi gjinor në administratën zgjedhore dhe në listat e kandidatëve, si dhe përgatitjet për të siguruar qasje për të gjithë popullatën në qendrat e votimit.

Ditën e zgjedhjeve, KZLNDQ, do të përdorë një metodologji statistikore në planin e saj të vëzhgimit. KZLNDQ ka përdorur të njëjtën metodologji në planin e vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të viti 2013 për qarkun e Tiranës. Kjo metodologji, e njohur si vëzhgim i bazuar në statistika, është një mënyre shumë e mirë e që do t'i japë mundësi KZLNDQ të vlerësojë me besueshmëri procesin e ditës së zgjedhjeve (hapjen, votimin, mbylljen e qendrave të votimit) për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjithashtu edhe në bashkitë Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Himarë.

KZLNDQ shpërndau në të gjithë vendin 1000 vëzhgues të paanshëm e të palëvizshëm, në bazë të një kampioni të rastësishëm dhe përfaqësues në rang kombëtar, si dhe në nivelin e bashkive të Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit. Të dhënat cilësore të KZLNDQ-së kanë një nivel besueshmërie 95%, me marzh gabimi +/- 4% në nivel kombëtar, +/- 5% për Tiranën, +/- 5% për Durrësin, dhe +/- 5% për Shkodren. Shkalla e raportimit nga kampioni kombëtar ishte 100%, ndërkohë që për bashkitë e përzgjedhura si Tirana, Durrësi dhe Shkodra ishte mbi 95%. Të dhënat që mungojnë ishin të shpërndara proporcionalisht në të gjithë vendin dhe nuk komprometojnë besueshmërinë e të dhënave.

Pas ditës së zgjedhjeve, KZLNDQ dërgoi rreth 300 vëzhgues në të gjitha qendrat e numërimit në të gjithë vendin, në mënyrë që të ishte në gjendje të analizonte procesin e numërimit. Vëzhguesit e KZLNDQ-së monitoruan të gjithë procesin e numërimit, duke lluar nga marrja e materialeve nga KZAZ-ja deri në nxjerrjen e rezultateve. KZLNDQ nuk e monitoroi procesin e transportimit të kutive të votimit nga qendra e votimit në qendrën e numërimit.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së u trajnuan nga stafi i KZLNDQ-së për të vëzhguar periudhën para-zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve. Vëzhguesit përdorën një formë të standartizuar për të regjistruar vërejtjet e tyre, të cilat u transmetuan më pas në qendrën e komunikimit të KZLNDQ -së në Tiranë. Çdo vëzhgim u hodh më tej në një bazë të dhënash, projektuar posaçërisht për këtë qëllim dhe që lejoi KZLNDQ-në të mblidhte dhe të analizonte lehtësisht të dhënat. Pas analizes së të dhënave, KZLNDQ përgatiti deklarata gjatë gjithë periudhës para-zgjedhore, në ditën e zgjedhjeve dhe pas procesit të numërimit për të ndarë me publikun dhe aktorët e zgjedhjeve gjetjet e rëndësishme lidhur me cilësinë e procedurave zgjedhore dhe shkeljet e mundshme të tyre.

KZLNDQ-ja publikoi raporte bazuar në gjetjet e vëzhguesve të saj gjatë procesit para-zgjedhor, duke përfshirë edhe një raport paraprak para ditës së zgjedhjeve. Më 19 qershor 2015, KZLNDQ-ja organizoi një simulim të ditës së zgjedhjeve, në selinë e saj, për të testuar mekanizmat e mbledhjes dhe marrjes së të dhënave nga vëzhguesit. Dita e simulimit përfshiu të gjithë vëzhguesit që u vendosen në ditën e zgjedhjeve mbi bazën e njëjësive kampionë në të gjithë Shqipërinë dhe operatorëve të komunikimit në selinë qendrore.

Të gjitha informacionet u postuan në kohë reale në faqen e internetit të Koalicionit: www.kzln.org.al dhe rrjetet sociale.

FALENDERIME

Gjatë zbatimit të projektit KZLNDQ ka marrë një mbështetje të madhe nga vëzhguesit, qytetarët, media, administrata zgjedhore, donatorët dhe ekipi bazë që kanë kontribuar në arritjen e objektivave të projektit. Mbështetja financiare dhe mbështetje teknike kanë siguruar cilësi të lartë dhe kushte të përshatshme pune si dhe një themel të fortë për të përmbushur qëllimet e projektit. Media ka luajtur një rol thelbësor përmes transmetimit dhe raportimit të aktiviteteve të KZLNDQ për publikun.

Ne do të donim të falënderonim të gjithë vëzhguesit tanë, të cilët kanë punuar në pa kompromis, me devotshmëri, përkushtim dhe profesionalizëm, duke u bërë një kontribut i rëndësishëm për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në Shqipëri. Ata përfaqësuan pa asnjë dyshim fuqinë dhe motivimin e procesit të monitorimit.

Gjithashtu, do të donim të falënderonim organizatat partnere të KZLNDQ në të gjithë Shqipërinë, për angazhimin e paanshëm dhe profesional të drejtuesve, stafeve dhe atyre qytetarëve shqiptarë që përmes tyre u bënë vëzhgues së Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme, duke krijuar e konsoliduar kështu një rrjet më të qendrueshëm bashkëpunëtorësh në të ardhmen.

KZLNDQ falenderon veçanërisht Institutin Demokratik Amerikan në Shqipëri për mbështetjen teknike

Një falenderim i veçantë shkon për donatorin tonë USAID që përmes organizatës Assist Impact, mbështeti financiarisht KZLNDQ për realizimin me sukses të këtij misioni të rëndësishëm qytetar.

ANEKSET

Aneksi 1 – Tabela e adresave të KZAZ-ve

| Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ | Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ | Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ | Bashkia | Njësia Administrative | KZA |
|----------------|-----------------------|------|------------|-----------------------|------|--------------|-----------------------|------|---------|-----------------------|-----|
| Malësi e madhe | Koplik | 1 | | Nj. Bashkiake nr. 1 | 31 | Mallakastër | Ballsh | 61 | | | |
| | Shkodër | 2 | | Nj. Bashkiake nr. 2 | 32 | Ura vajguore | Ura vajguore | 62 | | | |
| | Shkodër | 3 | | Nj. Bashkiake Nr. 3 | 33 | Kuçovë | Kuçovë | 63 | | | |
| | Shkodër | 4 | | Nj. Bashkiake Nr. 4 | 34 | Berat | Berat | 64 | | | |
| Vau i dejës | Shkodër | 5 | | Nj. Bashkiake Nr. 5 | 35 | Polican | Polican | 65 | | | |
| | Bushat | 6 | | Nj. Bashkiake nr. 6 | 36 | Skrapar | Çorovodë | 66 | | | |
| Pukë | | 7 | | Nj. Bashkiake nr. 7 | 37 | Pogradec | Pogradec | 67 | | | |
| Fushë arrëz | | 8 | | Nj. Bashkiake Nr. 8 | 38 | Maliq | Maliq | 68 | | | |
| Tropojë | Bajram curri | 9 | | Nj. Bashkiake Nr. 9 | 39 | | Pustec | 69 | | | |
| Has(Krumë) | Krumë | 10 | | Nj. Bashkiake Nr. 10 | 40 | Devoll | Bilisht | 70 | | | |
| | Kukës | 11 | | Nj. Bashkiake Nr. 11 | 41 | Korçë | Korçë | 71 | | | |
| Lezhe | Lezhë | 12 | Kavajë | Kavajë | 42 | | Korçë | 72 | | | |
| | Lezhë | 13 | Rrogozhinë | Rrogozhinë | 43 | Kolonjë | Ersekë | 73 | | | |
| Kurbini | Laç | 14 | Peqin | Peqin | 44 | Këlcyrë | Përmet | 74 | | | |
| | Rrëshen | 15 | Belsh | Belsh | 45 | Përmet | Këlcyrë | 75 | | | |
| Mat | Burrel | 16 | Cërrik | Cërrik | 46 | Memaliaj | Memaliaj | 76 | | | |
| | Klos | 17 | | Elbasan | 47 | Tepelenë | Tepelenë | 77 | | | |
| Bulqizë | Bulqizë | 18 | Elbasan | Elbasan | 48 | Gjirokastrë | Gjirokastrë | 78 | | | |
| | Dibër | 19 | | Elbasan | 49 | Libohovë | Libohovë | 79 | | | |
| Krujë | Krujë | 20 | | Elbasan | 50 | Dropull | Jorgucat | 80 | | | |
| | Durrës | 21 | Gramsh | Gramsh | 51 | Vlorë | Vlorë | 81 | | | |

| Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ | Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ | Bashkia | Njësia Administrative | KZAZ |
|---------|-----------------------|------|----------|-----------------------|------|----------|-----------------------|------|
| | Durrës | 22 | Librazhd | Librazhd | 52 | | Vlorë | 82 |
| | Durrës | 23 | Prenjas | Prenjas | 53 | | Vlorë | 83 |
| | Durrës | 24 | Lushnjë | Lushnjë | 54 | | Vlorë | 84 |
| Shijak | Shijak | 25 | Lushnjë | Lushnjë | 55 | Selenicë | Kotë | 85 |
| Vorë | Vorë | 26 | Divjakë | Divjakë | 56 | Himarë | Himarë | 86 |
| Kamëz | Kamëz | 27 | Fier | Fier | 57 | Delvinë | Delvinë | 87 |
| | Paskuqan | 28 | Fier | Fier | 58 | Sarandë | Sarandë | 88 |
| Tiranë | Kashar | 29 | Patos | Patos | 59 | Livadhja | Dermish | 89 |
| | Bërzhitë | 30 | Roskovec | Roskovec | 60 | Konispol | Konispol | 90 |

Anex 2 – Pyetsori përdorur nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve të 21 qershorit 2015.



Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme
Pyetësi i vëzhguesve në ditën e votimit për zgjedhjet e
Organeve të Pushtetit Vendor, 21 Qershor 2015

Ju lutem plotësoni të gjithë pyetësin!

Kodi i Vëzhguesit:

| | |
|---|--|
| Numri i Qendrës së Votimit: | Emri dhe Adresa e Qendrës së Votimit: |
| Emri dhe Mbiemri i Vëzhguesit | Numri i Telefonit të Vëzhguesit: |
| Emri i Koordinatorit | Numri i Telefonit të Koordinatorit: |
| Numri ku duhet të dërgoni SMS (mesazhet telefonike): | +31614793545 |
| Numrat e Qendrës së Komunikimit: (Do merrni në këta numra VETËM në rastet e incidenteve!) | 0692477405 ; 0692477551; 0692477552; 0692477574; 0692477576; |

| SMS 1 – Hapja e Qendrës së Votimit | | | | | | | | | | |
|---|--|------------------------------|--|--------------------------|--------------------------|-----------|----|---|---|----|
| KUIDES! Ju duhet të dërgoni SMS në numrin +31614793545në orën 07:15 | | | | | | | | | | |
| AB | Cili është numri i qendrës tuaj të votimit (numri duhet të jetë i shënuar qartazi në hyrje të Qendrës së Votimit)? Vini re! Numri mund të ketë 4 deri në 5 shifra. Nëse numri i Qendrës tuaj të Votimit ka katër shifra atëherë vendosni një zero përpara numrit kur të dërgoni SMS. | | | | | | | | | AB |
| AC | Në çfarë ore u hap Qendra e Votimit? Nëse u hap pas orës 7:10, ose nuk u hap fare, plotësoni formularin e incidentit kritik. | Përpara orës 06:50 (1) | Nga ora 06:50 – në orën 07:10 (2) | Pas orës 07:10 (3) | Nuk u hap fare (4) | AC | | | | |
| AD | Numri i votuesve të regjistruar (lista e votuesve) në Qendrën e Votimit | | | | | | | | | AD |
| AE | Numri i fletëve të votimit të dorëzuara pranë Qendrës së Votimit nga KZAZ | | | | | | | | | AE |
| AF | A ishte bosh kutia e votimit dhe ju tregua vëzhguesve përpara se të mbyllej me kodet e sigurisë? Nëse jo, ju lutem plotësoni formën e incidentit kritik. | | | | PO (1) | JO (2) | AF | | | |
| AG | A u shënuan numrat e vulave të sigurisë që mbyllën kutinë e votimit në Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV? | | | | PO (1) | JO (2) | AG | | | |
| AH | A ju dha Kopje e Procesverbalit të Vulosjes nga KQV anëtarëve të saj dhe vëzhguesve të partive politike? | | | | PO (1) | JO (2) | AH | | | |
| AJ | A i kishte qendra e votimit TË GJITHA materialet e listuara më poshtë? [Fletët e votimit, Listën e votuesve, Kutinë e Votimit, Bojën timbruese, vulat zyrtare, dhomën e fshehtë të votimit] Nëse jo, plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve dhe shpjegoni çfarë mungon. | | | | PO (1) | JO (2) | AJ | | | |
| AK | A ishin të shtatë anëtarët e Qendrës së Votimit kur u hap qendra e votimit? | | | | PO (1) | JO (2) | AK | | | |
| AM | Sa nga anëtarët e qendrës së votimit ishin gra? | 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | AM |
| AN | A është grua kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit? | | | | PO (1) | JO (2) | AN | | | |
| AP | A ishte e aksesueshme për njerëzit me aftësi të kufizuara qendra e votimit (a kishte rampa apo ashensorë) ? | | | | PO (1) | JO (2) | AP | | | |
| AQ | A pati ndonjë moment kur ju ndaluan ju apo ndonjë mbikqyrës tjetër të mbikqyrnit procesin e votimit apo kur ju penguan/refuzuan qasjen ndaj informacionit rreth procesit? Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | | PO (1) | JO (2) | AQ | | | |
| AR | A vëzhguat shkelje të rënda që mund të ndikojnë në procesin zgjedhor dhe rezultatet e tij? Për një listë të shkeljeve të mundshme konsultoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | | PO (1) | JO (2) | AR | | | |
| AS | A u organizua nga ndonjë parti apo kandidat fushatë brenda rrezes 150 m larg nga Qendra e Votimit ku ju po vëzhgoni (kjo përfshin dhe materialet propagandistike) Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | | PO (1) | JO (2) | AS | | | |

MONITORIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE, 21 QERSHOR 2015, NË SHQIPËRI - RAPORT PËFUNDIMTAR

| | | | | | | | | |
|--|--|-------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| Cdo SMS duhet të fillojë me V dhe kodin e vëzhguesit | Pyetja AB Mund të jetë me 4 ose me pesë shifra. Nëse është me 4 shifra, duhet ta filloni me zero | Pyetja AC (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja AD (ndoshta më pak se 1000) | Pyetja AE (ndoshta më pak se 1000) | Pyetja AF (1 ose 2) | Pyetja AG (1 ose 2) | Pyetja AH (1 ose 2) | Pyetja AJ (1 ose 2) |
| V | A B | A C | A D | A E | A F | A G | A H | A J |

| | | | | | | |
|------------------------|-----------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| Pyetja AK (1 ose 2) | Pyetja AM (0 to 7) | Pyetja AN (1 ose 2) | Pyetja AP (1 ose 2) | Pyetja AQ (1 ose 2) | Pyetja AR (1 ose 2) | Pyetja AS (1 ose 2) |
| A K | A M | A N | A P | A Q | A R | A S |

Shembull: V01234AB01234AC1AD700AE700AF1AG1AH1AJ1AK1AM1AN1AP1AQ1AR1AS1

KUJDES!! Ky është vetëm një shembull. Mos nisni këtë si mesazh! Mesazhin me të dhënat tuaja do ta dërgoni në +31614793545

SMS 2 – Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhje ora 14:00

KUJDES! Ju duhet të dërgoni SMS në numrin +31614793545 në orën 14:00

| | | | | | | | |
|----|--|-----------|--|-----------|--|--|----|
| BA | Sa është numri i saktë i votuesve të cilët votuan nga hapja e qendrës deri në orën 14:00? <i>Ju lutem pyesni kryetarin e komisionit për këtë informacion.</i> | | | | | | BA |
| BC | Sa nga këta votues ishin gra e vajza? <i>Ju lutem pyesni kryetarin e komisionit për këtë informacion.</i> | | | | | | BC |
| BD | Sa nga këta votues ishin burra e djem? <i>Ju lutem pyesni kryetarin e komisionit për këtë informacion.</i> | | | | | | BD |
| BE | Sa zgjedhës kanë votuar me vendim gjykate? <i>Ju lutem pyesni kryetarin e komisionit për këtë informacion.</i> | | | | | | BE |
| BF | Sa zgjedhës kanë votuar të asistuar? <i>Ju lutem pyesni kryetarin e komisionit për këtë informacion.</i> | | | | | | BF |
| BG | A pati ndonjë moment kur ju ndaluan ju apo ndonjë mbikqyrës tjetër të mbikqyrnit procesin e votimit apo kur ju penguan/refuzuan qasjen ndaj informacionit rreth procesit? Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | | JO (2) | | | BG |
| BH | A vëzhguat shkelje të rënda që mund të ndikojnë në procesin zgjedhor dhe rezultatet e tij? Për një listë të shkeljeve të mundshme konsultoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | | JO (2) | | | BH |
| BJ | A pati ndonjë rast gjatë ditës kur procesi u pezullua për më shumë se 30 minuta? Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | | JO (2) | | | BJ |
| BK | A u organizua nga ndonjë parti apo kandidat fushatë brenda rrezes 150 m larg nga Qendra e Votimit ku ju po vëzhgoni (kjo përfshin dhe materialet propagandistike). Nëse po ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | | JO (2) | | | BK |

| | | | | | | | |
|--|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|------------------------|------------------------|
| Cdo SMS duhet të fillojë me V dhe kodin e vëzhguesit | Pyetja BA (numer) | Pyetja BC (numer) | Pyetja BD (numer) | Pyetja BE (numer) | Pyetja BF (numer) | Pyetja BG (1 ose 2) | Pyetja BH (1 ose 2) |
| V | B A | B C | B D | B E | B F | B G | B H |

| | | |
|------------------------|------------------------|--|
| Pyetja BJ (1 ose 2) | Pyetja BK (1 ose 2) | Shembull: V01234BA123BC123BD123BE1BF1BG1BH1BJ1BK1 KUJDES!! Ky është vetëm një shembull. KUJDES! Mos nisni këtë si mesazh! Mesazhin me të dhënat tuaja do ta dërgoni në +31614793545 |
| B J | B K | |

SMS 3 – Votimi

KUJDES! Ju duhet të dërgoni SMS në numrin +31614793545 në orën 19:00

| | | | | | | |
|----|---|--------------|--------------------|---------------------|-----------------------|----|
| CA | Sa votues u lejuan të votonin pa pasaportë ose kartë identiteti? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CA |
| CB | Sa votues u lejuan të votonin <u>pa</u> e patur emrin në listën e votimit dhe <u>pa</u> vendim gjykate? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CB |
| CD | Sa votues <u>nuk</u> u lejuan të votonin edhe pse kishin pasaportë, dhe kartë identiteti dhe emrin në listë ose vendim gjykate? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CD |

MONITORIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE, 21 QERSHOR 2015, NË SHQIPËRI - RAPORT PËFUNDIMTAR

| | | | | | | | | | |
|----|--|---|-----------------|------------------|--------------------|--------------------|--------|------------|----|
| CE | A u ndihmuan të gjithë votuesit që u shprehën se kishin nevojë për ndihmë? [Votuesit që për arsye fizike nuk kanë mundësi të votojnë vetë, kërkojnë ndihmën e një familjari apo zgjedhësi tjetër.] Nëse jo, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë votues nuk kërkoj ndihmë për të votuar (9) | PO (1) | JO (2) | CE | | | | |
| CF | Sa votues votuan në emër të tjerëve pa ju kërkuar asistencë dhe/ose pa u ndjekur kushtet dhe procedurat për asistimin në votim? [Kujdes! Personi që ndihmon duhet të jetë zgjedhës i asaj QV-je dhe bën deklaratë në librin e protokollit të komisionit të QV-së. Personi nuk mund të jetë anëtar komisioni dhe nuk mund të ndihmojë më shumë se një person] Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CF | | | |
| CG | Sa votues <u>nuk e gjetën</u> emrin e tyre në listat e votuesve? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CG | | | |
| CH | Sa votues <u>nuk u kontrolluan</u> nëse e kishin gishtin të ljer me bojën timbruese para se të votonin? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CH | | | |
| CJ | Sa votues <u>nuk u ngjyen</u> me bojën timbruese para se të votonin? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CJ | | | |
| CK | Sa votues me aftësi të kufizuar nuk mundën të votonin të pavarur dhe në fshehtësi në dhomën e fshehtë? Nëse ishin më shumë se 10, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | Nuk erdhi asnjë person me aftësi të kufizuar në qendrën e votimit (9) | Asnjë (1) | 1 deri në 5 (2) | 6 deri në 10 (3) | Më shumë se 10 (4) | CK | | |
| CM | A ishit dëshmitar i ndonjë incidenti të mbushjes së kutive të votimit me më shumë se një fletë votimi nga votues ose persona të tjerë, votimi më shumë se një herë i një zgjedhësi, blerje e votës, fletë votimi të plotësuar paraprakisht, përdorimi i aparateve celulare gjatë votimit, dhunë ose kërcënim, apo çfarëdo shkeljeje tjetër gjatë procesit të votimit? A u pezullua procesi në çfarëdo kohe gjatë ditës për më shumë se 30 minuta; A u organizua nga ndonjë parti apo kandidat fushatë brenda rrezes 150 m larg nga Qendra e Votimit ku ju po vëzhgoni? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | PO (1) | JO (2) | CM | | | |
| CN | A pati ndonjë moment kur ju ndaluan ju apo ndonjë mbikqyrës tjetër të mbikqyrnit procesin e votimit apo kur ju penguan/refuzuan qasjen ndaj informacionit rreth procesit? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | PO (1) | JO (2) | CN | | | |
| CP | Cilën parti përfaqësonin vëzhguesit partiakë që ishin prezentë në qendrën tuaj gjatë procesit të votimit? Shënoni të gjithë vëzhguesit që ishin prezentë në qendrën e votimit. | Asnjë 1 | PS 2 | PD 3 | LSI 4 | PR 5 | PDIU 6 | Të tjerë 7 | CP |

| | | | | | | | | | | |
|---|-------------------------------------|----------------------------|----------------------------|-------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| Çdo SMS duhet të fillojë me V dhe kodin e vëzhguesit | Pyetja CA (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CB (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CD (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CE (9, 1, ose 2) | Pyetja CF (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CG (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CH (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CJ (1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CK (9, 1, 2, 3, ose 4) | Pyetja CM (1, 2, 3, ose 4) |
| V | C A | C B | C D | C E | C F | C G | C H | C J | C K | C M |
| Pyetja CN (1 ose 2) | Pyetja CP (1 ose disa numra rresht) | | | | | | | | | |
| C N | C P | | | | | | | | | |
| Shëmbull: V01234CA1CB1CD1CE1CF1CG1CH1CJ1CK1CM1CN1CP1234. KUJDES!! Ky është vetëm një shëmbull. KUJDES! Mos nisni këtë si mesazh! Mesazhin me të dhënat tuaja do ta dërgoni në +31614793545 | | | | | | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|--------|--------|----|
| SMS 4 – Mbyllja e votimit (Plotësoni këto pyetje gjatë mbylljes së qendrës së votimit) KUJDES! Ju duhet të dërgoni SMS në numrin +31614793545 kur votimi në qendrën tuaj të ketë mbaruar dhe kutitë të jenë nisur në qendrën e numërimit. | | | | | |
| DA | A u lejuan të votojnë votuesit që ishin në rradhë në orën 19:00? | Nuk kishte njeri në rradhë (9) | PO (1) | JO (2) | DA |
| DB | A u lejuan të votojnë votues që mbërritën në qendrën e votimit pas orës 19:00? | Nuk pati votues që mbërritën pas orës 19:00 (9) | PO (1) | JO (2) | DB |
| DC | A u përputh numri i fletëvotimeve të Qendrës me numrin e fletëvotimeve në materialet e marra nga KZAZ? | | PO (1) | JO (2) | DC |
| DE | A kishte persona të pa-autorizuar prezentë në Qendrën e Votimit gjatë çfarëdo kohe të procesit të votimit? (personat që | | PO (1) | JO (2) | DE |

MONITORIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE, 21 QERSHOR 2015, NË SHQIPËRI - RAPORT PËFUNDIMTAR

| | | | | | | | | | |
|----|--|------------|-----------|---------|----------|---------|-----------|---------------|----|
| | lejohe në QV janë votuesit, komisionerët, vëzhguesit e akredituar të partive politike apo kandidatëve të pavarur si dhe vëzhguesit e tjerë të pavarur) Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | | | | | | | | |
| DF | A u futën në qendrën e votimit, personat e ngarkuar me ruajtjen e rendit gjatë apo çfarëdo kohe të hapjes, votimit apo mbylljes pa u thirrur më parë nga Kryetari i Qendrës së Votimit, apo refuzuan të largoheshin pasi u thirrën në Qendrën e Votimit? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DF | | | | | |
| DG | A pati ndonjë rast gjatë ditës kur procesi u pezullua për më shumë se 30 minuta? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DG | | | | | |
| DH | A pati ndonjë moment kur ju ndaluan ju apo ndonjë mbikqyrës tjetër të mbikqyrnin procesin e votimit apo kur ju penguan/refuzuan qasjen ndaj informacionit rreth procesit? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DH | | | | | |
| DJ | A u mbyll dhe u siguroa kutia e votimit para transportit? Nëse JO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DJ | | | | | |
| DK | A u fut në kutinë e votimit Procesverbali i Mbylljes së Votimit pasi u plotësua? Nëse JO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DK | | | | | |
| DM | A kishte probleme apo dhunë gjatë procesit të mbylljes së votimit? Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DM | | | | | |
| DN | Cila nga partitë dorëzoi pranë komisionit të votimit ankesa përmes vëzhguesit të saj, gjatë ditës së votimit? Shënoni të gjitha partitë që dorëzuan ankesa dhe shënoni në sms të gjitha numrat përkatës | Asnjë 1 | PS 2 | PD 3 | LSI 4 | PR 5 | PDIU 6 | Të tjerë 7 | DN |
| DP | A kishte ndonjë person të paautorizuar në grupin e shoqërimit të kutive të votimit nga QV në Qendrën e Numërimit? [Kujdes! Dërgimi i kutive me fletët e votimit nga qendra e votimit në qendrën e numërimit bëhet me automjet, në të cilin ndodhen anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mosprekjen e kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë së materialeve të votimit] Nëse PO, ju lutem plotësoni Formularin e Raportimit të Incidenteve. | PO (1) | JO (2) | DP | | | | | |
| DQ | Sa është numri total i zgjedhësve që votuan? (Ju lutem përfshini edhe enumerin e votuesve me urdhër gjykate) | | | | | | | | DQ |
| DR | Sa është numri i zgjedhësve që votuan me Vendim Gjykate? | | | | | | | | DR |
| DS | Sa është numri i zgjedhësve që votuan të asistuar sipas Regjistrat të Posaçëm të Zgjedhësve të KQV? | | | | | | | | DS |
| DT | Sa votues ishin gra e vajza? | | | | | | | | DT |
| DU | Sa votues ishin burra e djem? | | | | | | | | DU |
| DV | Sa ishte numri i fletëve të votimit të papërdorura? | | | | | | | | DV |
| DZ | Sa ishte numri i fletëve të votimit të dëmtuara? | | | | | | | | DZ |

| | | | | | | | | | | |
|--|-------------------------|-------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Cdo SMS duhet të fillojë me V dhe kodin e vëzhguesit | Pyetja DA (9, 1, ose 2) | Pyetja DB (9, 1, ose 2) | Pyetja DC (1 ose 2) | Pyetja DE (1 ose 2) | Pyetja DF (1 ose 2) | Pyetja DG (1 ose 2) | Pyetja DH (1 ose 2) | Pyetja DJ (1 ose 2) | Pyetja DK (1 ose 2) | Pyetja DM (1 ose 2) |
| V | D A | D B | D C | D E | D F | D G | D H | D J | D K | D M |

| | | | | | | |
|--------------------------------------|---------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Pyetja DN (1 ose disa numra rrjesht) | Pyetja DP (1 ose 2) | Pyetja DQ (numri) | Pyetja DR (numri) | Pyetja DS (numri) | Pyetja DT (numri) | Pyetja DU (numri) |
| D N | D P | D Q | D R | D S | D T | D U |

| | | |
|-------------------|-------------------|---|
| Pyetja DV (numri) | Pyetja DZ (numri) | Shëmbull: V01234DA1DB1DC1DE1DF1DG1DH1DJ1DK1DM1DN123DP1DQ400DR70DS50DT25DU12DV30DZ15 KUJDES!! Ky është vetëm një shëmbull. KUJDES! Mos nisni këtë si mesazh! Mesazhin me të dhënat tuaja do ta dërgoni në +31614793545 |
| D V | D Z | |

Faleminderit që ishit vëzhguesi i
Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme dhe Demokraci të Qendrushme

Anex 3 - Forma e Incidenteve kritike përdorur nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve të 21 qershorit 2015.



Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme dhe Demokraci të Qëndrueshme
Pyetësi i incidenteve kritike në ditën e votimit për zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Vendor, 21 Qershor 2015

Ju lutem plotësoni të gjithë pyetësin!

Kodi i Vëzhguesit:

| | |
|--------------------------------|---|
| Numri i qendrës së votimit: | Emri dhe adresa e Qendrës së votimit: |
| Emri dhe mbiemri i vëzhguesit: | Numri i telefonit të vëzhguesit: |
| Emri i Koordinatorit: | Numri i telefonit të koordinatorit të vëzhguesve: |

**Kur plotësoni formën e incidentit kritik gjithmonë telefononi në numrat:
0692477405 ; 0692477551; 0692477552; 0692477574; 0692477576;**

Forma u plotësua nga 1) Vëzhguesi 2) Koordinatori

1. Lloji i Incidentit – Zgjidhni një ose disa mundësi sipas ngjarjes

- | | |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> 1) Qendra e Votimit u hap pas orës 07:00 (pyetja AC) | <input type="checkbox"/> 12) Votuesit ose persona të tjerë futën më shumë se një fletë në kutitë e votimit (pyetja CM) |
| <input type="checkbox"/> 2) Vëzhguesit u penguan (pyetjet AQ, BG, CN, DH) | <input type="checkbox"/> 13) U ble ose shit vota (pyetja CM) |
| <input type="checkbox"/> 3) Qendra e votimit kishte mungesa të materialeve kryesore të votimit (pyetja AJ) | <input type="checkbox"/> 14) U vodh, rrëmbye me dhunë ose u dëmtua kutia e fletëve të votimit ose fletët e votimit (pyetjet DJ) |
| <input type="checkbox"/> 4) Fshehtësia e votës nuk u garantua | <input type="checkbox"/> 15) Pati fletë votimi të mbushura paraprakisht |
| <input type="checkbox"/> 5) Votuesit e pa regjistruar në Listat e Zgjedhësve dhe pa vendim gjykate, si dhe pa dokument identifikimi u lejuan të votojnë (pyetjet CA, CB) | <input type="checkbox"/> 16) U pezullua votimi (pyetja BJ, CM, DG) |
| <input type="checkbox"/> 6) Procedura e kontrollit të gishtave dhe timbrimit nuk u realizua (pyetjet CH, CJ) | <input type="checkbox"/> 17) Kishte prezencë të personave të paautorizuar (pyetjet DE, DF) |
| <input type="checkbox"/> 7) Votuesit e regjistruar në Listat e Zgjedhësve ose me vendim gjykate, dhe me dokument identifikimi, <u>nuk</u> u lejuan të votojnë (pyetja CD) | <input type="checkbox"/> 18) Kishte problem me votimin e asistuar (pyetjet CE, CF, CK) |
| <input type="checkbox"/> 8) Shumë votues nuk e gjetën emrin në listat e votimit (pyetja CG) | <input type="checkbox"/> 19) U fotografuan ose filmuan fletët e votimit (pyetja CM) |
| <input type="checkbox"/> 9) U ushtrua dhunë në ose pranë qendrës së votimit (pyetja CM) | <input type="checkbox"/> 20) Kutia e votimit nuk u trajtua sic duhet (pyetja AF, DJ, DK, DP) |
| <input type="checkbox"/> 10) U ushtrua presion ose kanosje në ose pranë qendrës së votimit (pyetja CM) | <input type="checkbox"/> 21) U zhvillua fushatë pranë qendrës së votimit ose brenda në të (pyetja AS, BK, CM) |
| <input type="checkbox"/> 11) U votua më shumë se një herë (pyetja CM) | <input type="checkbox"/> 22) Pati probleme ose dhunë gjatë procesit të mbylljes së votimit (pyetja DM) |
| | <input type="checkbox"/> 23) Shkelje të tjera të rëndësishme (shpjego) |

2. A u morrën dëshmi/materialë si provë për incidentet e vërejtura?

PO JO

Përgjigjuni pyetjes 2 vetëm nëse keni dëshmi për ta vërtetuar çfarë ndodhi jashtë QV. Nëse jo ju lutem kaloni në pyetjen 3.

Nëse PO ju lutem dërgoni dëshminë/materialin me e-mail në adresën kzln@kzln.org.al, ose duke përdorur Viber ose në What's Up në numrin 0692477405

3. Shpjegim i detajuar (Ju lutem përdorni faqen tjetër për të shtuar informacion nëse ju duket e nevojshme)

Ju lutem jepni një raport të detajuar të incidenteve duke specifikuar kush, çfarë, ku, kur, pse, etj. (ju lutem jepni emrin e partisë politike dhe/ose të kandidatëve apo mbështetësve të tyre nëse e gjykoni të përshtatshme). Gjithashtu specifikoni nëse ishit ju personalisht dëshmitar i incidentit apo kjo që po raportoni është konstatuar nga të tjerë. Nëse ky është një raport nga të tjerë, ju lutem specifikoni kush ua dha këtë informacion dhe sa i besueshëm është. Ju lutem gjithashtu komentoni nëse dhe sa ky incident ndikoi në nivel lokal.

Vlerësimi i incidentit

Cili është mendimi juaj për çfarë ndodhi dhe reagimet e mundshme?

Reagimet

A kishte ndonjë reagim nga Komisioni i Qendrës së Votimit ose Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) Nëse po ju lutem përshkruani.

Monitorimi në vazhdim

Çfarë do të kryeni tjetër në mënyrë që të monitoroni këtë incident? Çfarë duhet të bëjë KZLN për t'ju ardhur juve në ndihmë ?

RAPORTONI MENJËHERË TË GJITHË INCIDENTET PRANË KZLN-SË NË NUMRAT:

0692477405 ; 0692477551; 0692477552; 0692477574; 0692477576;

4. Pas bisedës dhe vendimit në konsultim me këshilltarët ligjorë në Qendrën e Komunikimit, a dorëzuat vërejtje me shkrim pranë komisionit të qendrës së votimit mbi këtë incident?

Po Jo

| | | |
|--------------------|-------------------|---------------------------|
| Firma e vëzhguesit | Emri i Vëzhguesit | Ora dhe data e incidentit |
| | | |

Anex 4 – Grafikët informues në lidhje me vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve. Ju lutem e gjeni këtë informacion në faqen e internetit të: www.kzln.org.al

Anex 5 – Tabelat me rezultatet e vëzhgimit të Ditës së Zgjedhjeve. Ju lutem e gjeni këtë informacion në faqen e internetit të: www.kzln.org.al



A : Rr. "Abdyl Frashëri" P. 10/1, Ap. 3. P.O. Box 2418. Tirana, Albania
W : www.kzln.org.al E : kzln@kzln.org.al T : +355 4 22 555 14



www.kzln.org.al



KoalicioniPerZgjedhjeTeLiraETeNdershme



KZLN_CFFE



KZLNCFFE



KZLN CFFE